

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

**SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM
I PASURIVE NATYRORE**

Materialet e Tryezës shkencore,
20 tetor 2010, në Prishtinë



PRISHTINË

2011

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

SECTION OF SOCIAL SCIENCES

**THE SUSTAINABLE USE
OF NATURAL RESOURCES**

The Materials from the scientific conference,
20 October 2010, Prishtina

Editorial board: Hivzi Islami, Pajazit Nushi and Isa Mustafa

Editor: Academician Pajazit Nushi, Secretary of the Section
of Social Sciences



**PRISHTINA
2011**

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I PASURIVE NATYRORE

Materialet e Tryezës shkencore,
20 tetor 2010, në Prishtinë

Këshilli redaktues: Hivzi Islami, Pajazit Nushi dhe Isa Mustafa

Redaktor: akademik Pajazit Nushi, sekretar i Seksionit
të Shkencave Shoqërore



PRISHTINË
2011

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	5
Pajazit NUSHI: SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I PASURIVE NATYRORE.....	7
Minir DUSHI: SHFRYTËZIMI I PASURIVE MINERALE DJE, SOT DHE NESER....	9
Latif SUSURI dhe Skender KAÇIU: RESURSET BUJQËSORE DHE ZHVILLIMI RURAL I KOSOVËS ..	23
Muhamet MUSTAFA: MJEDISI INSTITUCIONAL DHE SHFRYTEZIMI EFEKTIV I BURIMEVE NATYRORE	35
Isa MUSTAFA: ZHVILLIMI I QENDRUESHËM DHE RESURSET E PËRTËRITSHME DHE TË PAPËRTËRITSHME	45
Ruzhdi PLLANA dhe Vahdet PRUTHI: RESURSET UJORE DHE SFIDAT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	57
Azem HAJDARI: RREGULLATIVA LIGJORE E SHFRYTËZIMIT TË RESURSEVE NATYRORE TË KOSOVËS	71
Avdullah HOTI: PASURITË NATYRORE DHE ZHVILLIM EKONOMIK: EVIDENCA DHE IMPLIKIMET PËR POLITIKAT EKONOMIKE....	87
Petrit GASHI: RESURSET NATYRORE DHE NDIKIMI I TYRE NË RRITJEN EKONOMIKE: ÇFARË MUND TË THUHET PËR KOSOVËN?.....	99

Pajazit NUSHI

SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I PASURIVE NATYRORE

(Fjala e hapjes së punimeve të Tryezës Shkencore)

I shpall të hapura punimet e Tryezës Shkencore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mbi shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore të Kosovës. Kemi konsideruar se tema bosht e kësaj tryeze “ **Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore të Kosovës**”, në kohën e tanishme të zhvillimit të Kosovës dhe të shtetndërtimit të Kosovës, përbën tematikën themelore të aktualitetit të politikës ekonomike e sociale të Kosovës dhe të regjionit të gjerë. Me rastin e përcaktimit të një qëndrimi të këtillë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka pas parasysh tri qëndrime esenciale:

1. Pasuritë natyrore të secilit vend, sidomos pasuritë natyrore të shtetit në ndërtim të Kosovës, përbëjnë komponentin themelor të tërësisë së zhvillimit ekonomik, social dhe politik të pavarësimit të plotë të shtetit – të Republikës së Kosovës.
2. Pasuritë natyrore janë të papërsëritshme dhe shi për këtë kërkohet konceptim i qartë, i balancuar i angazhimeve të koordinuara afatgjate dhe frytdhënëse për brezin e tashëm dhe brezat e ardhshëm.
3. Për shkak se resurset natyrore janë të rralla dhe kapacitetet e tyre nuk janë të pafundme, për Kosovën me zhvillim demografik karakteristik dhe me synime integruese të gjera, shfrytëzimit të tyre duhet t'i paraprijë strategjia e balancuar dhe koordinuese e konceptuar mbi objektivat afatgjatë të zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës.

Nga një këndvështrim i këtillë është shtjelluar teksti i gjerë mbi shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore, që u është dërguar të gjithë pjesëmarrësve dhe në bazë të të cilit janë konceptuar temat e pjesëmarrësve të kësaj tryeze, si edhe programi i punës së kësaj tryeze. Duke pasur për bazë parapërgatitjet e bëra për punën e kësaj tryeze,

presim që temat e shtjelluara në këtë tryezë, si edhe diskutimi për përmbajtjen e këtyre temave, do të vërë theksime të posaçme në këto çështje:

- a) Roli dhe rëndësia e shfrytëzimit me plan i pasurive të qëndrueshme natyrore të Kosovës, duke i shndërruar këto pasuri prej “pasurive të mallkimit” në pasuri të mirëfillta për mirëqenien njerëzore dhe zhvillimin e shtetit të Kosovës.
- b) Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore të Kosovës, duke mos rrezikuar ambientin e pëlleshëm dhe të bukur tokësor, ujor dhe ajror.
- c) Nxitje sistematike e kontrollimit të koncepteve mbi bazën e të dhënave empirike dhe të risive që paraqiten gjatë procesit të shfrytëzimit të pasurive natyrore.

Kërkesës së objektivave të kësaj tryeze i janë përgjigjur dhjetë studiues, me tetë tema të renditura sipas programit të definuar qysh para dhjetë ditësh. Të gjithë studiuesit pjesëmarrës të kësaj tryeze kanë përvojë studimore e hulumtuese shumëvjeçare, si edhe përvojë nga tubimet e ngjashme të natyrës së tryezës shkencore. Për këto shkaqe kemi propozuar që prezantimi i kumtesave të zgjatë deri 15 minuta. Diskutimi për përmbajtjen e temave të prezantuara konsiderojmë se është pjesë përbërëse e punës sonë të sotme dhe mund të zgjatë pesë minuta. Punimet e prezantuara si dhe diskutimet do të botohen në kuadrin e publikimeve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Minir DUSHI

SHFRYTËZIMI I PASURIVE MINERALE DJE, SOT DHE NESËR

Abstrakt

Në këtë studim bëhet fjalë për shfrytëzimin e pasurive minerale të Republikës së Kosovës në periudhën e kaluar, të sotme dhe në perspektivë. Në të kaluarën suksese më të mëdha nga nxerrja dhe përpunimi industrial i pasurive minerale ishin arritur në vitet ' 80, kur prodhimi shoqëror i Kosovës në bazë të këtyre lëndëve shënoi një vlerë prej 47,4 %, ndërsa punësimi rreth 39 % nga numri i përgjithshëm i të zënëve me punë (1988).

Në vazhdim janë dhënë lartësitë e prodhimeve minerare-industriale, metalurgjike, kimike dhe të materialeve të ndërtimit në vitin 1987. Aktualisht, prodhimet e xeherorëve të Pb-Zn dhe të Ni-Co janë të vogla, veçanërisht ato të Pb-Zn, të cilat mezi arrijnë 10 % të prodhimit të dikurshëm të "Trepçës"(1988). Prodhimin më të madh, sot, në Republikën e Kosovës, kanë gëlqerorët e gurorëve në vëllim prej 2,164.589 m³/v (2009).

Janë dhënë edhe informacione për organin kompetent për punë në lëmin e gjeologjisë dhe të xehetarisë në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-081, që është **Komisioni i Pavarur për Minerale dhe Miniera** (KPMM).

Në fund, bëhet fjalë për rezervat e pasurive minerale të trevës së Republikës së Kosovës, veç e veç për secilën lëndë minerale. Në bazë të lartësive të rezervave është dhënë prognoza mbi madhësitë e prodhimit optimal vjetor për secilën lëndë minerale në përputhje me lartësinë e rezervave.

HYRJE

Pasuritë minerale janë begati e posaçme natyrore, të cilat, për dallim nga begatitë e tjera, janë të shtershme dhe kur harxhohen nuk

mund të përtërihen. Ndërkaq, në rruzullin tokësor janë të shpërndara në mënyrë jo të njëtrajtshme. Pasuritë minerale janë një thesar i vërtetë, pasi janë bazë e zhvillimit të gjithanshëm ekonomik dhe të progresit njerëzor. Zhvillimi i industrisë dhe i metalurgjisë i një vendi nuk mund të mendohet pa shfrytëzimin dhe përpunimin e mineraleve metalore, jometalore dhe kaustobiolite. Pothuajse të gjitha vlerat materiale të krijuara nga aktivitetet njerëzore kanë preardhje nga lëndët minerale.

A) SHFRYTËZIMI DHE PËRPUNIMI I PASURIVE MINERALE DJE

Dihet se pasuritë minerale të Kosovës janë të shumta si për nga lloji e cilësia, ashtu edhe për nga sasia. Sa i përket kësaj të fundit, veçohen mineralet e **plumb-zinkut, nikel-kobaltit, magnezitit, boksiteve, qymyrit, linjtitit** dhe **materialeve të ndërtimit**, që kanë rëndësi të madhe gjeologjike. Këto pasuri nuk i ka askush në rajon. Republika e Kosovës ka një të ardhme shumë të mirë me pasuritë minerale që ka. Nga shfrytëzimi i pasurive minerale, ekonomisë së Kosovës, në forma të ndryshme, iu ishin siguruar në kohë të gjata prosperitet dhe të mira materiale. Me shembullin e Kosovës më së miri vërtetohet teza se lëndët e para minerale janë faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik.

Në bazë të pasurive të lëndëve minerale, në Kosovë ishin ndërtuar kapacitete industriale të përpunimit në energjetikë, në metalurgjinë me ngjyra, në industrinë e jometaloreve dhe në industrinë e materialeve të ndërtimit. Këto kapacitete, në vitin 1988, kanë arritur të realizojnë rreth 47,4 % të **prodhimit shoqëror të Kosovës**, kurse kanë marrë në punë rreth 39 % nga numri i përgjithshëm i të zënëve me punë¹. Në vitin 1983, ish-kombinati i “Trepçës” ka eksportuar mallra me vlerë 103 milionë USD, duke u radhitur në vendin e pestë të eksportuesve në ish-federatën jugosllave, kurse eksporti mesatar vjetor i realizuar ishte 75,000.000 USD. Ndërkaq, në periudhën dhjetëvjeçare 1975-1985, vlera e përgjithshme e prodhimit mesatar vjetor të “Trepçës”, shprehur në USD, ka qenë 262,282.000, shkalla e akumulimit 3,8 % nga të hyrat e përgjithshme ose në vlerë 10,000.000 USD.

Së këndejmi, edhe në të ardhmën burimet e lëndëve minerale të vendit tonë do të përfaqësojnë pikënisje për sigurimin e zhvillimit të

¹ Zhvillimi ekonomik i Kosovës, **Riinvest**, f. 30, 1998.

mundshëm ekonomik-industrial të programuar. Se si ishte zhvillimi industrial i Kosovës në bazë të shfrytëzimit e të përpunimit të pasurive minerale në të kaluarën më së miri mund të shihet nga të dhënat në pasqyrën në vazhdim.

Në vitin 1987, Kosova, në bazë të shfrytëzimit e përpunimit industrial të pasurive të lëndëve të para minerale, kishte arritur këto prodhime minerare, metalurgjike, kimike dhe ndërtimore² :

1. Elektroekonomia

- Energji elektrike gjithsej	6003 milj.kwh
- Qymyr linjit	10.710 milj.t
- Linjit i terur	207 mijë t.

2. Prodhimi i metaleve me ngjyra

- Hekurnikel	9556 t
- Plumb i papërpunuar	92871 t
- Plumb i përpunuar (i rafinuar)	86475 t
- Zink elektrolit	44822 t
- Argjend i përpunuar (i rafinuar)	98 t
- Bizmut	73 t.

3. Prodhimi i mineraleve jometalore

- Magnezit i pjekur kaustik	5924 t
- Sintermagnezit	42540 t
- Pllaka qeramike (të murit, dyshemesë etj.)	19726 t.

4. Prodhimi i produkteve kimike

- Acid sulfurik 66 Be	88000 t
- Sulfid alumini	1960 t
- Superfostat 16 % P ₂ O ₅	64000 t
- Plehra komplekse	64000 t.

5. Prodhimi i materialeve të ndërtimit

- Gëlqere e pashuar	310000 t
- Tulla	101 milionë copë
- Tjegulla	2 milionë copë
- Çimento	295000 t
- Prodhime të azbest-çimentos	25640 t.

² Burimi: Vjetari statistikor i Kosovës, 1988.

B) PRODHIMI I LËNDËVE TË PARA MINERALE METALORE, JOMETALORE DHE KAUSTOBIOLITE SOT

Sektori i pasurive minerale në KPMM mban shënime mbi sasitë e shfrytëzuara të lëndëve të para minerale. Por, në anën tjetër, edhe kompanitë, që posedojnë licenca për shfrytëzim, dërgojnë raporte të rregullta për sasitë e nxjerra të lëndëve minerale.

Në vazhdim do të tregohen, me anë të tabelave, sasitë dhe llojet e lëndëve të para minerale metalore, jometalore dhe atyre djegëse, që sot shfrytëzohen në Republikën e Kosovës.

Prodhimi i materialeve jometalore ndërtimore dhe industriale në vitet 2005-2009 [m³]

Tabela 1.

Materiali / viti	2005	2006	2007	2008	2009
Gëlqerorë	629.61 2	777.49 1	879.79 7	1,917.19 6	2,164.58 9
Rërë dhe zhavorr	14.894	35.650	41.621	45.463	46.085
Mergel	264.81 4	254.38 6	260.70 7	322.007	291.829
Andenzite		19.940	36.321	45.005	58.778
Proluvion	4.515	3.800	2.610	3.121	2.620
Argjilë			27.614	35.382	78.812
Rëra kuarcore			26.800	27.325	20.180
Andenzite- Bazalte					7.194
Harcburgit e					8.788

Prodhimi i xeherorëve të nikel-kobaltit [t] në vitet 2007-2009

Tabela 2.

Vendburimi/ viti	2007	2008	2009
Kodra (Golesh)	119632	248.963	261458
Qikatovë	26.249	489.514	294.618
Gjithsej	145.881	738.477	556.076

Pas privatizimit në periudhën 2007-2009 të ndërmarrjes “Ferronikeli”³, prodhimi mesatar vjetor i xeherorit të Ni-Co ka arritur në 480.000 t/v, që është diçka më shumë se 50 % nga sasia e programuar e prodhimit të ndërmarrjes së “Ferronikelit” në Kosovë (980.000 t/v). Privatizimi shumë i përfolur i “Ferronikelit”, për nga çmimi i turpshëm, si përfundim, përveç të tjerave, kishte varfërimin e buxhetit të Republikës së Kosovës. Prandaj, kjo ndërmarrje ekonomike nuk ka ndikuar në zhvillimin ekonomik e as në uljen e papunësisë dhe të varfërisë së vendit.

“Ferronikeli” ishte ndërtuar prej vitit 1978-1984, kurse më 1985 ka filluar prodhimin testues. Teknologjia prodhuese është ndër më bashkëkohoret dhe e sofistikuar, ndërsa pajisjet janë nga Perëndimi (Gjermania, Danimarka dhe Norvegjia). Për ndërtimin e “Ferronikelit”, Kosova ka investuar afro 580 milionë dollarë. Kjo ndërmarrje ishte kthyer në njërin nga shtyllat kryesore ekonomike të Kosovës pas “Trepçës” dhe “Elektroekonomisë”.

“Ferronikeli” ishte një ndërmarrje koherente dhe shumë dobiprurëse, e vetmja e këtij lloji në ish-federatën jugosllave. Kjo ndërmarrje në praktikën e deritashme është shfaqur e mbyllur, me xhelozë në vete, ku vështirë mund të depërtohej.

Autori i këtyre rreshtave është detyruar të heqë dorë nga një vizitë profesionale të mihjeve sipërfaqësore të “Ferronikelit” për shkak të formaliteteve të tepruara, zvarritjes së përgjigjes në kërkesën me shkrim të kërkuar nga Akademia, pyetjeve: “Përse doni të vizitoni?”, “Për çfarë jeni të interesuar?” etj.

Ndërkaq, askush nuk di se çfarë afarizmi ka “Ferronikeli” sot, duke pasur parasysh edhe çmimin aq të ulët të energjisë elektrike që

³ Emër joadekuat, duhet të ishte Hekurnikeli

shfrytëzon. Në anën tjetër, nuk dihet se sa janë duke u përtërirë rezervat e xeherorëve të Ni-Co, që po shfrytëzohet. Ka edhe shumë aneksa për ndotjen e mjedisit, sepse filterët, edhe pse janë vendosur, nuk mirëmbahen me rregull.

Shfrytëzimi i xeherorëve të Pb-Zn ka traditë shumë të madhe prodhuese në Kosovë. Aktualisht, Pb-Zn janë duke u nxjerrur vetëm në 4 miniera (tabela 3). Lartësia më e madhe e prodhimit të këtyre xeherorëve në vitin 2009 është arritur 162.000 t., që përbën rreth 10 % të prodhimit prej 1,648.935 t. në kombinatin e “Trepçës” në vitin 1988⁴.

Pas një ndërprerjeje të punës aktive prej 15-20 vjetësh, riaktivizimi i prodhimit në minierat e “Trepçës” është punë shumë e vështirë. Për të arritur këtë duhen përgatitje nga shumë aspekte (rimkëmbja e galerive, riparimi i pajisjeve dhe makinerive, pastrimi pas përmbytjeve etj.).

Prodhimi i xeherorëve të plumb-zinkut [t] në vitet 2005-2009

Tabela 3.

Vendburimi/ viti	2005	2006	2007	2008	2009
Stantërg	12.200	43.776	23.599		40.088
Artana		19.741	7.967	27.356	11.943
Belloberdë			3.035	24.810	7.280
Crnac			43.319	87.504	32.680
Gjithsej	12.200	63.517	77.920	139.670	161.991

Sot, prodhim më i lartë prej 2,164.589 m³ (tabela 1) i lëndëve minerale në Republikën e Kosovës janë materialet e ndërtimit, përkatësisht gëlqerorët, të cilët për nga sasia kanë zënë vendin e xeherorëve aq të çmueshëm të Pb-Zn.

Lartësia e prodhimit vjetor të qymyrit linjit në KEK vazhdon të jetë e njëjtë qysh nga viti 1975, me lëkundje të vogla lart-poshtë.

⁴ Libri “Trepça”, f. 94.

Prodhimi i qymyrit linjit [t] në vitet 2004-2009

Tabela 4.

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Prodhimi	5,658. 365	6,391. 138	6,538. 967	6,715. 357	7,885. 345	7,839. 173

ADMINISTRIMI I PASURIVE MINERALE TË KOSOVËS

KOMISIONI I PAVARUR PËR MINERALE DHE MINIERA (KPMM), që punon sipas Ligjit Nr. 03/L-081, është organ i vetëm kompetent për punë në lëmenj të gjeologjisë dhe të xehetarisë, që rregullon dhe mbikëqyr:

- hulumtimin dhe shfrytëzimin optimal të pasurive minerale në të gjitha fazat e nxerrjes së lëndëve të para minerale;
- zbatimin e standardeve ndërkombëtare;
- sigurinë e punëtorëve dhe të objekteve të tjera në pajtim me Ligjin e lartshënuar.

Licencat dhe lejet e lëshuara nga KPMM nga viti 2005-2009

Tabela 5.

Lloji i licencës/viti	2005	2006	2007	2008	2009	Gjithsej
Licenca për hulumtim	10	14	27	74	53	177
Licenca për shfrytëzim	33	49	55	38	27	202
Licenca të posaçme	9	15	37	33	20	115
Gjithsej	52	78	119	145	100	494

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në qershor të vitit 2008, ka dekretuar Ligjin Nr. 03/L-081, me të cilin është ndryshuar Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/2 dhe KPMM u bë organ përgjegjës i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me Ligjin në fjalë, **KPMM** lëshon dokumente-licenca të vlefshme për hulumtimin dhe shfrytëzimin e pasurive minerale (metalore, jometalore dhe kaustobiolite) të trevës së Kosovës.

KPMM nga viti 2005-2009 ka lëshuar 494 licenca dhe leje për punë nga fusha e veprimtarive të gjeologjisë e të minierave të paraqitura në tabelën 5.

Analiza e licencave të lëshuara

Licencat e lëshuara mund të jenë: **licenca hulumtimi, licenca shfrytëzimi dhe licenca të posaçme pune.**

1. **“Licenca për hulumtime”** përfaqëson autorizimin zyrtar të lëshuar nga KPMM për hulumtime në afat 2-vjeçar, me mundësi vazhdimi.
2. **“Licenca për shfrytëzim”** përfaqëson autorizimin për shfrytëzimin e ndonjë lënde minerale. Kjo licencë për shfrytëzim të lëndëve jometalore lëshohet në afat deri në 25 vjet, me mundësi vazhdimi, kurse për ato metalore deri në 40 vjet, pa mundësi vazhdimi.
3. **“Leje për punë të posaçme (speciale)”** mund të jenë të disa llojeve: punë kërkimore, punë me mjete plasëse, xehetari zejtare, punë në xehetari, përpunimi i mineraleve dhe lëshohen për kohëzgjatje deri në 3 vjet.

Me gjithë angazhimin e madh të stafit të KPMM në ndalimin e operacioneve ilegale në forma të ndryshme administrative, **janë regjistruar 83 seperacione, që operojnë pa licencë të KPMM-së.** Ndërkaq, kompanitë ilegale, që merren me shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë, të rërës dhe zhavorrit, gjatë vitit 2009 **janë regjistruar në 51 lokalitete.**

Shtretërit e lumenjve të Kosovës po shkatërrohen nga nxerrja e rërës dhe e zhavorit. Ndërkaq, komunat nuk kanë kompetenca për të parandaluar këtë të keqe. Në anën tjetër, inspektorët e **KPMM** nga Prishtina vështirë arrijnë të bëjnë në kohë kontrollimin e vazhdueshëm të një numri kaq të madh të operatorëve ilegalë. Kurse denoncimet e inspektorëve përfundojnë në gjyqësi, që nuk është efikase. Mirëpo, qëndron fakti se të gjitha kompanitë kanë licenca nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.

C) MUNDËSITË PRODHUESE NË BAZË TË REZERVAVE TË PASURIVE MINERALE NESËR⁴

Në vazhdim do të njihemi me llojet dhe rezervat e lëndëve më të rëndësishme minerale metalore, jometalore dhe kaustobiolite (të ngurta). Këto rezerva, të cilat kanë qenë objekt i shfrytëzimit edhe në të kaluarën, bëjnë të mundur realizimin e një prodhimi minerar në shkallë të lartë në Republikën e Kosovës.

1. REZERVAT E QYMYRIT LINJIT

Hulumtimet gjeologjike të qymyrit të Fushë-Kosovës, të kryera nga shumë institucione të specializuara në ish- Federatën jugosllave kishin hartuar dokumentacione të shumta për sasinë e rezervave të qymyrit. Së këndejmi, në Kosovë një kohë të gjatë kanë ekzistuar vlerësime të ndryshme për lartësinë e rezervave të qymyrit. Me kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe të Minierave, **instituti** “Inkos” në vitin 2007, në bazë të dokumentacionit teknik ekzistues, ka hartuar një studim, me të cilin ishte kryer përcaktimi i saktë i rezervave gjeologjike të qymyrit të basenit të Fushë-Kosovës. Prandaj, këto rezerva, përfundimisht të pranuar në mënyrë zyrtare, janë: **10.369,724,770 t** .

2. REZERVAT E XEHERORËVE TË PLUMB-ZINKUT

Gjithashtu, edhe rezervat e këtyre xeherorëve shprehen, sipas kohës, në disa variante. Kanë kaluar më se 20 vjet që kur nuk është bërë asnjë vërtetim i rezervave të lëndëve minerale të Kosovës. Sipas ish-Ligjit të xehetarisë, rezervat minerale duhet vërtetuar çdo 3 vjet, përkatësisht 5 vjet.

Varianti i parë .– Në fillim të vitit 1989, gjendja e rezervave gjeologjike të xeherorëve të plumb-zinkut dhe përmbajtja e metalit në vendburimet e Republikës së Kosovës siç janë: Stantërg me Zijaç, Kishnica, Hajvalia, Badovci, Artana, Belloberda, Crnac, Zhuta Prlina, Koporiq, Jallakse etj., përkatësisht të ish-kombinatit “Trepça” kanë qenë:

⁴ Shifrat e nxjerra të pasurive minerale janë vlerësuar kryesisht në vitet 80, në pajtim me standardet e rezervave, që ishin të përbashkëta për vendet e ish- Bllokut Lindor (A,B,C₁,C₂)

Rezervat e kategorive	Përmbajtja e metalit		
	Pb %	Zn %	Ag (g/t)
A+B+C ₁	4,10	2,92	63,6
41,781.000 (t)			

Varianti i dytë. – Në vitin 1986, rezervat e xeherorëve të plumb-zinkut të të tri grupeve të minierave të ish-kombinatit “Trepça”: **Trepça-Stantërg, Kizhnicë-Artanë** dhe **minierat e Kopaonikut** përbëjnë këto rezerva të vërtetuara:

Rezervat e kategorive	Përmbajtja e metalit		
	Pb %	Zn %	Ag (g/t)
A+B+C ₁	4,28	3,00	74,33
37,718.525 t.			

Përveç rezervave të pasqyruara më lart, ekzistojnë edhe ato me **perspektivë** të xeherorëve të plumb-zinkut në suazën e rrethinave të afërta të minierave aktive (në rrethinën e Stantërgut: Melenica, Magjera, Mazhiqi, Maja e Madhe, Zijaça, Tërstena, pastaj Lugthati, Drazhnja, Crepula Pilatovice dhe Shatorice), në të cilat janë vlerësuar rezervat e këtyre xeherorëve në mbi 17 milionë t.

3. REZERVAT E XEHERORËVE TË Ni-Co SILIKAT

Rezervat e xeherorëve të Ni-Co silikat në vendburimin e **Çikatovës** dhe të **Kodrës** së **Goleshit**, të vërtetuara në vitin 1977 nga ish-Sekretariati Krahinor i Ekonomisë, janë B+C₁ = 20,104.046 t. me përmbajtje Ni=1,31 % dhe Co=0,065 %. Mirëpo, për shkak të humbjeve ato redukohen në të ashtuquajtura rezerva të shfrytëzimit prej 17,610.133 t. Ndërkaq, në lokalitetet e minierave në Çikatovë dhe në Kodrën e Goleshit janë vërtetuar edhe rezerva me perspektivë C₂ prej 8.000.000 t. me përmbajtje të Ni=1,31 % dhe Co = 0,07 %.

Përveç këtyre, në lokalitetin Rugjerci – Veluça janë zbuluar rezerva të reja të Ni-Co silikat të kategorisë C₁ prej 15,183.500 t. me përmbajtje Ni=1,19 % dhe Co=0,06 %.

4. REZERVAT E XEHERORËVE TË MAGNEZITIT

Bazën e pasurisë minerale të magnezitit e përbëjnë rezervat e xeherorëve në minierat: “**Golesh**”, “**Strezovc**” dhe “**Dubovci**”. Këtyre rezervave duhet shtuar ato të perspektivës si dhe shfaqjet e magneziteve në rajonin e gjerë të minierave ekzistuese (Medvec, Mirenë, Stankoc, Dritan, Gropa Arushës, Leletiq, Vrellë, Deçan etj.).

Në minierat "Golesh", "Strezovc" dhe "Dubovc" ishin vërtetuar këto rezerva:

1. Në "Golesh" $A+B+C_1 = 2,358.457 \text{ t.} + C_2 = 2,500.000 \text{ t.}$ të perspektivës;
2. Në "Strezovc" $A+B+C_1 = 5,365.000 \text{ t.}$ dhe
3. Në "Duboc" $A+B+C_1 = 964.949 \text{ t.}$

5. REZERVAT E XEHERORËVE TË BOKSITEVE

Gjendja e rezervave të xeherorëve të boksiteve të **Grebnikut të Klinës**, në fund të vitit 1977, të kategorisë $A+B = 3,385.000 \text{ t.}$ me këtë përmbytje:

$$\text{Al}_2\text{O}_3 = 47,89 \% ; \text{SiO}_2 = 2,36 \% \text{ dhe } \text{Fe}_2\text{O}_3 \text{ } 37, 18 \%$$

Në trupa të tjerë mineralë, akoma të pahulumtuar hollësisht, vlerësohet se rezervat e kategorisë $C_1 = 1,700.000 \text{ t.}$, ndërsa ato të perspektivës $C_2 = 4-5$ milionë tonë. Ndërkaq, në këtë zonë të Grebnikut mund të pritet edhe më tej shtimi i rezervave.

6. REZERVAT E GRANITEVE TË KAOLINIZUARA DHE MERGELET ÇIMENTORE

Në vendburimin e Karaçevës, që është hulumtuar në hollësi (1983), janë vërtetuar këto rezerva të kaulinit $A+B+C_1 = 5,619.000 \text{ t.}$

Përveç këtyre, në trevën e Republikës së Kosovës vendburimet e mergeleve çimentore janë vërtetuar edhe në 3 lokalitete: **Hani Elezit**, **Pali Vodnica** dhe **Dreni**.

Rezervat e mergeleve çimentore të kategorisë $A+B+C_1$ të këtyre vendburimeve janë:

- | | |
|------------------------|---------------|
| 1. Hani Elezit | 15,470.000 t. |
| 2. Pali Vodnica | 25,985.000 t. |
| 3. Dreni | 30,336.000 t. |

7. REZERVAT E BENTONITEVE

Në basenin terciar të Vitisë, Dardanës dhe Gjilanit, janë të njohura dhjetëra e më shumë shfaqje të bentoniteve, por me interes të veçantë janë vendburimet: **Karaçevë**, **Gushticë** dhe **Sadovina e Jerlive**. Në **Karaçevë**, shtresa e bentonitit shtrihet në gjatësi prej 400 m e trashësi mesatare 0.50 m. Ndërsa në **Gushticë** është zbuluar një

vendburim ndër më të mëdhenjtë në botë të bentoniteve. Rezervat e këtyre vendburimeve janë:

1. **Karaçevë** $B+C_1 = 1,147.775$ t.
2. **Sadovinë e Jerlive** $A+B+C_1 = 6,154.000$ t. dhe
3. **Gushticë**, rezervat e kategorisë $C_1 = 23,600.000$ t dhe ato të kategorisë $C_2 = 50,000.000$ t.

8. REZERVAT E LËNDËVE MINERALE ARGJILORE

Në trevën e Republikës së Kosovës janë të njohura shumë vendburime të argjilës, të cilat përdoren për prodhimin e tullave, tjegullave dhe enëve shtëpiake.

Argjila në industri përdoret në dy forma:

- 1 – **natyrale** (për prodhimin e çimentos, letrës, gomës etj.) dhe
- 2 – **të pjekura** (në industrinë kimike, metalurgji, në prodhimin e qeramikës etj.).

Vendburimet më të rëndësishme të argjilës janë hulumtuar në lokalitete të fabrikave të tullave e tjegullave, siç janë: **Zveçan, Besianë, Prishtinë, Ferizaj, Landovicë, Gjakovë, Pejë, Skënderaj, Jagodë, Dardanë** etj.

Rezervat gjeologjike të balansuara të argjilës dhe të rërës për prodhimin e materialeve të qeramikës (refraktore) janë:

- | | |
|--|--------------------------------------|
| 1 – Gjakovë | $A+B+C_1 = 3,385.811$ m ³ |
| 2 – Dardanë (Kodra e Topanicës) | $A+B+C_1 = 1,304.370$ m ³ |
| 3 – Prishtinë (Bernicë e Poshtme) | $A+B+C_1 = 3,989.489$ m ³ |
| 4 – Landovicë | $A+B+C_1 = 1,809.683$ m ³ |
| 5 – Jagodë | $A+B = 3,242.353$ m. ³ |

Duke u bazuar në rezervat e bollshme dhe llojet e pasurive minerale metalore, jometalore dhe të kaustobiolite, që gjenden në tokën e Republikës së Kosovës e që kanë gjetur përdorim në degët e ndryshme të ekonomisë, del se industria e minierave ka perspektivë të madhe.

Siç pamë, rezervat e pasqyruara të pasurive minerale bëjnë të mundshme zhvillimin e një prodhimi ekonomik mineraro-industrial, kur ndërtohen kushtet adekuate të shfrytëzimit në një shkallë mjaft të lartë, si, për shembull:

1. Qymyri energjetik	40-80.000.000 t/v
2. Xeherorët e plumb-zinkut	1.500.000 – 2.000.000 t/v
3. Xeherorët e nikelit	1.000.000 t/v
4. Xeherorët e magnezitit	300.000 t/v
5. Xeherorët e boksitit	100.000 t/v
6. Granitet e kaolinizuara	100.000 t/v
7. Bentonitet	200.000 t/v
8. Mergelet çimentore	300.000 t/v
9. Argjila	300.000 t/v
10. Gurë dekorativë-bloqe	4.000 m ³
11. Gurë dekorativë-pllakë	75.000 m ² .

Ndërkaq, në lartësitë e mundshme të prodhimeve të lëndëve minerale nuk mund të bëhen kalkulime vetëm në bazë të rezervave të përgjithshme, duke lënë pas dore të gjithë faktorët e tjerë relevantë (p.sh., për qymyrin: depozitimi i hirit dhe i shterpës, mbrojtjes së mjedisit jetësor, sigurimi i ujit etj.).

Dikur ka pasur rezerva të dukshme të kromit, por tani janë shterur. Nga jometalet rëndësi të madhe kanë **magnezitet**, e pastaj lëndët e para të shumta siç janë: **kaolini**, **dunitet**, **bentonitet**, **mergelet çimentore**, **halozitet**, **leucitet**, **rëra kuarcore**, **talku**, **sericitet**, **argjila**, **tufet**, **magnetiet**, **kalcitet**, gurët dekorativë, si dhe materialet e tjera të ndërtimit.

BIBLIOGRAFI

BOTIME, RAPORTE DHE DOKUMENTE TË PËRDORURA

M. Dushi, Pasuritë minerale të Kosovës, Vëllimi I dhe II, ASHAK, Prishtinë, 2009.

M. Dushi, Mundësitë gjeominerale të Kosovës. Simpoziumi ndërkombëtar; Potencialet gjeominerale, strategjia dhe menaxhimi i tyre, Mitrovicë, 2006.

KPMM, Raporti vjetor për vitin 2009, Prishtinë, 2010.

Riinvest, Zhvillimi ekonomik i Kosovës, f. 30, 1998, Prishtinë.

M. Dushi, “Trepça”, botim i ASHAK, Prishtinë, 2002.

Vjetari statistikor i Kosovës, Prishtinë, 1988.

Riinvest, Zhvillimi ekonomik i Kosovës, Prishtinë, 1998.

Latif SUSURI dhe Skënder KAÇIU

RESURSET BUJQËSORE DHE ZHVILLIMI RURAL I KOSOVËS

Abstrakt

Në Kosovë, bujqësia është një ndër aktivitetit më të rëndësishme ekonomike. Në këtë sektor janë në marrëdhënie pune një numër i konsiderueshëm i fuqisë punëtore, posaçërisht të asaj të zonave rurale. Aktualisht, Kosova ka afro 577.000 ha, por vetëm 272.000 ha apo 47.1 për qind janë toka të mbjella me kultura, ndërkaq, pjesa tjetër iu takon livadheve, kullotave dhe djerrinave. Nga sipërfaqet e mbjella dominojnë drithërat – kryesisht gruri dhe misri. Tokat bujqësore po shfrytëzohen shumë edhe për nevoja të tjera, që si pasojë, sipërfaqet e tokave të tilla po zvogëlohen në vazhdimësi. Ngastrat e fermave bujqësore janë shumë të vogla (mesatarisht 1 – 2 ha) dhe si të tilla kryesisht janë të orientuara për prodhim familjar, kurse vetëm një pjesë e vogël e prodhimit i dedikohet tregut. Analizat e shumta ekonomike tregojnë se blegtoria (prodhimi dhe përpunimi i qumështit dhe mishit), prodhimi i bimëve për ushqimin e kafshëve, prodhimi i perimeve dhe pemëve, janë sektorë, që duhet të trajtohen me përparësi. Kosova ka traditë dhe kushte mjaft të favorshme agroekologjike për këto prodhime. Zhvillimi i këtyre sektorëve do të mundësonte edhe zvogëlimin dhe zëvendësimin e importit dhe do të jetë shtytës për zhvillimin e industrisë përpunuese. Zhvillimi i pamjaftueshëm i industrisë përpunuese paraqitet si kufizim në zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Mungesa e infrastrukturës, sidomos e asaj rrugore, në vendbanimet rurale, po ashtu, është njëri ndër faktorët kufizues në rritjen e prodhimtarisë bujqësore. Varfëria në këto zona, mundësitë e vogla për aktivizimin e kapaciteteve prodhuese të fermerëve, janë ndër faktorët kryesorë, që ndikojnë në migrimin e popullatës në drejtim të qendrave urbane. Në këtë punim jepen të dhëna për gjendjen aktuale të bujqësisë, si dhe propozimet për një

zhvillim të mirëfilltë të kësaj dege të rëndësishme ekonomike.

HYRJE

Në këtë punim analizohen resurset që ka Kosova në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, sfidat që ka sektori dhe mundësitë e zhvillimit të bujqësisë si degë e rëndësishme e ekonomisë së vendit. Në punim janë analizuar raporte të ndryshme, që kanë të bëjnë me sektorin, kushtet agroekologjike që posedon vendi dhe identifikimi i përparësive që mund të ketë Kosova në prodhimin bujqësor në raport me kërkesat e tregut dhe të vendeve të rajonit.

Raporte të shumta studimore, tregojnë se bujqësia llogaritet si segment i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik në Kosovë (si për nga aspekti i prodhimit po ashtu edhe punësimit). Megjithatë, ky sektor ballafaqohet me vështirësi nga më të ndryshmet, dhe si i këtillë ende nuk po mundet të jetë konkurrent në raport me produktet bujqësore që importohen në Kosovë.

Bujqësia është njëri ndër sektorët ekonomik më të dëmtuar gjatë luftës. Dëmtimet janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga infrastruktura rurale, shkatërrimi gati në tërësi i industrisë përpunuese ushqimore si dhe rënie e theksuar e rendimenteve të kulturave bujqësore. Përveç dëmeve të drejtpërdrejta, kjo situatë e krijuar ka ndikuar edhe në humbjen e tregjeve të produkteve bujqësore të Kosovës. Fermerët, menjëherë pas luftës, janë përballur me probleme ekzistenciale, që kanë pasur të bënin me meremetimin e shtëpive dhe me nevoja të tjera elementare. Në këtë situatë ata nuk kanë qenë në gjendje të bëjnë investime për rimëkëmbjen e ekonomive familjare. Kësaj situatë në masë të konsiderueshme i ka ndihmuar edhe mungesa e investimeve në bujqësi për një kohë të gjatë, e cila po vazhdon edhe sot. Si pasojë e kësaj situatë, Kosova është kthyer në një importues të prodhimeve bujqësore.

Ky sektor në GDP merr pjesë me rreth 25%, dhe me 25% deri 30% të numrit të përgjithshëm në sektorin informal. Gjithashtu, në eksportin e përgjithshëm merr pjesë me rreth 15%.

KUSHTET AGROEKOLGJIKE

Kosova ka sipërfaqe prej 10.887 km². Tokat bujqësore përfshijnë 577.000 ha. Nga kjo vetëm 272.040 ha apo 47.1 për qind janë toka të mbjella me kultura të ndryshme, ndërkaq, pjesa tjetër iu

takon livadheve, kullotave dhe djerrinave. Nga sipërfaqet e mbjella, dominojnë drithërat, kryesisht gruri, misri dhe elbi. Nga këto sipërfaqe, mbi 95 për qind janë në pronësi private. Pjesa tjetër, që ka qenë pronë shoqërore, është në përfundim të procesit të privatizimit.

Shumica e fermave në Kosovë janë të vogla dhe në masën më të madhe ato janë të orientuara në prodhimin për nevojat e familjes. Vetëm një sasi e vogël e prodhimit në fermë i dedikohet tregut. Fragmentimi i ngastrave të tokës bujqësore, që disponojnë fermerët, ka qenë i vazhdueshëm.

Toka bujqësore i është nënshtruar shfrytëzimit shumë të madh edhe për nevoja të tjera. Kjo ka bërë që sipërfaqet me tokë bujqësore të zvogëlohen në vazhdimësi. Është konstatuar se për çdo vit së paku 1.000 ha tokë bujqësore shndërrohen në zona ndërtimi.

Humbja e sipërfaqeve punuese është proces i pashmangshëm (nevojat për objekte banimi, kapacitetet përpunuese etj.). Megjithatë, ka shumë vite që problemi i shkatërrimit të sipërfaqeve punuese të ne ka marrë trende tepër shqetësuese.

Faktorët që e ndihmojnë këtë proces janë të ndryshëm: mungesa e infrastrukturës ligjore-apo mosrespektimi i saj, faktorët ekonomikë, mosinteresimi i fermerëve për ta shfrytëzuar tokën për qëllime bujqësore, si rezultat i profitabilitetit të ulët.

Problemi i ruajtjes së sipërfaqeve punuese është shumë kompleks dhe si i tillë kërkon edhe një qasje më serioze gjithëpërfshirëse. Ruajtja e sipërfaqeve punuese duhet të ndiqet me infrastrukturë ligjore, e cila do të ketë një zbatueshmëri të kënaqshme, dhe me masa stimuluese për prodhuesit, në mënyrë që ata ta shohin edhe vetë interesin e ruajtjes së sipërfaqeve të punueshme.

Prodhimi i ushqimit për popullatën, e cila është në rritje të vazhdueshme, bëhet në sipërfaqe të njëjta. Në përmasa globale, deri tani rritjen e prodhimit të ushqimit e ka ndjekur rritja e popullsisë, por shtrohet pyetja se deri kur kjo është e mundur.

Megjithëse është një territor relativisht i vogël, Kosova veçohet me tipa të ndryshëm tokash. Një kundërshti e tillë është rezultat i strukturës gjeologjike, pedologjike, klimës, florës e faunës dhe hidrografisë. Tipi i tokës së Kosovës me përbërje të volitshme pedologjike dhe me cilësi të lartë agrokimike sillet rreth 15%, me cilësi të mesme 30% dhe me cilësi të dobët 55%. Tokat me cilësi të lartë dhe të mesme agropedologjike përbëjnë 45% të sipërfaqes së përgjithshme. Tipat e tokave me cilësi të dobët shtrihen në pjesët kodrinore dhe malore të Kosovës.

Në Kosovë mbizotëron klima e mesme kontinentale, e cila kushtëzohet nga lartësia mbidetare. Ekzistojnë dy regjione prodhuese bujqësore, të cilat dallohen me disa veçori: Rrafshi i Kosovës me klimë tipike kontinentale, ndërkaq, Rrafshi i Dukagjinit ka klimë më të butë, që përmes lumit Drini i Bardhë ndikohet nga klima mesdhetare. Në këtë regjion është e koncentruar më tepër prodhimtaria e perimeve dhe pemëve e më pak drithërat. Ky regjion posedon sipërfaqe më të mëdha nën sisteme të ujitjes, që po ashtu krijojnë përparësi për kultivimin e bimëve me vlerë të lartë.

Reshjet mesatare vjetore në pjesën lindore të Kosovës sillen në 660 mm dhe me temperaturë mesatare vjetore 11.5°C. Në Rrafshin e Kosovës mbillen më tepër drithërat dhe patatja. Edhe në këtë regjion mund të hasen edhe prodhues mjaft të mirë të pemëve dhe perimeve, siç janë ata të Anamoravës.

Marrë në përgjithësi, kushtet klimatike e vënë Kosovën në një disavantazh të vogël në krahasim me rajonet e tjera brenda EJT-it (Tab. 1.). Megjithatë, edhe brenda këtyre kushteve ka hapësirë të pashfrytëzuar për të zhvilluar bujqësi konkurrenente me vendet e tjera, sidomos ato të regjionit.

Tab. 1. Krahasimi i ditëve me temperaturë të volitshme për fillimin e mbjelljeve të kulturave bujqësore në Kosovë dhe rajon

Stacioni klimatik dhe vendi	Numri i ditëve pa acar	Dita e parë e mbjelljes
Shqipëri – Tiranë	339	shkurt
Kosovë – Prishtinë	220	fundi i prillit
Bosn. – Herc. Sarajevë	269	prill
Maqedoni - Shkup	281	fillimi i prillit
Serbi - Beograd	307	fundi i marsit
Greqi – Athinë	363	janar
Itali – Romë	352	mars
Bullgari - Sofje	252	prill
Hungari - Budapest	270	prill
Kroaci - Zagreb	276	prill


BB, Raport nr. 53185-XK

Kjo mund të ilustruhet edhe me faktin se edhe prodhimet në të shumtën e rasteve mund të realizohen me mjaft sukses brenda këtyre konditave klimatike dhe importohen me sasi mjaft të mëdha.

Sistemet e ujitjes ende nuk mundësojnë ujitjen e sipërfaqeve, në të cilat ka kushte për ujitje¹. Në kohë të fundit ka përpjekje për përmirësimin e sistemeve të ujitjes, kryesisht në rehabilitimin e sistemeve ekzistuese. Sistemet e ujitjes në Kosovë paraqiten si faktor kufizues në prodhimtarinë bujqësore.

PRODIMI BUJQËSOR

Në strukturën e përgjithshme të të mbjellave, drithërat, kryesisht gruri dhe misri, zënë sipërfaqen më të madhe me rreth 150.000 ha. Bimët industriale: luledielli, panxharsheqeri, duhani, që dikur zinin sipërfaqe relativisht të mëdha, si pasojë e shkatërrimit gati në tërësi të industrisë përpunuese, pothuajse nuk mbillen fare. Në sipërfaqe diç më të mëdha mbillet elbi dyreshtor për nevojat e Fabrikës së Birrës.



Graf. 1. Struktura e të mbjellave

Edhe pse në vitet e fundit vërehet një interesim i shtuar i fermerëve, por edhe i disa kompanive private që të shtojnë sipërfaqet me drithëra për farë, posaçërisht për grurë dhe elb, kjo prodhimtari, për shkak të problemeve nga më të ndryshmet, është larg përmbushjes së nevojave për farë të këtyre bimëve (Graf. 1.). Zhvillimi i këtij

¹ Vlerësohet se në Kosovë ka mundësi të ujitjen rreth 200.000 ha.

sektori mundëson rritjen e produktivitetit të këtyre kulturave dhe uljen e çmimit të prodhimit.

Në krahasim me potencialin gjenetik të kulturave bujqësore dhe kushtet që ofron Kosova, rendimentet që merren nga ato janë shumë të ulëta. Prodhimtaria e ulët dhe çmimet e larta të prodhimit janë faktorët që ndikojnë në pamundësinë e të qenit konkurrent në raport me prodhimet që vijnë nga importi.

Si rast pozitiv në këtë drejtim mund të përmendet patatja, e cila, si për nga sipërfaqet po ashtu edhe për nga rendimentet, ka tendencë të rritjes. Kosova ka kushte shumë të favorshme agroekologjike për kultivimin e patates. Megjithatë, problem mbetet prodhimi i farës së patates. Është me shumë interes që të shfrytëzohen disa regjione, që janë shumë të favorshme për shumëzimin e farës së patates, siç janë regjioni i Dragashit, Shalës së Bajgores etj. Marrë në përgjithësi, kjo kulturë është potencial i mirë për eksport.

Edhe në pemëtari situata është e ngjashme, me gjithë kushtet mjaft të favorshme agroekologjike që ka Kosova për këtë prodhimtari. Si pasojë e mosmirëmbajtjes së pemishteve, sidomos atyre që kanë qenë në sektorin shoqëror, pothuajse ato janë shkatërruar në tërësi. Ngritja e pemishteve të reja është më e ngadalshme, për shkak të mungesës së investimeve në këtë sektor në krahasim me sektorë të tjerë. Fermerët kryesisht janë të orientuar në ata sektorë të cilët kthimi i investimeve është më i shpejtë. Fermerët me traditë, të cilët mbjellin pemë në kopshte, kryesisht për nevojat e familjes, janë ende mbizotërues në prodhimin e përgjithshëm të tyre.

Pothuajse gjysma e prodhimit të pemishteve vlerësohet se shfrytëzohet në fermë, ndërkaq, një pjesë prodhohet për treg për konsumim në gjendje të freskët. Një ndër pemët kryesore në Kosovë është molla, me rendiment relativisht të mirë si në sasi po ashtu edhe në cilësi. Por, aktualisht, mungojnë objektet përkatëse për ruajtjen e tyre për një periudhë më të gjatë e që do t'iu mundësonte fermerëve të përfitojnë me çmime më të larta jashtë sezonit prodhues.

Situatë e ngjashme është me vreshtat. Problemi i tyre është mjaft kompleks, pasi që prodhimi i rrushit, edhe pse shumë më i vogël në krahasim me prodhimin e mëhershëm, përballet me mungesë të tregut. Si pasojë e situatës nëpër të cilën ka kaluar edhe me gjithë traditën e gjatë në kultivimin e rrushit dhe prodhimin e verës dhe rakisë, Kosova ka mbetur mbrapa në mundësinë e saj që të prodhojë verë për tregun regional dhe atë ndërkombëtar. Aktualisht, pothuajse është humbur tregu i verës që ka ekzistuar para luftës për nga sasia e eksportit. Me

zvogëlimin e sipërfaqeve të vreshtave assesi nuk mund të kompensohet sasia e verës që ka ekzistuar për eksport.

Edhe pse Kosova ka kushte mjaft të favorshme për zhvillimin e blegtorisë, ato nuk janë të shfrytëzuara as për së afërmi. Prodhimet blegtorale janë të destinuara kryesisht për nevoja të familjes, ndërkaq, vetëm një sasi e vogël është e destinuar për treg.

Pas luftës, u vlerësua se mbi 50% e fondit blegtoral në Kosovë është humbur. Po ashtu edhe pjesa dërrmuese e infrastrukturës blegtorale është dëmtuar. Kjo situatë ka shkaktuar mungesë të kafshëve dhe prodhimeve të tyre. Për këtë shkak nevojat e popullatës për kafshë dhe prodhime blegtorale plotësohen nga importi. Me gjithë përkrahjen nga donatorët dhe investimet private, blegtoria në Kosovë është ende në nivel, që nuk arrin t'i përmbushë nevojat e vendit. Megjithatë, bazuar në kushtet që ka Kosova, mund të konstatohet se në këtë sektor ekzistojnë hapësira të mëdha për zhvillim.

Një prej kufizimeve, që ndikon në rritjen e prodhimit bujqësor, është edhe sektori ende i pazhvilluar sa duhet i përpunimit të prodhimeve bujqësore. Që nga përfundimi i luftës janë zhvilluar disa ndërmarrje private në sektorin e agropërpunimit, sidomos mullinj për prodhimin e miellit, mullinj për përgatitjen e ushqimit të kafshëve, përpunimit të pijeve alkoolike dhe lëngjeve, prodhimeve të qumështit, që kanë marr një zhvillim më të madh. Problemet kryesore në sektorin e agropërpunimit janë mungesa e mjeteve financiare, furnizimi i dobët me lëndë të parë, çmimet e larta për lëndë të parë, si dhe humbja e tregut të jashtëm.

TREGU I PRODHIMEVE BUJQËSORE

Humbja e tregjeve tradicionale dhe mungesa e përkrahjes së nevojshme të bujqësisë kanë kushtëzuar rënie të vazhdueshme të këtij sektori. Si pasojë e kësaj situatë, Kosova është kthyer në një importues të prodhimeve bujqësore. Mjaft shqetësues është edhe fakti se importi ka shënuar rritje në vazhdimësi dhe nuk është arritur që jo vetëm të zvogëlohet, por as të mbahet në kufijtë e mëparshëm. Kështu, p.sh, përderisa në vitin 2006, importi i produkteve bujqësore ka qenë 319.425.000 €, në vitin 2010 ka arritur në 487,452.000 € (Tab. 2.). Në anën tjetër, eksporti në krahasim me importin është pothuajse simbolik.

Tab. 2 . Shkëmbimi tregtar për prodhimet bujqësore
(shprehur në 000 €)

Viti	Importi	Eksporti	Deficiti	Pjesëmarrja në %	
2006	319,425	11,646	-307,778	96.35	3.65
2007	384,111	18,134	-365,977	95.28	4.72
2008	417,696	20,763	-396,933	95.62	4.97
2009	434,369	19,993	-414,376	95.4	4.60
2010	487,452	20,338	-467,114	95.78	4.22

MBPZHR, 2011

PYLLTARIA

Pyjet përbëjnë rreth 41 për qind të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës, ose rreth 455.000 ha. 56 për qind janë në pronësi shoqërore dhe 44 për qind janë pronë private. Prerja ilegale e drurit si dhe zhvillimi i bujqësisë, industrisë dhe urbanizimi, shkaktojnë stresse në sektorin e pylltarisë. Problem i posaçëm akut është prerja joligjore e drurit. Varfëria e shoqëruar me ndërprerje të furnizimit të rrymës e shtyn popullatën të mbështetet më shumë në drurin për nxehje.

Vlera vjetore e prodhimeve dhe e përfitimeve të tjera nga pyjet dhe tokat pyjore sillet nga 50 - 75 milionë €. Potenciali i tanishëm kontribuues i sektorit të pylltarisë në BPV është ndërmjet 1.8% dhe 2.6%. Me investime, kjo mund të rritet në 3-4% të BPV.

INFRASTRUKTURA RURALE DHE NDËRMARRËSIA RURALE

Edhe pse në vitet e fundit ka pasur disa investime në zonat rurale, megjithatë, vendbanimet rurale në përgjithësi e ato kodrinore malore në veçanti karakterizohen me mungesë të madhe të infrastrukturës, posaçërisht të asaj rrugore. Në fakt kjo paraqitet si njëri nga faktorët më kufizues në rritjen e prodhimtarisë bujqësore, në njërin anë, si dhe një nga faktorët vendimtar, në anën tjetër, që determinojnë vendimin për ta braktisur fshatin, duke pasur parasysh transportin e vështirësuar dhe ofertën shumë të varfër të shërbimeve.

Gjithashtu, edhe furnizimi me ujë të pijshëm në viset rurale të Kosovës ende nuk është i atillë që të mundësojë furnizim cilësor. Një numër vendbanimesh, që gjenden bri rrugëve magjistrale apo afër qyteteve të mëdha, janë të lidhura me sistemet e ujësjellësit publik. Në

shumë fshatra kanë ndërtuar me vetëkontribut sisteme të vogla të ujësjellësve lokalë, cilësia e të cilëve nuk kontrollohet sa duhet.

Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje, si dhe dendësinë e popullsisë, është e qartë se në kushtet e Kosovës vetëm bujqësia nuk mund të sigurojë zhvillim të suksesshëm rural. Për të mbështetur zhvillimin e zonave rurale, një rëndësi të posaçme duhet t'i kushtohet nxitjes së kulturës ndërmarrëse dhe zhvillimit edhe të bizneseve jobujqësore, që do të thotë bizneseve familjare komplementare.

Situatë e ngjashme është edhe me rrjetet e ujit të pijshëm, kanalizimit, ofrimit të shërbimeve shëndetësore etj.

Në bazë të analizave të shumta, mund të thuhet se zhvillimi i sektorit jobujqësor në zonat rurale mund të ndikojë dukshëm në ngritjen e nivelit të të ardhurave dhe në uljen e papunësisë, pasi që efekti i sektorit të bujqësisë është i vogël në këtë aspekt.

Ka disa iniciativa, që kanë filluar në viset rurale, si „p.sh., zhvillimi i disa bizneseve, që mund të kenë perspektivë edhe më tutje, si përpunimi i drurit, që kohëve të fundit mjaft shumë po zhvillohet, pastaj përpunimi i produkteve bujqësore, biznese për grumbullimin e kërpudhave dhe fryteve të tjera pyjore, bletaria, bimët mjekuese etj.

Është shumë i rëndësishëm fakti se në disa nga veprimtaritë ka traditë shumë të mirë të ne dhe është shumë e rëndësishme që këto veprimtari të përkrahen nga institucionet përkatëse. Mund të konsiderohet se edhe këtu ka shumë hapësirë të pashfrytëzuar, e cila do të ishte burim i rëndësishëm i gjenerimit të vendeve të punës dhe të ardhurave për familjet rurale.

Një mundësi tjetër ka të bëjë me turizmin fshatar, që është fare pak i pranishëm. Përveç disa iniciativave individuale, në përgjithësi nuk ka asnjë investim publik në këtë sektor. Regjione të tëra në shumë pjesë të Kosovës, që ofrojnë kushte shumë të favorshme për këtë veprimtari, janë plotësisht të pashfrytëzuara. Në raste të rralla mund të hasen disa aktivitete të vogla hoteliere, të cilat assesi nuk janë në gjendje që të jenë gjeneratorë të zhvillimit të këtij sektori.

KONKLUZIONE

Me gjithë kushtet relativisht të favorshme agroekologjike, situata në të cilën ndodhet bujqësia sot ka ndikuar që ajo të mos jetë aspak tërheqëse si veprimtari ekonomike, pra konsiderohet zgjedhja e fundit për aktivitet ekonomik.

Humbja e tregjeve tradicionale dhe mungesa e përkrahjes së nevojshme të bujqësisë kanë kushtëzuar rënie të vazhdueshme të këtij sektori. Si pasojë e kësaj situatë, Kosova është kthyer në një importues të prodhimeve bujqësore. Kjo tendencë duhet ndalur me një qasje më komplekse, duke filluar nga përmirësimet në teknikat e prodhimit deri te marketingu i prodhimeve bujqësore.

Është nevojë urgjente ndalja e shkatërrimit të mëtejshëm të tokës bujqësore, me qëllim që të paktën të ruhet fondi i tanishëm i tokës. Ruajtja e sipërfaqeve punuese duhet të përcillet me infrastrukturë ligjore, e cila do të ketë një zbatueshmëri të kënaqshme dhe masa stimuluese për prodhuesit, në mënyrë që ata ta shohin edhe vetë interesin e ruajtjes dhe shfrytëzimit të sipërfaqeve të punueshme.

Rritja e produktivitetit duhet të jetë aktivitet kyç me qëllim që fermerët tanë të jenë konkurrent me prodhuesit bujqësorë të vendeve të tjera. Kjo mund të arrihet përmes një mbështetje të fuqishme financiare dhe teknike. Gjithashtu, është me rëndësi që të përkrahen sektorët, posaçërisht ata sektorë, në të cilët fermerët tanë mund të jenë konkurrent në treg, siç janë prodhimet blegtorale, pemët dhe perimet. Shfrytëzimi i këtyre prioriteteve duhet të ketë për bazë edhe nevojat strategjike të vendit për ushqim. Në të vërtetë, në gjendjen që është, janë gjasat e vogla që bujqësia të jetë faktor kyç i zhvillimit rural dhe ekonomik në përgjithësi.

Pyjet i janë nënshtruar dëmtimit të madh. Për shkak të varfërisë dhe ndërprerjes së furnizimit të rrymës, e shtyn popullatën të mbështetet më shumë në drurin për nxehje. Po ashtu, në këtë sektor ka edhe mundësi për zhvillimin e gjetisë dhe agroekoturizmit, për arsye se banorët që jetojnë në këto zona ende mbajnë kontakte të afërta me traditat e tyre rurale/pyjore, si dhe për shkak të mungesës relative të ndotjes.

Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje, vetëm bujqësia nuk mund të sigurojë zhvillim të suksesshëm rural. Zhvillimi i sektorit jobujqësor në zonat rurale mund të ndikojë dukshëm në ngritjen e nivelit të të ardhurave dhe uljen e papunësisë.

REFERENCA

World Bank; Raport nr. 53185-XK , KOSOVA “Zhblllokimi i potencialit për rritje ekonomike: strategjitë, politikat, veprimet”, Memorandumi ekonomik i shtetit , 29 prill 2010 , Njësia për zvogëlimin e varfërisë dhe menaxhimin ekonomik , Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore.

- MBPZHR, Të dhëna për importin e prodhimeve bujqësore, ESK, Statistika e Bujqësisë dhe Mjedisit, Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, 2008.
- European Agency for Reconstruction, The Agricultural Supply Chain in Kosovo: A Study of key aspects, May 2005.
- Jan van Aghthoven &Skënder Kaçiu, High Value Irrigated Crops, The European Agency for Reconstruction's Rural Development Programme for Kosovo, 2004.
- MBPZHR, Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2009-13, Prishtinë, 2009,
- MEF, korrik, Korniza afatmesme e shpenzimeve, Prishtinë, 2008.
- MTI, Politika Tregtare e Kosovës, Prishtinë, 2009.
- N. Daci, S. Berisha, A. Zajmi, Kosova - Strategjia e Zhvillimit Ekonomik, Prishtinë, 2002.
- Riinvest , Forest Industry Challenges of Development and Balanced Use, Prishtinë, janar 2008.
- Riinvest, Zhvillimi Rural në Kosovë, (Raport hulumtues), Prishtinë, 2004.
- World Bank Kosovo Poverty Assessment October, 2007.

Muhamet MUSTAFA

MJEDISI INSTITUCIONAL DHE SHFRYTËZIMI EFEKTIV I BURIMEVE NATYRORE

Rezyme

Në këtë punim trajtohet një përmbledhje jo e detajuar e diskutimeve teorike lidhur me atë se çfarë janë përvojat e vendeve që zhvillimin e vet e bazojnë në eksportin e burimeve natyrore . Diskutohet, gjithashtu, diskursi mbi bekimin ose mallkimin e resurseve, si dhe shtrohen disa pikëpamje lidhur me atë se cilat janë elementet kryesore të krijimit të një mjedisi institucional, i cili do të bënte të mundur një drejtpeshim midis interesave (përfitimeve dhe kostove) financiare, ekonomike dhe sociale . Ky mjedis institucional do të evitonte monopolin në përfitimet nga eksploatimi i burimeve natyrore për grupe të caktuara të ngushta ekonomike e politike dhe do të stimulonte zhvillim të qëndrueshëm. Kosova gjendet para sfidës që ta ndërtojë këtë kornizë institucionale dhe të ngrejë kapacitetet e veta për shfrytëzimin e burimeve natyrore në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Terma kyç: burimet natyrore, mallkimi i resurseve, bekimi i resurseve, Cost- benefit, institucionet, transparenca .

BURIMET NATYRORE SI FAKTORË ZHVILLIMI

Prodhimet primare (produktet bujqësore dhe pasuritë minerare), kanë dominim në strukturën e prodhimit , të të ardhurave dhe eksportit te vendet në zhvillim . Duke u nisur nga stadi i zhvillimit të tyre teknologjik, këto vende janë të shtrënguara të shfrytëzojnë faktorët e mundësitë që kanë, të cilat shpesh konsistojnë, para së gjithash, në shfrytëzimin e pasurive natyrore, për t'u inkuadruar në tregun botëror nëpërmjet eksportimit të pasurive natyrore dhe produkteve primare. Eksporti i këtyre produkteve te këto vende paraqitet ai parakusht për të zgjeruar mundësitë e konsumit. Kjo, gjithashtu, mund të ndihmojë në akumulimin e

faktorëve të tjerë si puna dhe kapitali: FDI, kursime vendore, shkathtësi të punëtorëve. Eksporti i produkteve primare në një pjesë mbahet si kursim, në të shumtën e rasteve, nga Qeveria dhe mund të investohet në sektorë të tjerë. Në këtë aspekt eksploatimi dhe eksporti i pasurive natyrore mund të ndikojë në nxitjen e zhvillimit të sektorëve të tjerë, duke pasuruar strukturën ekonomike të një vendi :

(a) nëpërmjet ndërlidhjeve me sektorë të tjerë dhe ndikimit në një zhvillim më të gjerë, duke u ndërlidhur me prodhimin e inputeve dhe përpunimin e tyre (p.sh., xehja dhe përpunimi i saj, “Trepça” në vitet 70) dhe (b) rritjen e kapaciteteve të buxhetit publik për të zhvilluar konsumin, infrastrukturën dhe duke përmirësuar kapitalin njerëzor, përkatësisht duke rritur shkathtësitë e fuqisë punëtore dhe të ardhurat e Qeverisë) .

Së këndejmi, në fazat initiale të zhvillimit duket se është e pashmangshme që vendet e caktuara ta bazojnë zhvillimin e tyre në shfrytëzimin e burimeve të tyre natyrore. Sesi do të jetë rruga e zhvillimit, kjo varet, para së gjithash, sesi një ekonomi i zhvillon aftësitë e saja konkurruese jashtë sektorit të shfrytëzimit të pasurive natyrore , veçanërisht sesi zhvillohet aftësia konkurruese e sektorëve të caktuar në kuadër të ndërlidhjeve sektoriale në një ekonomi, si dhe nga diversifikimi i strukturës së produkteve dhe shërbimeve, të cilat mund të konkurrojnë në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm¹. Ndërlidhja e konsumit me efektet propulsive ka të bëjë me atë se në këto faza të zhvillimit krijohet një kërkesë shtesë agregate e iniciuar nga rritja e pagave dhe shpërndarja e tyre.

Në kushtet kur fondet e krijuara nga shfrytëzimi racional i burimeve natyrore përdoren efektivisht për të ngritur kapacitetet e kapitalit human, mund të pritët se mund të zhvillohet një spektër ndikimesh, në kuadër të të cilave fuqia e aftësuar punëtore mund të stimulojë ndërmarrësinë dhe sektorët e tjerë. Ndërlidhja pozitive në aspektin fiskal vijues mund të krijohet kur renta, përkatësisht dividenda , si të ardhura buxhetore, fuqizojnë elemente të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social , por këtu, siç do të elaborohet më vonë, një rëndësi kruciale ka mënyra e krijimit dhe shfrytëzimit të këtyre fondeve. Ndërlidhja tjetër potenciale pozitive në ecuritë e zhvillimit shtrihet në fushën infrastrukturave, përkatësisht në zhvillimin e rrugëve, të hekurudhave, të sektorit të energjisë, sektorit të ujit , sektorit të telekomunikimeve dhe në saje të këtyre krijohen shanse për një zhvillim me një platformë më të gjerë, përkatësisht zhvillim në sektorë të tjerë.

DISKUTIMET TEORIKE DHE EVIDENCA EMPIRIKE/ BEKIMI APO MALLKIMI I RESURSEVE

Duke u nisur nga ajo që u tha më lart, deri në vitet 50, në shqyrtimet teorike të ndërlidhura me **ekonomiksin** ? e zhvillimit, pasuritë natyrore konsideroheshin si forca motorike e zhvillimit. Megjithatë, kërkimet e mëvonshme, të bazuara në një evidencë solide empirike, kanë vënë në dyshim efektivitetin e zhvillimit të bazuar në shfrytëzimin e pasurive natyrore, përkatësisht në zhvillimin e bazuar në eksportin e produkteve primare. Kështu, sipas një studimi të gjerë nga Sachs dhe Warnerⁱⁱ, i cili në një platformë të gjerë ka zhvilluar kërkime për 95 vende, duke nxjerrë një konkludim se brenda viteve 1971 -1989, vendet e pasura me burime natyrore, janë rritur më ngadalë sesa ato të varfra me burime. Këtë ecure e ka përcjellë edhe historiku i zhvillimit të Kosovës dhe viseve të tjera të pasura me burime natyrore në ish-Jugosllavi. Kjo fuqizohet edhe me një fakt tjetër. Evidenca qartazi tregon se derisa në tri dekada të fundit të shekullit të kaluar prodhimi industrial është rritur 3.9%, në kohën kur prodhimi i lëndëve të para është rritur vetëm 1.5%.ⁱⁱⁱVendet me rritje më të shpejtë ekonomike, sidomos pas Luftës II Botërore (Japonia dhe vendet e Azisë Juglindore (Koreja Jugore, Tajvani, Hong-Kongu, Singapori) e edhe disa vende të tjera evropiane si, për shembull, Irlanda. Kina ka një rritje të shpejtë ekonomike gati katër dekada, por ajo rritje ekonomike bazohet në eksportin e produkteve finale ose komponentëve sekondarë e jo produkteve primare dhe pasurive natyrore. Nga ana tjetër, nga grupi i vendeve të pasura me burime natyrore fare pak vende kanë pasur një performancë të mirë. Në këtë grup përmenden fare pak raste e ndër to Botsvana, Malajzia, Indonezia, Tunizia. Ndonëse në këto diskutime ka pasur edhe zëra të kundërt, është fakt i pamohueshëm se vendet të cilat zhvillimin e tyre e kanë bazuar në eksportin e lëndëve të para kanë ngelur prapa në dinamikën e rritjes ekonomike dhe zhvillimit ekonomik, të matur sipas treguesve çfarë janë GDP/ capita ose indeksi i zhvillimit njerëzor (HDI). Përjashtim këtu mund të jenë vetëm disa vende, që njihen si eksportues të mëdhenj të derivateve të naftës.

Nisur nga evidenca empirike, që u prezantua më lart, në teorinë e zhvillimit ekonomik ka filluar të trajtohet i ashtuquajtur i fenomeni i njohur me sintagmën “ Mallkimi i resurseve”/ (Resource Curse) si një kundër tezë e “ Bekimit të resurseve/ Resource Bless, sipas të cilit botëkuptim vendet e pasura me burime natyrore janë të bekuara. Duke qenë se në historinë e re të zhvillimit ekonomik, që

nga vitet 50 e këndej fenomeni i” Mallkimit të burimeve”, karakteristikë për vendet e pasura me burime, por me popullsi të varfër, ka qenë një fakt, atëherë shqyrtimet teorike janë përqendruar edhe në shpjegimin e shkaqeve që kanë sjellë një gjendje që përshkruhet me sintagmën e përmendur . Këto shkaqe janë kryesisht të lidhura me një sërë barrierash zhvillimore, në të cilat hasin vendet që zhvillimin e tyre e bazojnë në eksportin e produkteve primare, përkatësisht të pasurive natyrore. Midis këtyre shkaqeve duhet përmendur :

- Fenomeni që i përshkruhet Ligjit të Engelsit, sipas të cilit kërkesa për ushqim dhe pije rritet më ngadalë sesa të ardhurat, prandaj rritja e nivelit të zhvillimit rrit kërkesën për produkte finale industriale dhe shërbime me vlerë të lartë shtuese e me këtë edhe çmimet e këtyre produkteve dhe shërbimeve , andaj vendet që i zhvillojnë ato kanë një rritje më të shpejtë ekonomike.
- Ndryshimet teknologjike reduktojnë konsumin e burimeve primare (substituimi i sintetikës për leshin; ose fijet optike për përçuesit e bakrit dhe si pasojë e kësaj bie kërkesa dhe bashkë me këtë edhe çmimet e këtyre burimeve natyrore në tregun botëror.
- Keqësimi i kushteve të tregtimit (Terms of trade), pasi që raporti midis çmimeve të produkteve që importohen (pajisjet, teknologjia, know how, mallrat e caktuara të konsumit etj.) rriten relativisht në krahasim me çmimet e produkteve dhe shërbimeve që eksportohen (lexo: lëndë të para dhe minerale – produkte primare). Duke e konstatuar këtë Perbisch & Singer ,pasi që konstatojnë se në një periudhe afatgjatë çmimet e lëndëve të para bien relativisht në krahasim me produktet industriale. Ky fenomen në teorinë e zhvillimit njihet si “Pesimizmi i eksportit^{iv}”.
- Një fenomen tjetër në dëm të këtyre vendeve njihet si e ashtuquajtura “Epidemia holandeze”, e cila ndikon negativisht në drejtpeshimin makroekonomik, ngase të ardhurat devizore nga eksporti i pasurive natyrore rritin kursin e këmbimit duke ndikuar negativisht në eksportin e produkteve dhe shërbimeve të tjera, përveç lëndëve të para dhe mineraleve e kjo e nxit nga ana tjetër edhe inflacionin.

Përveç fenomeneve dhe lëvizjeve të përmendura e të cilat origjinën e kanë në lëvizjet afatgjatë në tregun botëror , një mori faktorësh të tjerë, që burojnë nga mjedisi institucional, dhe lidhen me nivelin e zhvillimit të institucioneve demokratike. Institucionet shtetërore në pjesën dërrmuese të vendeve në zhvillim të pasura me burime minerare janë të brishta, sidomos parlamenti dhe gjyqësori, të cilat janë nën diktatin e grupeve të ngushta të interesit politik dhe të grupeve mafioze të ndërlidhura me qarqet qeveritare e që aranzhmanet mbi koncesionimin e shfrytëzimit të burimeve natyrore i përcjellin me kërkim të rentës jolegale dhe korrupsion. Një proces i brishtë , jo transparent buxhetor dhe pa elemente të llogaridhënies i shkon për shtati tjetërsimit të fondeve të krijuara nga eksploatimi i burimeve natyrore dhe vënien e tyre nën kontrollin e grupeve të korruptuara dhe e tërë kjo bën që efekti nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të mos pasqyrohet me tipare të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik, i cili, përveç rritjes afatgjatë ekonomike, nënkupton shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore, duke pasur parasysh nevojat dhe interesat e gjeneratave që vijnë e edhe një rritje ekonomike, nga e cila përfitojnë gjithë pjesëtarët e një shoqërie.

TRANSPARENCA DHE MJEDISI INSTITUCIONAL


Duket se një kombinim i faktorëve të disfavorshëm në tregun ndërkombëtar me institucionet jodemokratike, të brishta dhe të korruptuara, kanë bërë që zhvillimi i bazuar në eksploatimin e burimeve natyrore t'i përgjigjet më tepër një sintagme të njohur si “ mallkim i resurseve’ sesa asaj me tipare të kundërta si “ bekim i resurseve”. Duke qenë se ndikimet në tregun botëror dhe mekanizmat e tij të pavolitshëm kërkojnë instrument rregullues multinacional ku pozita e vendeve në zhvillim është e brishtë, një zgjidhje apo më mirë të themi një zbutje e këtij problemi mund të jetë përqendrimi në zhvillimin e një mjedisi institucional, që do të bënte të mundur një shfrytëzim më efektiv të burimeve natyre dhe në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Krijimi i një kornize institucionale, e cila do të siguronte një transparencë në të gjitha aranzhmanet dhe në procesin e eksploatimit të burimeve natyrore, është një nga parakushtet esenciale për ndryshimin e gjendjes në shumicën e vendeve në zhvillim, në kuptim të rritjes së të ardhurave dhe përfitimeve publike nga eksploatimi i burimeve . Transparenca dhe aranzhimi institucional duhet të përfshijë një sërë fushash^v si :

- Qasja në dokumente, kontrata dhe kushte të licencimit lidhur me koncesionet dhe aranzhmanet e tjera për eksploatimin e burimeve natyrore, si mënyrë e rregullimit të qasjes në këto dokumente^{vi};
- Qasja dhe posedimi i informatave mbi gjenerimin e të ardhurave nga eksploatimi i burimeve (mënyra e publikimit dhe qasjes së këtyre informatave);
- Korniza institucionale – ligjet , rregullat , rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë në menaxhimin e kontratave dhe të të ardhurave, procesi i kontrollit intern, eksterne dhe transparenca ; Këtu një rëndësi të madhe ka roli dhe përgjegjësitë e parlamentit^{vii}.
- Qeverisja kooperative e ndërmarrjeve publike, ku rëndësi të madhe ka përbërja e bordeve të drejtorëve dhe kompetenca dhe pavarësia e tyre, respektivisht evitimi i ndikimit të interesave të ngushta grupore dhe politike;
- Fondet e burimeve natyrore dhe qeverisja e tyre^{viii}. Këto fonde janë krijuar në disa vende si institucione, në të cilat derdhen pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të gjeneruara nga eksploatimi dhe eksporti i burimeve natyrore. në mënyrë që të investohet në kapitalin fizik dhe njerëzor në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm ;
- Transferet – ligjet dhe rregullat lidhur me ndarjen e të ardhurave midis niveleve të ndryshme të pushtetit, si, për shembull, pushteti lokal dhe komunitetet.
- Transparenca e industrive ekstraktive – publikimi i EITI^{ix}ku vendet anëtare publikojnë raporte mbi pagesat në kompanitë që eksploatojnë burime, raporte auditeve të pavarura e të ngjashme.

I gjithë ky spektër i aranzhmaneve institucionale , që përfshin edhe kornizën ligjore dhe institucionet përgjegjëse, do të duhej të siguronte përdorimin më efektiv të burimeve natyrore në dobi të zhvillimit të gjithëmbarshtëm, duke filluar te komunitetet pranë burimeve natyrore, te pushteti lokal dhe ai qendror. Në mungesë të një kornize të tillë, efektet nga eksploatimi i burimeve nuk shtrihen në gjithë shoqërinë , e raste eklatante janë problemet zhvillimore dhe ekzistenciale të komuniteteve minerare.^x Në kushtet kur kjo kornizë mungon, mund të pritet që efektet pozitive nga eksploatimi i burimeve privatizohen (ose kooperatizohen), kurse efektet negative (negative

externatilities) socializohen dhe mbesin barrë e shoqërisë.^{xi} Në këtë aspekt një identifikim i përfitimeve dhe i kostove ekonomike e sociale, nga eksploatimi i burimeve natyrore dhe i analizave të tyre transparente do të duhej ta shoqëronte gjithmonë marrjen e vendimeve lidhur me partneritetin publiko-privat gjatë eksploatimit të burimeve natyrore. Një analizë e tillë do të duhej të shërbente edhe si një bazë nisëse për ndërtimin e kriterëve të objektivizuara të të ardhurave në atë mënyrë që humbësit, ata që më së rëndi goditen nga kostot, të kompensohen nga ata që përfitojnë më shumë.^{xii}



Një analizë e mirëfilltë cost-benefit duhet të bëjë një dallim sa i përket interesit të aktorëve të ndryshëm në eksploatimin e burimeve natyrore (shih figurën më lart) :

1. Kostot dhe përfitimet sociale për të cilat është i interesuar investitori, i cili përqendrimin e ka te maksimizimi i profitit për kooperatën apo biznesin e tij.
2. Përfitimet e kostot ekonomike, të cilat shprehin kontributin e projekteve të shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe koston e tyre oportune nga aspekti i rritjes ekonomike dhe performancave të tjera të zhvillimi i ekonomisë nacionale për të cilat është e interesuar qeveria qendrore e një vendi dhe më në fund
3. Kostot dhe përfitimet sociale të ndërlidhura me ndikimet anësore (externalities) të projektit në aspekte urbane, mjedisore, shëndetësore dhe të tjera tek aktorët e tjerë të interesuar – komunitetet e caktuara dhe qeverisja lokale.

Praktika ka treguar se në shumicën e vendeve nuk është siguruar një qasje, që merr në konsiderim interesat, përkatësisht kostot dhe përfitimet e këtyre aktorëve. Historia e zhvillimit ekonomik që nga periudha e kolonializmit dhe ajo postkoloniale tregon qartas se në vendet postkoloniale dhe ato postkonfliktuale në trekëndëshin e mësipërm midis interesave financiare, interesave ekonomike dhe interesave sociale, favoret kanë shkuar nga ato financiare dhe nga investitorët, në të shumtën e rasteve, investitorë të jashtëm strategjikë dhe kompani ndërkombëtare. Kjo gjendje më shumë i ashpëson sesa që i ka zgjidhur konfliktet zhvillimore e sociale në disa vende. Vetëm një drejtpeshim i duhur midis që të tri aspekteve të kostove dhe përfitimeve të një projekti do të mund të krijonte një platformë për zhvillim të qëndrueshëm. Vendet në zhvillim kanë nevojë të madhe për teknologji të reja të avancuara dhe kapital financiar për të investuar në eksploatimin e burimeve natyrore. Andaj, ato duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për investime dhe të bëhen tërheqëse për investitorët^{xiii}. Në kushtet moderne të qeverisjes korporative dhe përgjegjësisë sociale të korporatave edhe korporatat serioze bëhen gjithnjë e më të vetëdijshme për domosdoshmërinë e kujdesit për të siguruar drejtpeshimin midis këtyre tri palëve dhe iu ikin aranzhmaneve me qeveritë e korruptuara.

Në këtë aspekt, një analizë cilësore e përfitimeve dhe kostove (Cost- benefit) do të duhej të shërbente si bazë për përmirësimin e qeverisjes në dobi të përdorimit efektiv të burimeve natyrore për zhvillimin e vendit. Në këtë aspekt është e parapëlqyeshme që të ndërtohet përgjegjësia legale dhe ekonomike tek aktorët kryesorë.

Përgjegjësia legale, e cila do të përfshijë:

- Pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e konsultimit dhe marrjen e vendimeve;
- Një obligim që Kuvendi (Parlamenti) të obligohet të ratifikojë koncesionet dhe kontratat e rëndësishme (mbi një vlerë dhe kohëzgjatje të caktuar);
- Raportimi në Kuvend dhe në institucione të tjera dhe ndërtimi efikas i praktikave të transparencës.

Ndërkaq, përgjegjësia ekonomike përfshin:

- Arsytimi i investimeve në shfrytëzimin e burimeve natyrore sipas metodës së përfitimeve ekonomike dhe sociale dhe prezantimi i këtyre analizave në opinion;

- Krijimi i sistemit të evidentimit dhe raportimit transparent të të ardhurave;
- Krijimi i mekanizmave për ndarjen e kostove dhe përfitimeve dhe sigurimi i drejtpeshimit midis interesave sociale, ekonomike dhe financiare.

Kosova gjendet para sfidave serioze që të mësojë nga përvojat pozitive të shfrytëzimit të burimeve natyrore në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të krijojë kornizën institucionale, që është atraktive për investitorët, është në funksion të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në aspektin social.

REFERENCA DHE SHËNIME:

- ⁱ Një shembull i mirë për këtë është Malajzia, e cila ka diversifikuar me sukses strukturën e saj industriale dhe eksportuese. Kështu derisa eksporti i produkteve primare merret pjesë rreth 90% të totalit të eksporteve më 1965, në fund të viteve 90 rreth 80% e vlerës së eksporteve në produktet industriale të një niveli më të lartë përpunimi(World Development Report dhe World Development Indicators, World Bank , 2000;
- ⁱⁱ Jeffrey D. Sachs dhe Andrew W. Warner , Natural Resources and Economic Development , The Course of natural resources, European Economic Review (2001)
- ⁱⁱⁱ Brenda një qerek shekulli, që përfshin periudhën 1970- 1996 , vendet që kanë pasur një pjesëmarrje më të ulët të produkteve primare në eksporte kanë pasur rritje më të shpejtë të GDP: 0-5% pjesëmarrje ndaj rritjes ekonomike mesatare vjetore mbi 2.5%; 5-10% pjesëmarrje ndaj rritjes ekonomike vjetore 1.5%, 10-20% rritje ekonomike vjetore afër 1% dhe pjesëmarrje mbi 20% me rritje ekonomike mesatare nën 0.5% , sipas Radlet, Sachs dhe Wa Le: Economic growth in Asia, Harvard Institute for International Development, Cambridge, 1977.
- ^{iv} Perkins, Radlet, Lindauer, Economics of Development , W.W. Norton, faqe 669, 2006.
- ^v Revenue Watch Institute, Revenue Watch Index 2010.
- ^{vi} Një shembull i vështirësive në qasje në këtë lloj dokumentacioni mund të jetë, për shembull, kontrata e privatizimit të “Ferronikelit” në Drenas.
- ^{vii} Kështu, për shembull, në rastin e Kosovës , Kuvendi i Kosovës nuk ka një rol në mbikëqyrjen e kontratave që kanë të bëjnë me eksploatimin e burimeve. Autorizime tejet të mëdha ka një komitet ndërministerial i përbërë prej 5 ministrave dhe i kryesuar nga Minsitri i Financave. Kuvendi do të duhej të miratonte gjithë aranzhmanet e rëndësishme përtej një vlere të caktuar dhe sidomos në rastin kur jetëgjatësia e licencës është më e gjatë se 15 vjet;
- ^{viii} Shih më gjerësisht te Joseph Stiglitz : Making Natural Resources into a Blessing Rather a Curse në Lifting the Resource Curse , OSI, New York , 2005. Stiglitz, gjithashtu, propozon një sërë instrumentesh nga fusha makroekonomike dhe mikroekonomike, që sugjerojnë një maturi në shpejtësinë e ekstraktimit, maturi në hyrjen në borxhe të mëdha për

- industritë ekstraktuese, si dhe, siç e quan ai, “ fondin e stabilitetit” për investime në asete fizike dhe humane e sociale, të cilat diversifikojnë mundësitë e zhvillimit dhe e përgatisin vendin që të ballafaqohet me periudhën kur burimet ekonomike të jenë të eksploatuara;
- ^{ix} Extractive Industries Transparency Initiative (EITI)
- ^x Shih probleme të zhvillimore të vendbanimeve përreth mihjeve sipërfaqësore të KEK-ut, komuna e Obiliqit, Stantërgun, ose komunitetet afër xeherorerve dhe Shkrites së “Ferronikelit” në Drenas;
- ^{xi} Këtu fjala është sidomos për problemet urbane dhe komunale , energjia, uji, ndotja, ndikimet negative në shëndet;
- ^{xii} Dr. Muhamet Mustafa : Market Economy, Poverty and Resource Managment, CIPE Development Institute , Washington 2008 ;
- ^{xiii} Diskutimet aktuale lidhur me aranzhmanin koncesional për investime në gjenerimin e energjisë nga linjiti në Kosovë – Kosova C, duket se kryesisht përqendrimi është tek intersat e investitorit e më pak tek ai ekonomik nacional dhe kostot e përfitimet sociale (shih Përralla Moderne : Kosova C 2100 MW, Forumi 2015/ KFOS dhe RIINVEST 2007).

Isa MUSTAFA

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE RESURSET E PËRTËRITSHME DHE TË PAPËRTËRITSHME

Në këtë punim trajtohet zhvillimi i qëndrueshëm në kontekstin e shfrytëzimit të resurseve me të cilat disponon një vend, si dhe vlerësimi i resurseve në dritën e pronësisë private, relacionet ndërmjet resurseve të përtëritshme dhe atyre të papërtëritshme, politikat e zhvillimit bazuar në resurset e përtëritshme si dhe koncepti ekonomik i shfrytëzimit të resurseve të papërtëritshme.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i çdo vendi, prandaj edhe i Kosovës, ndërlidhet me resurset dhe rrethinën që do të plotësonin nevojat, jo vetëm për periudhën e tanishme, por edhe të gjeneratave që vijnë. Një zhvillim i tillë nënkupton plotësimin e nevojave dhe kërkesave aktuale pa i vënë në dyshim mundësitë e gjeneratës së ardhshme për t'i përmbushur nevojat e saj. Zhvillimi i qëndrueshëm ndërlidhet ngushtë edhe me kujdesin për të zhvilluar kapacitetet e sistemit natyror karshi sfidave sociale me të cilat ballafaqohet njerëzimi.

Në fund të shekullit të kaluar, ishte hequr dorë nga teoria se qëndrueshmëria përfaqëson një ekonomi në ekuilibër me sistemin bazik ekologjik. Në periudhën e tanishme, për t'u siguruar një zhvillim i qëndrueshëm, lypset të plotësohen tri parakushte themelore: qëndrueshmëria ambientale, qëndrueshmëria ekonomike dhe qëndrueshmëria sociopolitike.

Bazat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik qëndrojnë në aftësitë e këtij zhvillimi për të përmbushur nevojat njerëzore dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës, bazuar në shfrytëzimin eficient dhe të përgjegjshëm të resurseve natyrore, njerëzore dhe ekonomike. Prandaj, edhe zhvillimi i qëndrueshëm në Kosovë kërkon një qasje integrale të vendimmarrjes për shfrytëzimin e resurseve natyrore. Kjo qasje do të përfshinte:

- zhvillimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të resurseve;
- rritjen ekonomike dhe punësimin, të përcjellë me metodat dhe praktikatat e reja;

- cilësinë e lartë të jetës, të mbështetur në pasuritë natyrore të vendit;
- progresin social, i cili balancon nevojat për gjithë popullatën.

Në këtë aspekt, para nesh shtrohet pyetja, sesi do të ballafaqohen bizneset me disa sfida shumë karakteristike, me të cilat ballafaqohen tani Kosova dhe bota, siç janë ndryshimet klimatike dhe biodiversiteti, kushtet e punës dhe shëndeti deri te varfëria. Si të integrohen këto çështje në politikat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Teoria ekonomike flet se në periudhën bashkëkohore qëndrueshmëria ekonomike arrihet nëse sigurohen tri shtylla themelore: informimi i qartë, integrimi dhe pjesëmarrja, si flukse të rëndësishme që ndihmojnë në zhvillimin e vendeve. Në zhvillimin bashkëkohor ekonomik, *çdonjëri është shfrytëzues dhe dhënës i informatave*. Beteja për të bërë ndryshime po shpie që nga rruga e përqendrimit sektorial të biznesit të kërkohet një qasje e re; kjo qasje përfshin bashkërenditjen ndërsektoriale dhe *integrimin e nevojave ambientale dhe sociale në të gjitha proceset zhvillimore*. Ndërkaq, *pjesëmarrja e gjerë e publikut në marrjen e vendimeve* është një parakusht bazik i arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm.

Gërshetimi i faktorit ekonomik dhe atij ambiental siguron një zhvillim me shans për sukses. Gërshetimi i faktorit social dhe ambiental siguron një zhvillim, i cili mund të definohet si zhvillim i durueshëm, ndërkaq, gërshetimi i faktorëve socialë dhe ekonomikë mundëson një zhvillim të drejtë. Zhvillimi i qëndrueshëm mund të sigurohet vetëm nëse vlerat ekonomike dhe sociale pasohen me limite ambientale.

Në kushtet bashkëkohore ekonomike, paraqitet nevoja për tejkalimin e konflikteve ndërmjet objektivave afatshkurtër të konkurrencës dhe objektivave për prosperitet ekonomik, për cilësi ambientale dhe mirëqenie sociale. Në studimet për qëndrueshmërinë ekonomike dhe resurset e përtëritshme, konstatohet se *ambienti është një kombinim i natyrës dhe kulturave*, prandaj zhvillimi i qëndrueshëm integron kapacitetet multidisiplinare dhe interpreton diversitetin kulturor si një element kyç për strategjinë e re të zhvillimit. Në fakt, të gjitha studimet i shohin sfidat ambientale dhe sociale si më të arsyeshmet për objektivat zhvillimorë.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik është ngushtë i lidhur me qëndrueshmërinë e ambientit, por nuk varet vetëm nga ajo. Qëndrueshmëria e ambientit është proces, në të cilin veprimet vijuese

zhvillohen në interaksion me ambientin duke siguruar që ambienti të mbahet në formë natyrale, që nënkupton një sjellje ideale të bazuar. Një zhvillim i paqëndrueshëm do të ishte kur kapitali natyror, si formë agregate e të gjitha resurseve natyrore do të përdoret më shpejt nga koha e nevojshme për rivendosjen apo rimbushjen e tij. Ekuilibri ambiantal do të arrihet kur konsumi i resurseve të papërtëritshme do të jetë në harmoni me mundësinë e rivendosjes së tyre, ndërsa nëse ajo bëhet në nivel më të ulët sesa që ekzistojnë mundësitë natyrore për rivendosjen e tyre, atëherë gjendja e ambientit do të mund të rivendosej, që nënkupton një qëndrueshmëri ambientale.

Zhvillimi i qëndrueshëm bazohet në presupozimet se një shoqëri ka nevojë të menaxhojë tri lloje të kapitalit: atë ekonomik, social dhe natyror, me kusht që të krijohen baraspesha ndërmjet këtyre llojeve të kapitalit. Në këtë aspekt shtrohet nevoja e sigurimit të mundësive për zëvendësimin e disa resurseve natyrore me resurse, të cilat nuk do t'i rrezikonin proceset natyrore, siç është ekosistemi, ozoni, stabiliteti klimatik etj.

Në shkencën bashkëkohore ekonomike janë zhvilluar idetë që si tregues i shfrytëzimit të resurseve të jetë intensiteti i shfrytëzimit, i definuar si sasi e resurseve të konsumuara në raport me brutoproduktin vendor (GDP-në). Vendet në vitet e hershme të zhvillimit ekonomik kanë pasur intensitet të ulët të shfrytëzimit të resurseve, konsum të ulët dhe të ardhura të ulëta. Në fillim të industrializimit, u investua në industrinë bazike, në infrastrukturë dhe në projekte të tjera intensive kapitale, çfarë kishte ndikim në intensitetin e shfrytëzimit të resurseve dhe në rritjen ekonomike.

Shumë nga resurset nuk konsumohen në formën e tyre origjinale. Ato procesohen me qëllim që të përshtaten si produkte të ndryshme të nevojshme, që njihet si koncept i zhvillimit të resurseve. Në pikëpamje të profitit dhe maksimizimit të vlerës së pasurisë (aksioneve), pronarët e resurseve tentojnë të maksimizojnë vlerën e tanishme të përfitimeve që nxjerrin nga shfrytëzimi i tyre, në kushtet e kërkesës ekzistuese të konsumatorëve. Mirëpo, vendimi optimal i shfrytëzimit për çdo periudhë është i ndërvarur me periudha të tjera. Një sasi e resurseve e shfrytëzuar në një periudhë të caktuar nuk është e mundur të shfrytëzohet edhe në të ardhmen. Këto rregulla të shfrytëzimit në të shumtën e rasteve ndërliken me strukturën e tregut, me atë se a kemi të bëjmë me tregun monopol apo me tregun e konkurrencës së plotë, pra në cilat rrethana maksimizohet interesi i pronarit apo minimizohet humbja e tij.

Zhvillimi i qëndrueshëm i bazuar në shfrytëzimin e resurseve varet nga trendet e rritjes së popullsisë dhe stili intensiv e material i jetës. Në zhvillimin e koncepteve ekonomike për resurset dhe shkallën e shfrytëzimit të tyre ekziston dilema se a është më i qëndrueshëm shfrytëzimi i resurseve për gjeneratën e tanishme apo rezervimi i tyre për gjeneratat e ardhshme. Kjo dilemë bëhet aq më e madhe, pasi dihet se me rritjen e popullsisë, rritet edhe kërkesa për resurse, të cilat janë të kufizuara, pavarësisht nga ndryshimi i popullsisë.

Koncepti i pamjaftueshmërisë së resurseve karshi rritjes së nevojave për zhvillim më të shpejtë, shtron kërkesën për gjetjen e zgjidhjeve për shfrytëzimin racional të tyre në kohën e tanishme apo në kohët që vijnë, sepse me rritjen e popullsisë, rritet shpërpjesëtimi ndërmjet numrit të popullsisë dhe resurseve fizike me të cilat disponohet. Meqenëse ekonomistët fokusohen në alokimin e resurseve të pamjaftueshme, atëherë resurset e papërtëritshme nuk kanë vetëm rezervë fikse, ato njëherësh kanë ofertë të kufizuar karshi kërkesës në treg për to. Pyetja e parë që shtrohet nga ekonomistët për resurset e papërtëritshme është sesa duhet të korren nga këto resurse në çdo periudhë kohore, me qëllim që të maksimizohet fitimi.

Janë edhe faktorë të tjerë, të cilët ndikojnë në shkallën e shfrytëzimit të resurseve për një zhvillim të qëndrueshëm. Konsiderohet se rezervat minerale, si resurse, duhet të definohen në bazë të konsideratave dhe aplikimit të faktorëve teknikë, ekonomikë, legalë, të ambientit, faktorëve socialë dhe qeveritarë.

Kërkesa për resurse buron nga kërkesa për të mira finale. Meqenëse kërkesa prezanton një grup atributësh për të mira, në të shumtën e rasteve ekziston mundësia që përdorimi i një resursi të zëvendësohet me tjetrin. Resurset, si një entitet fizik apo virtual, kanë aftësi të kufizuara për të gjeneruar përfitime. Janë disa faktorë, të cilët ndikojnë në alokimin e resurseve përmes menaxhimit të tyre. Një nga përcaktuesit e kërkesës për resurse konsiderohet të jenë të ardhurat, çmimet përkatëse, çmimet e zëvendësuesve dhe plotësuesve, ndryshimet teknologjike dhe politikat qeveritare.

Kosova, në periudhën e pasluftës, nuk ka pasur një politikë të qartë zhvillimore dhe as politikë zhvillimore të bazuar në resurset natyrore, në ato kapitale dhe njerëzore. Zhvillimi ekonomik, menjëherë pas luftës, është bazuar në donacionet e jashtme për të tejkaluar pasojat e drejtpërdrejta të luftës.

Ekonomia e Kosovës është dëmtuar në një periudhë të gjatë kohore nga okupimi serb, nga politikat dezinvestuese të periudhës 1990-1999, nga shkatërrimet e luftë, por edhe nga pasiguritë pas

luftës, lidhjet e shkëputura të tregtisë së jashtme dhe investimet e pamjaftueshme në infrastrukturë. Menjëherë pas luftës, masat e rindërtimit dhe financimi nga donatorët ndikuan në rritjen e produktit të përgjithshëm vendor (GDP-së). Por qëndrueshmëria e këtij zhvillimi ekonomik ishte e varur nga ndihmat e jashtme, me mbështetje simbolike në eksport dhe në investime të huaja.

Në periudhën 2005-2007, norma e zhvillimit ekonomik është sjellë rreth 4 për qind dhe është mbështetur në rritjen e fuqishme të investimeve dhe të konsumit. Rritje më të shpejtë ka treguar eksporti, por efektet e tij kanë qenë të pamjaftueshme nga fakti se rritja e tij është bazuar në një bazë shumë të ulët paraprake. Zhvillimi ekonomik ka arritur nivelin më të lartë prej 5.5 për qind në vitin 2008 si rezultat i një politike fiskale ekspansioniste, kurse në vitin 2009 ka rënë në rreth 4 për qind.

Treguesit themelore ekonomike në periudhën 2005-2009

	2005	2006	2007	2008	2009
Rritja reale e GDP-së	3.8	3.8	4	5.4	4.0
GDP për kokë banori	2.4	2.3	2.7	3.8	2.5
Konsumi	5.8	2.2	6.1	3.7	2.6
Investimet	-6.1	1.3	3.9	15.5	12.6
Eksportet	8.8	31.9	11.7	4.2	-1.2
Importet	4.1	5.7	11.8	6	3.5
GDP (në mijë euro)	3,005	3,111	3,411	3,849	3,843
GDP për kokë banori	1,451	1,485	1,605	1,784	1,754
Popullsia	2,070	2,100	2,126	2,158	2,190

Burim: Fondi Monetar Ndërkombëtar

Niveli i ulët i integritimit ndërkombëtar të Kosovës ka ndikuar që kriza financiare globale të mos ketë ndikim të madh në ekonominë e këtij vendi. Efektet negative të krizës janë shprehur tek eksportet, tek investimet e huaja direkte dhe te remitancat nga diaspora. Me gjithë rënien e madhe të eksportit, prej rreth 18% në vitin 2009, përqindja e ulët e pjesëmarrjes në GDP prej rreth 5% nuk ka shkaktuar ndikim domethënës në zhvillim. Rënie prej rreth 22% kanë pasur edhe investimet e huaja direkte, kurse remitancat nga diaspora janë zvogëluar rreth 8%. Krahasuar me vendet e tjera të Evropës Juglindore, zhvillimi i përgjithshëm ekonomik i Kosovës ka qenë relativisht i ulët.

Zhvillimi ekonomik është bazuar dhe vazhdon të bazohet në sektorin e shërbimeve, ndërkaq, ngecin investimet në prodhimtari. Investime gjatë kësaj periudhe janë bërë kryesisht në rekonstruktimin e kapaciteteve të energjetikës. Privatizimi i “Ferronikelit” ka ndikuar në faza të caktuara në përmirësimin e bilancit tregtar me jashtë. Aktivizimi i kapaciteteve të kompleksit “Trepça”, me kapital vendor apo me investime të jashtme, mbetet një sfidë e madhe e ekonomisë kosovare. Në sektorin e bujqësisë është kryer privatizimi i rreth $\frac{3}{4}$ të pronave bujqësore, të cilat më parë kanë figuruar si prona shoqërore të organizuara në komplekse të mëdha të sipërfaqeve bujqësore, pemëtore, vreshtare apo edhe të agroindustrisë. Efektet e privatizimit në këto vite ishin shumë të ulëta, sepse sipërfaqja më e madhe e pasurive bujqësore të privatizuara mbetet e pashfrytëzuar, përderisa importi i produkteve bujqësore merr pjesë me rreth 30% në importin e tërësishëm të Kosovës.

RESURSET E PAPËRTËRITSHME

Janë dy faktorë themelorë, që influencojnë shfrytëzimin e resurseve të papërtëritshme:

- e para, çdo njësi e resurseve e shfrytëzuar sot, nuk do të jetë e mundshme të shfrytëzohet në të ardhmen dhe çdo resurs që mbetet i paprekur sot mund të sjellë një çmim më të lartë në treg në të ardhmen;
- e dyta, në qoftë se pronari shfrytëzon resurset sot, ai do të investojë në zhvillim dhe do të fitojë një përqindje të caktuar vjetore. Por, nëse pronari pret se çmimi i resurseve do të rritet më shpejt sesa përqindja r e fitimit ai do të shesë resurset duke fituar një çmim më të lartë për njësi. Dhe, e do të jetë e kundërta nëse çmimi i resurseve rritet më ngadalë nga përqindja vjetore r . Në bazë të përvojave të deritanishme të disponimit dhe menaxhimit me resurse në Kosovë, vërehet se politikat e shitjes së resurseve nuk janë bazuar gjithherë në kriteret e interesit ekonomik, në këtë rast të pronarit publik të tyre.

Linjiti në Kosovë dhe resurset e tjera natyrore nuk janë mjaft të shfrytëzuara, ndërsa energjia është problemi kryesor dhe më i madh për zhvillimin ekonomik dhe për standardin e qytetarëve. Resurset e linjtit janë potencial për tejkalimin e pengesave të mëdha të biznesit

në Kosovë, por edhe të gjenerimit të të hyrave të konsiderueshme për buxhetin dhe përmirësimin e bilancit të tregtisë me jashtë përmes eksportit të energjisë elektrike. Plumbi, zinku dhe magnezi janë, gjithashtu, potenciale të rëndësishme për punësim dhe zhvillim nëse riaktivizohen minierat e tyre.

Resurset e bollshme të linjtit, të vlerësuara mbi 10 miliardë tonë, kanë potencial ta bëjnë sektorin e energjisë një kontribuues kryesor të rritjes. Zhvillimi i sektorit të linjtit do të stimulonte punësimin dhe aktivitetet ekonomike që lidhen me të, si dhe eksportin e mundshëm. Zhvillimi i kapaciteteve prej rreth 1,000 megavat llogaritet se do t'i plotësonte nevojat vendore për energji, duke siguruar stabilitet të furnizimit të bizneseve, të ekonomive familjare dhe të qytetarëve, si dhe do të mundësonte edhe eksportin e një pjese të saj.

Në vitin 2010, Kosova aprovoi Strategjinë për energji 2009-2018, e cila parasheh heqjen graduale nga funksioni i Termocentralit Kosova A deri në fund të vitit 2015, rehabilitimin dhe privatizimin e Kosovës B, zhvillimin e resurseve të ripërtëritshme të energjisë në vend, duke përfshirë këtu Hidrocentralin e Zhurit, fillimin sa më të shpejtë të termocentralit Kosova e Re dhe privatizimin e distribuimit të energjisë elektrike. Studimet e investimeve e identifikojnë energjinë e prodhuar nga linjiti në Kosovë si opsion kryesor regional me kosto të ulët për zhvillim në krahasim me gazin, thëngjillin e importuar dhe hidroenergjinë, mbi bazë ekuivalente të energjisë.

Po ashtu, vlerësohet se aktivizimi i minierave kërkon investime të konsiderueshme, të cilat kryesisht do të mbështeten në investitorët e huaj.

RESURSET E PËRTËRITSHME

Resurset natyrore janë bazë mbi të cilat është ndërtuar civilizimi ynë. Në kuptimin më të gjerë, ato iu referohen burimeve të gjalla dhe jo të gjalla, të cilat na rrethojnë në tokë, mirëpo në pikëpamje tradicionale termi resurse natyrore përfshin resurset të cilat përdoren nga njerëzit, me një sistem të caktuar teknologjik, ekonomik, social dhe legal. Klasifikimi më i gjerë i resurseve përfshin:

- tokën bujqësore,
- tokën pyjore dhe produktet e shumëfishta,
- fushat e destinuara për rekreacion ose për qëllime shkencore, e
- ujërat e ëmbla dhe të njelmëta

- resurset minerale, të cilat përfshijnë lëndët djegëse dhe jodjegëse.

Disa resurse natyrore bëhen të përtëritshme përmes proceseve artificiale, ndërsa të tjerat nuk mund të riprodhohen.

Sa u përket resurseve të përtëritshme, duhet të theksohet se nga viti 1977, Bashkimi Evropian punoi në fushën e energjisë së përtëritshme nga era, dielli, uji dhe nga burime të tjera në formë ekuivalente prej rreth 12% nga konsumi i energjisë totale të BE-së deri në vitin 2010. Deri në vitin 2020, parashihet që 20% e energjisë të prodhohet nga burimet e përtëritshme. Komisioni Evropian ka ftuar vendet evropiane që të arrijnë marrëveshje për të ulur emisionin e gazit në hapësirë. Hapa të rëndësishëm në shfrytëzimin e resurseve të përtëritshme të energjisë kanë bërë edhe Kanadaja dhe SHBA-të. Në Evropë prijnë Austria, Suedia, Latvia, Portugalia, Finlanda.

Orientimet e Bashkimit Evropian në vitin 2001 specifikonin objektivat e anëtarëve të BE-së lidhur me pjesëmarrjen e energjisë elektrike nga burimet e përtëritshme në konsumin e tërësishëm të energjisë deri në vitin 2010. Por, në vitin 2010, u konstatua se ishte një numër shumë i vogël i shteteve të cilat ishin në gjendje të përmbushin këta objektiva; vetëm Gjermania kishte tejkaluar ato, ndërkaq Greqia dhe Britania e Madhe nuk i arritën objektivat as për së afërmi.

Politikat e Bashkimit Evropian orientojnë prodhimin e energjisë nga burimet, të cilat ndihmojnë reduktimin e emisionit të gazit për së paku 35%, me kusht që deri në vitin 2017 ulja e emisionit të arrihet në së paku 50%.

Megjithatë, mund të konkludohet se aplikimi i energjisë së përtëritshme vazhdon të jetë në nivel mjaft të ulët, edhe pse konsiderohet se ekzistojnë potenciale domethënëse. Në anën tjetër, vlerësohet se ekzistojnë mundësitë që me energji të ripërtëritshme t'u përgjigjet kërkesave globale për energji, krahas rritjes së popullsisë dhe standardit të jetesës. Llogaritet se sipërfaqja e tokës pranon energji diellore në vit prej rreth 10,000 herë më shumë sesa që është oferta totale e energjisë primare në botë.

Përdorimi i energjisë së përtëritshme lëviz dukshëm ndërmjet vendeve evropiane.

Politikat evropiane në sferën e energjisë së përtëritshme nisen nga fakti se njerëzit, por edhe kompanitë evropiane, kanë nevojë për furnizim të rregullt dhe të sigurt me energji dhe çmime të përshtatshme, me qëllim që të ruhet standardi i qytetarëve. Në të njëjtën kohë kërkohet të reduktohen efektet negative të energjisë, për

prodhimin e së cilës përdoren lëndët djegëse fosile, që kanë pasoja në ambient. Politikat evropiane janë fokusuar në krijimin e tregut të brendshëm konkurrues të energjisë, duke ofruar shërbime cilësore me çmime të ulëta, përmes zhvillimit të energjisë së përtëritshme dhe reduktimit të varfërisë dhe përmes marrjes së masave për uljen e konsumit të energjisë.

Si burime të rëndësishme të energjisë së përtëritshme llogariten ato nga biomasa, uji, era, dielli, energjia gjeotermale.

Pjesëmarrja e energjisë së përtëritshme në disa shtete anëtare , krahasuar me objektivat deri në vitin 2010			
	1977	2002	2010
Austria	70	68	78
Suedia	49.1	46	60
Latvia	50.1	48	49.3
Portugalia	38.5	21.8	39
Sllovenia	31.1	30.4	33.6
Finlanda	24.7	24.7	31.5

Biomatat të cilat gjenerojnë energji nëpërmjet shfrytëzimit të materialeve organike, siç janë ato bujqësore, pyjore, mbeturinat e kafshëve dhe metani për të prodhuar energji, janë një fushë e cila po përfiton gjithnjë e më shumë në resurset e përtëritshme. Përparësitë e kësaj energjie qëndrojnë në faktet se në të shumtën e herëve kjo është energji burimore vendore, është lehtë të shfrytëzohet dhe krijon vende të punës, sidomos në pjesët rurale. Bioenergja shfrytëzohet mjaft shumë në sektorin e ngrohjes dhe llogaritet se një sasi e konsiderueshme e energjisë në Evropë gjeneron nga këto burime dhe shfrytëzohet për ngrohjen e ndërtesave, për ujin e nxehtë dhe për ngrohjen në procesin industrial.

Energjia e prodhuar nga shfrytëzimi i forcës së ujit është mjaft e madhe. Kohëve të fundit, po ndërtohen turbina për shfrytëzimin e fuqisë së erës. Parashihet që deri në fund të vitit 2020 të dyfishohen turbinat për shfrytëzimin e erës.

Shfrytëzimi i burimeve të përtëritshme të energjisë në vendin tonë është në fazën fillestare, apo mund të thuhet edhe parafillestare. Përpos shfrytëzimit të burimeve nga uji për prodhimin e energjisë në sasi simbolike dhe disa rasteve testuese të shfrytëzimit të erës për energji, nuk janë zhvilluar forma të tjera të qëndrueshme. Politikat

qeveritare vazhdojnë të jenë të orientuara në prodhimin e energjisë nga thëngjilli, duke mos pasur konsideratë ndaj ambientit dhe efijencës energjetike. Shënohen vonesa të larta të shfrytëzimit të mbeturinave për prodhim të energjisë përmes riciklimit dhe shfrytëzimit të energjisë së diellit në disa pjesë të Kosovës, sidomos në pjesën e Dukagjinit, për bujqësi dhe nevoja të amvisërisë.

EFEKTET E SHFRYTËZIMIT TË RESURSEVE TË PËRTËRITSHME

Pritet që aftësia për zhvillimin e burimeve të përtëritshme të rritet në mënyrë rapide në vendet e Bashkimit Evropian në vitet që vijnë, do të rritet po ashtu shfrytëzimi i burimeve të pastra të energjisë. Zhvillimi i këtyre burimeve kërkon shfrytëzimin më efijentë të energjisë, sepse vlerësohet se furnizuesit e energjisë janë më mirë të organizuar nga konsumatorët. Krahas kësaj, do të përshtaten politikat fiskale dhe politikat e tjera për të orientuar zhvendosjen e vazhdueshme nga burimet e papërtëritshme në ato të përtëritshme. Në disa vende evropiane, qeveritë ndajnë miliarda euro për substituimin e prodhimit të thëngjillit me burime të tjera të energjisë. Këto masa janë të lidhura me ndryshimet klimatike përmes zvogëlimit të emetimit të tepërt të dyoksidit të karbonit në ajër. Ekstraktimi i thëngjillit përmes burimeve të hapura, siç është rasti në Kosovë, shkatërron sipërfaqen tokësore, derivatet e naftës shkaktojnë ndotjen e ambientit gjatë transportit të tyre, burimet nukleare shkaktojnë probleme gjatë ekstraktimit të uraniumit dhe rreziqe aksidentale. Ndërkaq, burimet e energjisë së përtëritshme konsiderohen se kanë efekte neutrale klimatike. Megjithatë, edhe këto burime kanë efekte estetike në sipërfaqen tokësore. Shfrytëzimi i burimeve ujore shkakton probleme në komunitetet lokale dhe në biodiversitetin e rrjedhave të ujit. Në pikëpamje të punësimit, shfrytëzimi i resurseve të përtëritshme krijon punësim me normë më të lartë në krahasim me teknologjitë e tjera të burimeve të papërtëritshme.

Kostoja e eksternalitetit për lloje të ndryshme të energjisë, të cilat e dëmtojnë hapësirën dhe shëndetin, është e madhe, por kjo kosto nuk përfshihet në çmimet e energjisë. Rast specifik në Kosovë është dëmtimi i hapësirës ajrore, ujore dhe tokësore nga tymi dhe nga mbeturinat, të cilat i prodhon KEK-u e të cilat dëmtojnë rrethinën, shëndetin e qytetarëve, bujqësinë, pemëtarinë dhe cilësinë e jetesës. Për këto dëme kjo kompani nuk i kompenson banorët dhe ekonomitë lokale dhe këto dëme nuk janë të përfshira në çmimin e energjisë

elektrike. Lidhur me këtë, studimet e kryera nga shtetet e Bashkimit Evropian tregojnë se thëngjilli ka kosto të lartë eksternale, e pasuar me naftën dhe gazin. Nëse kostoja eksternale do të përfshihej në çmim, atëherë kostoja e prodhimit të energjisë nga thëngjilli llogaritet se do të jetë përafërsisht e dyfishtë.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE DËSHTIMI I TREGUT

Në pikëpamje të përdorimit të resurseve për zhvillimin ekonomik, në teorinë ekonomike trajtohen shkaqet për dështimet e tregut, të cilat duhen evituar. Një nga shkaqet theksohet të jetë privatizimi i përfitimeve nga kapitali natyror ose shoqëror, i cili shpie në eksternalite negative për rrethinën; shkak i dytë qëndron në faktin se kapitali natyror shpesh është i nënvlerësuar nga shoqëria, e cila nuk është mjaft e kujdesshme për koston reale të eksploatimit të këtij kapitali. Informimi asimetrik, llogaritet të jetë shkak tjetër i dështimit të tregut, sepse e bën të ndërlikuar zgjidhjen efektive. Një shkak tjetër mjaft i rëndësishëm është alokimi jooptimal i resurseve nga firmat, për arsye të mentalitetit të zakonshëm, me të cilin veprojnë firmat në treg.

Një kriter i pranuar gjerësisht për qëndrueshmërinë ekonomike konsiston në efikasitetin e firmës gjatë përdorimit të kapitalit natyror. Eficienca e tillë konsiderohet si ekoeficienca, e cila llogaritet si vlerë e shtuar ekonomike e firmës në raport me impaktet ekologjike të agreguara. Ekoeficienca arrihet përmes distribuimit të çmimeve konkurruese të të mirave dhe shërbimeve, të cilat përbushin nevojat njerëzore dhe sigurojnë cilësi të jetës, ndërsa në formë progresive reduktojnë impaktet ekologjike dhe përdorimin intensiv të resurseve.

Mirëpo, koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm përballet edhe me kritika të ndryshme. Disa teoricienë ekonomikë, zhvillimin e qëndrueshëm e konsiderojnë si tendencë për kontrollin e resurseve botërore përmes një infrastrukture globale, e cila pretendon të menaxhojë, të llogarisë dhe të kontrollojë asetet botërore. Konsiderohet, po ashtu, se ky zhvillim i qëndrueshëm ndërlidhet me kufizimin e zhvillimit të vendeve në zhvillim dhe kontrollin e rritjes së popullsisë.

Ruzhdi PLLANA dhe Vahdet PRUTHI

RESURSET UJORE DHE SFIDAT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Abstract

In this paper are presented water resources and water challenges in natural, social, economic, ecological context and their management in Kosovo. National challenges of water resource vary from country to country. Key water challenges in Kosovo are: relatively limited water resources in comparison to needs, different distribution in time and space, the rapid growth of demand, appearances of droughts, floods, physical transformations and pollution of water bodies, conflicts between different sectors, inadequate management, etc.

According to hydrological studies are estimated that the average flow in surface water in Kosovo is about 114.5 m³/s. Surface water resources in Kosovo are estimated about 3.6 billion m³/year or about 1700 m³/inhabitant/year. Hydrologists are estimating that the area with such resources will have problems with water supply (stress). When talking about a country's water resources and their management, it is important the report between native (domicile) and transit waters. Republic of Kosovo stands predominantly with local water resources with over 90% and less than 10% transit water. This fact is conditioned by hydro-geographical position and topography of the terrain which is reflected as a priority in water resources management.

Fjalë kyçe: resurse ujore, menaxhim, përtëritje, regjim hidrik, prurje ujore, ujëra vendore.

HYRJE

Uji trajtohet si komponent qenësor i mjedisit dhe resurs vital natyror për çdo vend. Uji ndikon në krijimin dhe pamjen e peizazhit, përcakton përmbajtjen, vlerën dhe produktivitetin e trevës konkrete.

Hidrologët vlerësojnë se resurset ujore qëndrojnë në lidhshmëri të ngushtë me kushtet fiziko-gjeografike të vendit. Ndryshimi eventual i njërit nga komponentët e mjedisit mund të reflektohet në sisteme hidrike dhe në ngadalësimin e shkallës së përtëritjes.

Uji, në parim, bën pjesë në burime natyrore që përtërihen. Resurset ujore përtërihen përmes proceseve natyrore, mirëpo, përtëritja nuk është e garantuar. Përtëritja kryhet vetëm në kushte të ruajtjes së mundësive për përtëritje- rimbushjes të rezervuarëve natyrorë me ujë. Nëse shfrytëzimi i rezervave ujore është më i shpejtë se procesi natyror i përtëritjes, ato do të zvogëlohen ose shterin. Ky proces reflektohet në zvogëlimin e vëllimit të përgjithshëm të ujit në nivel pellgu lumor konkret dhe vendi në tërësi. Format më të shprehura të përkeqësimit të kushteve të rimbushjes së rezervuarëve natyrorë të ujit në vend po realizohen përmes:

- procesit të eksploatimit të pakontrolluar të inerteve në shtratin e lumenjve dhe në rrafshje aluviale të tyre, që reflektohet drejtpërdrejt në uljen e nivelit të ujërave nëntokësore, përkatësisht zvogëlimin e rezervave potenciale ujore;
- eksploatimit masiv (individual e kolektiv) të ujërave nëntokësore përmes shpimeve dhe hapjes së puseve të pakontrolluara, në të cilat bëhet eksploatimi më i shpejtë se përtëritja natyrore;
- procesit intensiv të shpyllëzimit të zonave malore që reflektohet në përkeqësimin e kushteve hidrike, sidomos në rimbushje të akuiferëve karstikë etj.;
- ngritjes dhe zgjerimit të paplanifikuar të vendbanimeve dhe infrastrukturës që nuk respektojnë rregullat e proceseve natyrore të lëvizjes së ujit në natyrë etj.

Sigurimi i kushteve të përshtatshme për përtëritje natyrore kërkon veprime të hershme, planifikim të integruar dhe të qëndrueshëm. Hidrologët vlerësojnë se qasja ndaj resurseve ujore, si objekt i shfrytëzimit, më tepër duhet orientuar nga aspekti i parashikimeve (prognozave) se nga përshkrimi dhe shpjegimi i ligjshmërive të proceseve hidrike në të kaluarën dhe atyre aktuale.

RESURSET UJORE TË KOSOVËS

Resurset ujore të një vendi përfshijnë të gjitha format (trupat) ujore të përshtatshme për përdorim praktik. Resurset ujore në Kosovë paraqiten kryesisht në formë të: ujërave sipërfaqësore (përroska, përrenj, lumenj), ujëra nëntokësore (burime, akuifer aluvial dhe në

depozitime neogjene, ujëra karstike, ujëra arteziane) dhe ujëra termale e minerale. Disa dukuri të liqeneve natyrore, për shkak të sipërfaqes dhe vëllimit të vogël të ujit, nuk janë resurse me rëndësi nga aspekti i shfrytëzimit praktik .

Në trajtimin e resurseve ujore të çdo vendi shtrohet pyetja themelore: **sa dhe çfarë** janë ujërat e disponueshëm? Mirëpo, kuptohet se ky është vetëm një informacion-vlerë për modelim, sepse gjatë vitit dhe prej vitit në vit kjo vlerë ndryshon (lëkundet). Në proceset e operimit me resurs ujor, për ndryshim nga resurset e tjera natyrore, përherë duhet pasur parasysh analizat retrospektive shumëvjeçare të ndryshimeve hapësinore dhe kohore të ujërave.

Si tregues i kamjes ujore (ujëdhënie) të territorit konkret zakonisht përdoren rrjedhjet sipërfaqësore të shprehura përmes rrjedhjeve specifike (moduli i rrjedhjeve). Vlera mesatare e rrjedhjeve specifike në nivel vendi është rreth 10.5 l/s/km². Mirëpo, lëkundjet territoriale dhe kohore janë mjaft të theksuara dhe sillen prej 4.92 l/s/km² (Morava e Binqit) deri në 42.5 l/s/km² (Bistrica e Deçanit). Për zbutjen e lëkundjeve të prurjeve ujore brenda viti dhe prej viti në vit nevojiten intervenime teknike përmes rregullimit të regjimit hidrik (akumulimit të ujit) dhe transferimit të ujit nga një pellg lumor në tjetrin. Resurset ujore nëntokësore janë burim i rëndësishëm për furnizimin e popullsisë me ujë të pijes dhe nevoja të tjera ekonomike. Në krahasim me ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, sidomos ato subarteziane dhe arteziane, përtërihen ngadalë. Nuk ka të dhëna të besueshme për bilancin e ujërave nëntokësore në Kosovë. Në studimet regionale hidro-gjeologjike rezervat e ujërave nëntokësore zakonisht vlerësohen në rreth 30% të atyre sipërfaqësorë.

Sipas treguesve natyrorë hidrikë, rezultojnë se Kosova ka vlerë të prurjeve specifike më të lartë se vlera mesatare për rruzullin tokësor (10.0 l/s/km²) dhe Evropë (9.7 l/s/km²). Po ashtu, Kosova ka vlerë të prurjeve specifike më të lartë se regjionet kufitare veriore- pellgu i Moravës, 6.8 l/s/km², që drenon pjesën më të madhe të Serbisë dhe ai jugor- pellgu i Vardarit, 7.8 l/s/km², që drenon pjesën më të madhe të Maqedonisë. Pra, shikuar në kontekst natyror, rezultojnë se Kosova është vend relativisht i pasur me resurs ujor. Kur këtij vlerësimi i shtohet edhe fakti se në Kosovë mbizotërojnë ujëra autoktone (domicile) me mbi 90%, mund të konstatohet se nga aspekti natyror Kosova disponon kushte relativisht të favorshme hidro-gjeografike.

Mirëpo, resurset ekzistuese ujore shikuar në raport me kërkesat, mënyrën ekstensive dhe joeficiente të shfrytëzimit dhe statusin ekologjik të tyre, rezultojnë se Kosova mund të trajtohet si vend me

kriza potenciale hidrike. Në Kosovë ekziston përqendrim i madh i vendbanimeve (mbi 13 vendbanime në 100 km^2), dendësi e madhe e popullsisë (mbi 200 b/km^2), sipërfaqe të mëdha të tokave bujqësore të përshtatshme për ujë (rreth 253.600 ha), pasuri të mëdha të burimeve minerale (metale dhe jometale) dhe energjetike, që shtrojnë kërkesa të mëdha për ujë, që njëkohësisht paraqitën edhe si degradues dhe ndotës të mëdhenj.

Resurset ujore të një vendi, hidrologët zakonisht i vlerësojnë në bazë të raportit të ujërave të disponuar me numrin e popullsisë. Sipas një modeli, bëhet ky kategorizim i kamjes me ujë të vendit:

- shumë i pasur me ujë $> 20\,000 \text{ m}^3/\text{b/v}$
- i pasur me ujë $10\,000 - 20\,000 \text{ m}^3/\text{b/v}$
- mesatarisht i pasur me ujë $5\,000 - 10\,000 \text{ m}^3/\text{b/v}$
- i varfër me ujë $2\,000 - 5\,000 \text{ m}^3/\text{b/v}$
- shumë i varfër me ujë $< 2\,000 \text{ m}^3/\text{b/v}$.

Sipas këtij kriteri, Kosova, me rreth $1800 \text{ m}^3/\text{b/v}$, bën pjesë në vende shumë të varfra me ujë.

Tab. 1. Resurset ujore në disa vende të Evropës Juglindore

Vendi	Ujera domicile (interne) 10^9	m^3/banor	Ujera transite (externe) 10^9	m^3/b	Gjithsej m^3/b
Shqipëria	26.9	8.583	14.8	4.722	13.306
Bosnj- Herc.	36.0	9.052	2.0	503	9.555
Bullgaria *	21.0	2.642	0.3	38	2.680
Kroacia	37.7	8.101	33.7	7.241	15.342
Maqedonia	5.4	2.655	1.0	492	3.147
Rumania	42.3	1.885	169.6	7.556	9.442
Serbia e Mali i Zi	25.1	2.379	164.5	15.589	17.961
Kosova**	3.268	1.634	0.370	185.2	1.819

Burim: AQUASTAT, Food and Agriculture Organization (2002)

* Për Bullgari nuk janë llogaritur resurset ujore transit të lumit Danub.

** Llogaritje dhe vlerësime të autorit(nr. i banorëve për Kosovën 2 mil.).

Me qëllim të rregullimit të regjimit hidrik dhe shfrytëzimit sa më racional të resurseve ujore, ngritën akumulime ujore. Në këtë aspekt në Kosovë janë ngritur penda dhe akumulime të ujit me rëndësi për zgjidhjen e problemeve hidro-ekonomike.

Tab.2. Kapaciteti i ujit në akumulime në disa vende të Evropës Juglindore

Vendi	Vëllimi/ m ³ 10 ⁹	m ³ / banor	% e resurseve të ujërave sipërfaqësore
Shqipëria	4.56	1.455	12%
Bosnja- Hercegovina	3.85	968	10
Bullgaria	5.00	629	25
Kroacia	1.53	329	3
FYRM-Maqedonia	1.70	836	27
Rumania	14.00	624	11
Serbia dhe Mali i Zi	7.78	737	4
Kosova*	0.569	284.5	15.7

Burim: World Atlasand Industry Guide,2002.The International Journal of Hydropower and Dams.

* Për Kosovën të dhënat e përgatitura nga autori.

KONTEKSTI SOCIAL-EKONOMIK I RESURSEVE UJORE

Qasja ekonomike ndaj resurseve ujore nënkupton raportet ekonomike ndaj ujit. Uji, si dhe produktet e tjera të punës së njeriut dhe resurset e shfrytëzuara në zinxhirin riprodhues, trajtohet si mjet i përgjithshëm i punës , si prodhim final dhe si lëndë e parë ose mjet për punë. Me gjithë faktin se uji, nga qasja ekonomike, është prodhim-mall, që ka çmim dhe iu nënshtrohet ligjshmërive të tregut, roli rregullues i shtetit është i domosdoshëm, sidomos në përcaktimin e prioriteteve, kushteve të shfrytëzimit të resurseve jo të mjaftueshme, regjimin hidrik, rregullimin e raporteve ekonomike në relacionin hidro-ekonomi- shfrytëzues të shërbimeve etj.

Resurset ujore nga aspekti social-ekonomik integrojnë tri shtylla kyçe: eficientia ekonomike (qëndrueshmëria ekonomike), qëndrueshmëria mjedisore-ekologjike dhe drejtësia sociale (qëndrueshmëria sociale). Eficientia ekonomike mund të jetë mjet plotësues (suplementar) për ruajtjen dhe parandalimin e mungesës së ujit. Uji nuk është mall (artikull) i rëndomtë si nafta ose gazi,

përkundrazi, uji është element i domosdoshëm për mbështetjen e jetës dhe plotësimin e nevojave të domosdoshme të njeriut për pije, bujqësi, industri, pushim, rekreacion, sport, turizëm etj.

E drejta për ujë është pjesë e së drejtës elementare të njeriut për ushqim, shëndet, mirëqenie njerëzore dhe jetë. Mirëpo, e drejta për ujë nuk nënkupton edhe të drejtën për disponim të pakufishëm të ujit. Resurset e kufizuara, shtrëngimet ekologjike, faktorët ekonomikë dhe politikë kufizojnë mundësitë për përdorimi të pakufizuar të ujit nga njeriu. Shtrohet pyetja: sa është sasia e ujit e nevojshme për të gëzuar këtë të drejtë? Sipas hidrologut Gleick (1996), e drejta njerëzore për ujë duhet t'i plotësojë "nevojat themelore" për pije, për përgatitjen e ushqimit dhe për nevoja të domosdoshme shtëpiake. Në Samitin e Tokës (1992), kjo e drejtë është zgjeruar apo begatuar duke përfshirë këtu edhe nevojat ekologjike për ujë. Vlerësohet se nevojat minimale humane për ujë janë afërsisht 3-5 l/b/d (litër/banor/dite). Banka Botërore dhe OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) rekomandojnë 20-40 l/b/d, si nevoja elementare. Me Agjendën 21 propozohen 5 l/b/d ujë të pastër për pije dhe 20 l/b/d për sanitari dhe higjienë. Mirëpo, kur flitet për të drejtën për ujë, vlen parimi: uji si e drejtë, por mbrojtja si përgjegjësi.

Furnizimi i popullsisë me ujë dhe konsumi i ujit për kokë banori është tregues i rëndësishëm i nivelit të zhvillimit socio-ekonomik dhe standardit të jetës për çdo vend. Sipas regjistrimit të popullsisë dhe të amvisërive më 1971, kur për herë të parë janë evidentuar edhe të dhënat për numrin e familjeve të përfshira në ujësjellës publik, rezulton se vetëm rreth 15% e familjeve në Kosovë kishin furnizim me ujë nga ujësjellësi publik. Mirëpo, kjo nuk do të thotë edhe 15% e popullsisë, sepse bëhet fjalë kryesisht për familje në qendra urbane, që zakonisht cilësohen me numër më të vogël të anëtarëve.

Sipas të dhënave të MMPH (Gjendja e ujërave në Republikën e Kosovës/Projektraport, Prishtinë, 2010), vlerësohet se mbulimi i popullsisë me shërbime të ujësjellësit publik në Kosovë sillet në kufijtë 70%-75%. Ndryshimet rreth mbulimit të popullsisë me ujë nga ujësjellësi publik në vendbanime urbane dhe rurale janë mjaft të theksuara. Masat e zbatuara në sistemet ekzistuese, investimet në sigurimin e burimeve të reja, si dhe ngritja e rrejtës së ri për furnizim me ujë në dekadën e fundit, akoma nuk kënaqin nevojat e furnizimit me ujë në aspektin sasior dhe cilësor. Vlerësohet se konsumi i ujit për kokë banori në vend sillet rreth 50 l/b/d, që është dukshëm nën nivelin e standardeve evropiane (180-200 l/p/d (litra /person/ditë). Sipas të dhënave në raportin e cituar, rreth 50%-55% e popullsisë ka

qasje në shërbime sanitare të derdhjes së ujërave të zeza (kanalizim). Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujërave të zeza nuk kënaqin në masë të mjaftueshme nevojat e qytetarëve dhe janë sfida serioze mjedisore dhe shëndetësore. Mungesa e trajtimit (fizik, kimik dhe biologjik) të ujërave të zeza në Kosovë paraqet rrezik të madh për cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Zgjidhja e problemeve duhet orientuar kah ngritja e sistemeve regionale për shfrytëzimin e ujërave, rregullim, mbrojtje dhe ndërlidhje funksionale të tyre.

Topografia e terrenit, ndërtimi gjeologjik dhe vetitë pedologjike të tokave, kanë krijuar kushte jashtëzakonisht të favorshme natyrore për mbizotërimin e lartë të tokave bujqësore prej 584.882 ha ose 53.6% të sipërfaqes së tërësishme të vendit (1.090.800 ha). Kosova disponon kushte të favorshme klimatike dhe tokësore për zhvillim të bujqësisë intensive. Mirëpo, sasia e vogël e reshjeve atmosferike në periudhën e vegjetacionit është faktor kufizues për prodhimtari të lartë dhe stabile. Ujitja është masë e domosdoshme agroteknike për zvogëlimin e rreziqeve klimatike që shkaktohen nga mungesa e sasisë së mjaftueshme të reshjeve. Nga sipërfaqet e tërësishme të tokave të punueshme (407.782 ha), rreth 253.600 ha janë toka të përshtatshme për ujitje (klasa I-IV e bonitetit). Sipas vlerësimit të Prof. dr. B. Kabashit, për prodhimtari të qëndrueshme bujqësore me rendimente të larta, në periudhën e vegjetacionit nevojiten mesatarisht rreth 3.500 m³ ujë për ujitjen e një hektari tokë të punueshme. Në bazë të dhënave rezulton se për ujitjen e tokave të punueshme nevojiten sasi të mëdha të ujit, madje kryesisht në periudhën e pakave ujore. Këto kërkesa nuk mund të plotësohen në kushtet natyrore të regjimit hidrik, por vetëm përmes intervenimeve teknike dhe barazimit të prurjeve ujore (ngritjen e akumulimeve) dhe transferimit të ujit nga një pellg lumor në tjetrin.

Nën sisteme të vjetra për ujitje si dhe ato bashkëkohore në Kosovë gjenden rreth 72440 ha, nga to me spërkatje 33.490 ha dhe 38.950 ha me ujitje sipërfaqësore. Mirëpo, deri para luftës vlerësohet se janë ujitur më pak se 50.000 ha ose rreth 70% të sipërfaqeve të përfshira në sisteme për ujitje. Vlerësohet se për ujitje në Kosovë shfrytëzohen rreth 270 milionë m³ që paraqet rreth 55% të harxhimit të përgjithshëm të ujit në Kosovë.

Tab.3. Sipërfaqe të tokave të punuara nën ujitje sipas hidrosistemeve ekzistuese (burim:A.Sharku, MBPZHR, Prishtinë,2004)

Hidrosistemi (HS)	Sipërfaqe të përfshira me projekt (ha)	Sipërfaqe të ujitura në ha sipas viteve	
		Vitet 80	më 1999
“Dukagjin”	5.000	4500	1.400
“Radoniqi”	10.250	5.080	4000
“Lumi i Bardhë”	14.250	11.450	3970
“Drini i Bardhë”	10.500	5.630	2.800
“Ibër-Lepenc”	20.000	20.000	2000
Gjithsej	72.440	54.490	19.150

Pasuritë e mëdha minerale (metalore dhe jometalore), struktura e larmishme dhe kushtet e eksploatimit dhe përpunimit të tyre, shtrojnë kërkesa të larta për ujë në Kosovë. Për shkak të ndryshimeve në strukturën e ndërmarrjeve industriale pas pavarësimit dhe mungesës së strategjisë së qëndrueshme të zhvillimit ekonomik të vendit, nuk ka të dhëna të besueshme për nevojat e ujit në industri. Aktualisht, si konsumues më të mëdhenj të ujit paraqitet KEK-u me harxhim specifik prej 5,23 m³/MWh (TCA) dhe 2.987 m³/MWh (TCB), “NewCO –Ferronikeli” me konsum vjetor prej rreth 3.604560 m³/vit (2008) dhe “Sharcem” me konsum vjetor prej rreth 113 661 m³/vit. Objektet e vogla industriale kanë burime vetjake të furnizimit me ujë ose janë të përfshira në ujësjellës publik.

Potencialet hidroenergjetike të Kosovës janë modeste. Sipas vlerësimeve të Ministrisë së Energjisë dhe të Minerave, potencialet hidroenergjetike të lumenjve në Kosovë vlerësohen rreth 403,32 MW. Aktualisht, në disa nga hidrocentralet e vogla (“Kozhnjer”, “Radac”, “Istog”, “Diaknc” etj.), prodhohen rreth 11.82 MWh, kurse në hidrocentralin “Pridvoricë“ 2x17,5=35 MWh. Planifikohet të ngrihen edhe disa hidrocentrale të vogla, në të cilat do të prodhohen rreth 63.7 MWh dhe hidrocentrali “Zhur” me fuqi prej 292.8 MWh. Duhet cekur se ngritja e hidrocentraleve të reja do të rezultojë me intervenime domethënëse teknike përmes kthimeve të rrjedhave ujore, ngritjen e pendave dhe akumulimeve, që do të reflektohen në aspekte të ndryshme mjedisore-ekologjike, hidrike, ekonomike-sociale dhe politike, që nuk janë vlerësuar në masë të duhur.

INFRASTRUKTURA E EKONOMISË SË UJËRAVE NË KOSOVË

Zhvillimi social- ekonomik dhe urban i çdo vendi qëndron në lidhshmëri të ngushtë me nivelin e zhvillimit të infrastrukturës së ekonomisë së ujërave. Me infrastrukturë të ekonomisë së ujërave (hidro-ekonomi) nënkuptohet tërësia e objekteve dhe sistemeve të ngritura nga faktori njeri, përmes të cilave realizohen objektivat e shfrytëzimit të ujit, mbrojtja e ujit dhe mbrojtja nga uji. Shfrytëzimi i ujit për nevoja të popullsisë dhe ekonomike në Kosovë realizohet përmes : furnizimit me ujë të popullsisë dhe industrisë, ujitja e tokave të punuara, prodhimi i hidro-energjisë, peshkimi dhe kultivimi i peshkut, shfrytëzimi në mënyrë të natyrshme ose rregullimi i trupave ujore për nevoja rekreative dhe turizëm, shfrytëzimi i inerteve nga shtrati i lumit etj. Me mbrojtje të ujit nënkuptohet kompleksi i aktiviteteve në lidhje me trajtimin (mekanik, kimik dhe biologji) të ujërave të përdorura, bonifikimin e regjimit të pakave ujore, mbrojtja e ekosistemeve të trupave ujore natyrore dhe të krijuar nga njeriu. Kurse mbrojtja nga uji përfshin kompleksin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me masat rregulluese të pellgjeve lumore dhe mbrojtjes së tokës nga erozioni, rregullimi i lumenjve në përgjithësi dhe i mjediseve urbane e rurale, mbrojtja nga përmbytjet, kullimi i ligatinave etj. Në Kosovë janë ngritur objekte të rëndësishme teknike për shfrytëzimin e ujit (sisteme për furnizim me ujë të popullsisë dhe industrisë, kanale ujitëse, akumulime) dhe mbrojtjen nga uji (masa pasive dhe aktive në rregullimin e shtratit dhe argjinaturave mbrojtëse). Mirëpo, ka ngecje serioze në ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e ujit nga degradimi dhe ndotja, që seriozisht rrezikojnë resurset ujore të vendit.

Kosova ka traditë të gjatë historike në shfrytëzimin e ujërave për ujitje. Çështje të ndryshme të rregullave dhe prioritetit të shfrytëzimit të ujit hasën edhe në Kanunin e Lek Dukagjinit. Vlerësohet se tradita e ujitjes së tokave bujqësore, duke shfrytëzuar ujin me rënie të lirë në Dukagjin, është ndër më të hershmet në Ballkan. Mbi bazën e kushteve të favorshme hidro-gjeografike dhe kërkesave për ujë për plotësimin e nevojave të ndryshme të popullsisë, bujqësisë dhe industrisë, në Kosovë është ngritur një infrastrukturë relativisht e mirë e ekonomisë së ujërave.

Pas heqjes së autonomisë së KSAK, aplikimit të aparteidit (1989) dhe konflikteve e luftës së armatosur për çlirimin definitiv të vendit, për shkak të keqmenaxhimit dhe veprimeve luftarake, pjesë të rëndësishme të infrastrukturës ujore janë dëmtuar, demoluar,

shkatërruar dhe paaftësuar për funksionim normal. Pas pavarësimit, me ndihmën e donatorëve, janë rehabilituar disa sisteme të rëndësishme të ujitjes (kanale, stacione pompimi), ujësjellës lokal e regional, si dhe intervenime të tjera teknike.

KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR I UJËRAVE TË KOSOVËS

Uji është materie jashtëzakonisht mobile dhe duke lëvizur pandërprerë në hapësira dhe kohë i ndërlidh dhe funksionon lokalitetet, regjionet dhe shtetet e ndryshme. Nga ky aspekt, uji si resurs natyror shoqërohet edhe me implikime të ndryshme mjedisore-ekologjike, hidrike dhe politike ndërkombëtare (bilaterale dhe multilaterale). Rritja e kërkesave për ujë dhe përkeqësimi i statusit ekologjik po shprehet edhe me tensione dhe konflikte të ndryshme brenda vendit dhe në mes shteteve kufitare. Konflikte më të shprehura po paraqiten ndërmjet regjioneve e vendeve të pasura me ujë dhe atyre të varfra, si dhe atyre me pozitë në pjesën e sipërme dhe atyre në pjesët e poshtme të rrjedhave ujore. Në lidhje me zgjidhjen e kontesteve të ndryshme ndërkombëtare dhe menaxhimin e integruar të ujërave janë adoptuar disa konventa, por me rëndësi të veçantë është Konventa mbi mbrojtjen dhe shfrytëzimin e rrjedhave ujore që priten nga vija kufitare dhe liqeneve ndërkombëtar (Helsinki, 1992).

Pozita gjeografike dhe topografia e terrenit kanë kushtëzuar që Kosova të gjendet kryesisht në pjesët e sipërme të gjithë lumenjve që presin vijën kufitare. Në Kosovë mbizotërojnë ujërat autoktone (domicile) me rreth 90%, kurse ujërat transite janë diç më pak se 10% të potencialit ujqor. Ujërat vendore-autoktone formohen nga reshjet atmosferike që bien në territorin e shtetit dhe paraqesin inputin kryesor hidrik për resurset ujore të vendit. Nga ky aspekt mund të konstatohet se Kosova ka një pavarësi natyrore hidrike, duke u shtrirë në pjesën e sipërme të rrjedhave ujore, me përjashtim të rrjedhjes së sipërme të Ibrit. Me gjithë faktin se sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës e lumit Ibër, jashtë vendit, është relativisht e vogël, inputet hidrike për resurset ujore të vendit janë me rëndësi të madhe.

Nisur nga fakti se të gjitha rrjedhat kryesore ujore presin vijën kufitare të Kosovës, ato mund të implikojnë çështje të ndryshme mjedisore-ekologjike, hidrike, ekonomike dhe politike. Ngritja e akumulimeve dhe devijimi i rrjedhave ujore në zonat kufitare të Kosovës ka dhe do të ketë edhe implikime të ndryshme bilaterale me vendet fqinje.

POLITIKAT DHE MENAXHIMI I RESURSEVE UJORE NË KOSOVË

Çdo vend krijon politika nacionale për ujëra në përputhje me kushte natyrore dhe socio-ekonomike të tij. Projektionet afatgjata (njëzetvjeçare) të shfrytëzimit dhe zhvillimit të resurseve ujore të Kosovës janë përfshirë në dokumentin : Bazat e Ekonomisë së Ujërave të Kosovës, të hartuar nga instituti “J. Çerni” dhe aprovuar nga Kuvendi i KSA të Kosovës më 1983. Të dhënat e prezantuara në studim kanë pasur karakter zyrtar dhe janë shfrytëzuar si bazë për të gjitha fazat e projekteve të objekteve dhe sistemeve hidro-ekonomike në Kosovë. Me gjithë faktin e skadimit të afatit, ky dokument akoma mbetet si burim i referimeve të ndryshme në lidhje me statusin e resurseve ujore në Kosovë derisa të hartohet Plani i ri Strategjik për Ujëra në Kosovë. Në periudhën e pasluftës dhe pavarësimit, Republika e Kosovës ka ngritur organe dhe institucione përgjegjëse edhe në sferën e ujërave, mirëpo, akoma nuk ka arritur të fuqizojë në masë të duhur menaxhimin e integruar të ujërave. Në Ligjin për Ujërat e Kosovës, në disa ligje të tjera dhe në akte nënligjore të nevojshme janë adoptuar dispozita të legjislacionit për menaxhimin e ujërave në përputhje me kërkesat e BE-së- Direktiva kornize për ujërat (2000/60/EC) .

Në bazë të Ligjit për Ujërat e Kosovës, MMPH-ja, përmes Departamentit të Ujërave, është përgjegjëse për përcaktimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore për ujërat në Kosovë, realizimin e objektivave të aprovuar nga programi i Qeverisë, administrimin e resurseve ujore etj. Për qëllime të administrimit të ujërave, në nivel të pellgjeve lumore, si njësi themelore të ekonomisë së ujërave janë themeluar dy rajone të pellgjeve lumore: Rajoni i Pellgut të Drinit të Bardhe dhe Rajoni i Pellgut të Ibrit, Moravës së Binçes dhe Lepencit. Krijimi i politikave në lëmin e ujitjes dhe kullimit , si dhe projektet për planifikim të ujitjes janë në kompetencë të MBPZHR-së. Sipas nenit 20 të Ligjit për Ujera (nr. 2004/24), detyra dhe përgjegjësi në nivel lokal të komunave janë veprimtaria publike lidhur me krijimin e politikave për furnizim me ujë të pijes, burimet natyrore, krojet publike, pusët publike dhe vijat ujore, evakuimi i ujërave të zeza dhe trajtimi i tyre . Ndërmarrjet publike që merren me administrimin e ujërave të pijes dhe ujërave për ujitje janë të klasifikuara në tri grupe: ndërmarrje publike qendrore, ndërmarrje publike rajonale dhe ndërmarrje publike lokale.

Me Ligjin për Ujërat e Kosovës (Nr.2004/24), është paraparë sigurimi i mjeteve financiare nga kompensimi për shfrytëzimin e ujërave, shkarkimi i ujërave të zeza , shfrytëzimi i inerteve nga shtrati i lumenjve dhe brigjet e tyre, si dhe aktivitete të tjera. Pra, parimi “përdoruesi paguan” dhe “ndotësi paguan” janë inkorporuar në dispozitat ligjore, por zbatimi i tyre shoqërohet me probleme serioze.

Përdorimi me efikasitet i ujit të pijshëm shtrohet si nevojë imediate për shumicën e vendbanimeve të Kosovës. Me gjithë faktin se niveli dhe cilësia e furnizimit të popullsisë me ujë të pijes është larg standardeve të BE-së, mund të konstatohet se në disa sisteme regjionale dhe lokale të ekonomisë së ujërave ka shembuj të përpjekjeve pozitive të mirëmenaxhimit me resurs ekzistues ujor, sidomos në ekonomizimin me rezervat e ujit në akumulacione. Ekuilibri ndërmjet kamjes ujore, zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit, mund të realizohet përmes menaxhimit të qëndrueshëm të pellgjeve lumore, si njësi themelore hidro-ekonomike. Sipas vlerësimeve të autorit Brian Richter, sfidat e shekullit 21 të menaxhimit të lumenjve qëndrojnë në faktin e ekuilibrit më të mirë ndërmjet nevojave humane për ujë dhe nevojave për ujë të vetë lumenjve si sisteme natyrore. Ballafaqimi i këtyre sfidave nënkupton qasje plotësisht të re të vlerësimit dhe menaxhimit të lumenjve. Çdo komponent i rrjedhjeve ujore-prurjet e mëdha, mesatare apo pakat ujore, janë me rëndësi për sistemin lumor dhe shëndetin (jetën) e tij.

Përdorimi me efikasitet i burimeve ujore përmes krijimit dhe zbatimit të politikave adekuate dhe parimeve “ përdoruesi paguan” dhe “ ndotësi paguan” ndihmojnë arritjen e objektivave të paraparë me Direktivën për ujë të BE-së, Nr.2000/60, 23.10.2000.

KONKLUZION

Resurset ujore në Kosovë i ekspozohen trysnisë së madhe nga aspekti i shfrytëzimit joracional, shndërrimeve fizike dhe ndotjes së pakontrolluar, humbjeve të mëdha teknike në sisteme ujitëse dhe furnizim me ujë të pijshëm, gjendja e pavolitshme e furnizimit me ujë të pijes dhe menaxhimit joadekuat .

Për zhvillimin strategjik të ekonomisë së ujërave në Kosovë rol themelor do të luajnë akumulimet ekzistuese dhe hapësirat shfrytëzuese të tyre. Duke u nisur nga fakti se hapësira e shfrytëzueshme e akumulimeve gradualisht mbushet me inerte, duhet pasur parasysh ruajtjen e hapësirave të tyre si dhe ruajtje të hapësirave potenciale për akumulime të reja nga zënia e tyre me zgjerime rurale-

urbane, ngritja e vendbanimeve joformale, infrastrukturës dhe aktiviteteve të tjera. Duhet të identifikohen dhe të mbrohen zonat e burimeve potenciale të ujit që shfrytëzohen për pije. Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve ujore është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit .

Trendet kryesore në lidhje me resurset ujore në vend shoqërohen me procese :

- Drejt zvogëlimit të sasisë së ujit për kokë banori;
- Drejt rritjes së degradimit, ndotjes dhe uljes së cilësisë së ujit;
- Drejt rritjes së tensioneve ndërmjet mjediseve urbane e rurale, atyre që kanë ujë dhe atyre që nuk kanë, atyre që janë në pjesët e sipërme të burimeve dhe rrjedhave ujore dhe atyre në pjesët e poshtme;
- Drejt rritjes së konflikteve potenciale me vendet fqinje;
- Rritjes së garës/konfliktit me mjedisin;
- Rritjes së kostos së mundësive.

LITERATURA

- R. Pllana (Tiranë, 2002) : Politikat dhe menaxhimi i ujërave në Kosovë, Konferencë Kombëtare , Aplikime të Sistemit të Informacionit Gjeografik(GIS) në Shqipëri, Tiranë, 10-12 dhjetor 2002.
- R.Pllana (Prishtinë, 1996) : Hidrologjia, shkalla e tanishme dhe perspektiva e shfrytëzimit dhe ruajtjes së resurseve ujore, ASHAK, Konferenca shkencore , Shqyrtim multidisiplinar i mundësive zhvillimore të Kosovës, f.149-162.
- Ligji për ujërat e Kosovës (Nr. 2004/24).
- Water Framework Directive (Directive 2000/60/EC of the European Parliament and of the Council.
- Baza e ekonomisë ujore në Kosovë, 1983.
- Akademija Nauk SSSR, Institut vodnih problem : Problemi izučrnija i kompleksnogo ispolzovanija vodnih resursov, Moskva, 1978.
- MMPH/Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Gjendja e ujërave në Republikën e Kosovës/Projektraport, Prishtinë, 2010.

Azem HAJDARI

RREGULLATIVA LIGJORE E SHFRYTËZIMIT TË RESURSEVE NATYRORE TË KOSOVËS

HYRJE

Kosova ndodhet në Evropën Juglindore, në brendësi të Gadishullit të Ballkanit. Ajo ka një sipërfaqe prej 10.877 kilometrash katrorë dhe kufizohet me Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi.¹ Kosova formon një njësi gjeografike të rrethuar prej vargmalesh dhe kodrash imponante.² Vendosja e Kosovës në qendër të Gadishullit të Ballkanit e përcakton atë në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme tokësore, që kalojnë nga Evropa Veriore e Qendrore drejt Evropës Jugore e Perëndimore.³ Relievi i Kosovës, marrë në përgjithësi, është malor. Kosova ka tokë bujqësore që kryesisht punohet lehtë, sipërfaqe të konsiderueshme pyjore, pasuri të mëdha ujore, zona të pasura me bimësi e faunë, si dhe pasuri të konsiderueshme nëntokësore.⁴

Këto dhe resurse të tjera me të cilat disponohet përfaqësojnë faktorin kryesor mbështetës të zhvillimit të Kosovës tani dhe në të ardhmen. Në fakt, si çdo vend tjetër edhe Kosovën e karakterizon elementi kufizues sa i përket masës së disponimit të resurseve përkatëse natyrore.

Siç dihet, në kushtet e ekonomisë së tregut të lirë dhe të privatizimit, mundësitë për të siguruar një planifikim të mirëfilltë të shfrytëzimit të të gjitha resurseve natyrore me të cilat disponohet relativizohen në masë të konsiderueshme. Së këndejmi, bazuar në faktin se resurse të pashtershme nuk mund të ketë, shtrohet si e domosdoshme që mekanizmat përkatës të autorizuar të bëjnë çdo gjë që është e mundshme, që shfrytëzimi i resurseve të tilla të bëhet në mënyrë të kujdeshme dhe racionale. Për realizimin e një qëllimi të tillë, siç është e njohur, shtetet bashkëkohore, duke përfshirë këtu edhe

¹ Kosova në vështrim enciklopedik, Tiranë, 1999, fq.7.

² Kosova- një histori e shkurtër, Noel Malcolm, Tiranë, 2001, fq.1.

³ Kosova në vështrim,....., fq.8.

⁴ Po aty, fq.26-44.

Kosovën, kanë nxjerrë edhe ligjet përkatëse. Së këndejmi, përmes këtij artikulli synohet të pasqyrohet gjendja aktuale, në të cilën ndodhet Kosova sa i përket rregullativës ligjore të shfrytëzimit të resurseve natyrore të cilat ajo i ka.

1. DISA NGA LLOJET MË TË RËNDËSISHME TË RESURSEVE NATYRORE QË DISPONON KOSOVA DHE ASPEKTET LIGJORE TË SHFRYTËZIMIT TË TYRE

Siç u theksua në hyrje të këtij artikulli, Kosova është shtet me pasuri të mëdha natyrore, sidomos nëntokësore. Ndonëse në periudhat e kaluara pasuritë natyrore kanë luajtur rol të madh në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës, megjithatë, indikatorët cilësorë tregojnë se resurset natyrore nuk kanë qenë sa duhet faktor i zhvillimit, por që në periudhën e ardhshme ato mund të jenë shumë më tepër. Kjo, për faktin se resurset natyrore të Kosovës i karakterizon elementi i tyre strukturor relativisht i volitshëm; fakti për rëndësisë gjithnjë e më të madhe që sot u kushtohet lëndëve të para, të energjisë dhe të ushqimit, me mungesën, përkatësisht me përndarjen joadekuate të të cilave ballafaqohet aktualisht njerëzimi; faktin e orientimit të politikës së zhvillimit të vendit kah resurset e brendshme dhe të nukleuseve të krijuara për shfrytëzimin e pasurive natyrore në Kosovë.⁵

Tashmë është i njohur fakti se resurset natyrore kryesore, të cilat i ka Kosova janë: toka, flora, fauna, uji dhe pasuritë nëntokësore. Së këndejmi, për shkak të karakterit dhe natyrës së këtij punimi, por edhe të faktorëve të tjerë kushtëzues, në kuadër të këtij artikulli do të ndalem në trajtimin e disa prej aspekteve të shfrytëzimit të këtyre resurseve, vështruar kjo në kontekst të rregullimit ligjor aktual.

1.1. TOKA BUJQËSORE DHE ASPEKTI LIGJOR I SHFRYTËZIMIT TË SAJ

Është fakt i padiskutueshëm se fondi i tokës paraqet resurs natyror shumë të rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Siç u theksua në hyrje të këtij artikulli, Kosova ka një sipërfaqe prej 10.877 kilometrash katrorë. “Sipërfaqja tokësore e Kosovës në masën prej

⁵ Ismet Gusia, Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të KSAK, “Rilindja”, Prishtinë, 1982, f.7.

54.23% është tokë bujqësore, 40.92% është sipërfaqe pyjore dhe 4.85% konsiderohet tokë jopjellore.”⁶

Në kuadër të kësaj tematike nuk do të bëhet fjalë për pyjet, sepse ato do të trajtohen më poshtë, kuptohet ndërlidhur kjo me qëllimin e këtij artikulli.

Hulumtimet shkencore tregojnë se toka bujqësore me cilësi të mirë përbën 15% të sipërfaqes së tërësishme të tokës bujqësore, 29% të mesme, kurse 56% është tokë e cilësisë më të dobët.⁷

Fondi tokësor i Kosovës, struktura e saj marrë në përgjithësi dhe në nivel të sipërfaqes tokësore bujqësore, së bashku me popullsinë në rritje, janë faktorët kushtëzues, që do të duhej të merren në konsideratë nga autoritetet përgjegjëse në politikën që duhet zbatuar sa i përket mënyrës së shfrytëzimit të saj. Në këtë aspekt, është më se e qartë se rregullativa ligjore është ajo që, në fund të fundit, do të duhej vendosur rregullat e sjelljes. Megjithatë, që ligji t’i adresojë në mënyrë të duhur nevojat esenciale të qytetarëve të Kosovës, vlerësoj si çështje urgjente hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse, duke përfshirë këtu edhe mënyrën e sjelljes së gjithsecilit autoritet përballë tërësisë së resurseve natyrore me të cilat disponohet.

Aktualisht, Kosova nuk ka një strategji të tillë. Kurse, sa i përket ligjbërjes gjërat, megjithatë, duket të jenë më ndryshe. Në fakt, në kontekst të kësaj tematike Kosova ka nxjerrë Ligjin mbi tokën bujqësore,⁸ Ligjin për ujitjen e tokave bujqësore,⁹ Ligjin për bujqësinë organike¹⁰ dhe Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural.¹¹ Të kësaj natyre konsiderohen edhe: Ligji për mbrojtjen e natyrës¹², Ligji për mbrojtjen e mjedisit¹³, Ligji mbi materialin fidanor¹⁴, Ligji për kooperativat e bujqve¹⁵ etj.¹⁶

⁶ Po aty, f.135.

⁷ Po aty, f.135.

⁸ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/ L-26.

⁹ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/ L-9.

¹⁰ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/ L-122.

¹¹ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.03/ L-098.

¹² Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/ L-18.

¹³ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.03/ L- 025.

¹⁴ Ligji nr.2004/16.

¹⁵ Ligji nr.2003/09.

¹⁶ Ligje që adresojnë çështje që kanë të bëjnë me shfrytëzim të tokës bujqësore, bazuar në zgjidhjet që ato ofrojnë, mund të konsiderohen edhe: Ligji për verërat (Ligji nr.2005/02- L8), Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura (Ligji nr.2008/03- Lo39), Ligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve (Ligji nr..2008/24), Ligji për duhanin (Ligji nr. 2007/1) etj.

Marrë në përgjithësi, mund të thuhet lirisht se Kosova, në periudhën e fundit dhjetëvjeçare, ka arritur të ndërtojë një infrastrukturë ligjore mjaft të avancuar që adreson çështje që ndërlidhen me mënyrën e shfrytëzimit të fondit tokësor bujqësor. Por, megjithatë, vështruar në çështje të veçanta, të ashtuquajtura praktike, konsideroj se disa nga këto ligje, kur kemi parasysh përvojat e disa vendeve të përparuara,¹⁷ nuk kanë arritur që, megjithatë, të adresojnë në aspektin më të mirë të mundshëm çështjen e funksionalizimit të mënyrës së zbatimit të ligjit, në çështjet që ndërlidhen me mënyrën e shfrytëzimit të fondit tokësor bujqësor. Kjo arsyetohet me faktin se Kosova e këtyre viteve ka vazhduar të ballafaqohet me shumë sfida, disa prej të cilave kanë qenë larg përvojave tona të mëhershme. Këtu, në fakt, nuk e kam fjalën vetëm për sfidat e karakterit politik (çështja e pavarësisë së vendit, ato të funksionimit të UNMIK-ut apo ndonjë autoriteti tjetër ndërkombëtar), por edhe për sfida të karaktereve të tjera (çështja e privatizimit, ekonomia e tregut të lirë etj.), të cilat, në një mënyrë ose tjetër, kanë reflektuar ndikimin e tyre edhe në çështjet që kanë të bëjnë me adresimin e mënyrës së shfrytëzimit të tokës bujqësore.

Edhe pse, sipas mendimit tim, Kosova nuk ka arritur të konsumojë të gjitha përvojat e mira ligjberëse në lëmin e shfrytëzimit të potencialit ekzistues të tokës bujqësore, megjithatë, konsideroj se problemi kyç është ai që ka të bëjë me zbatimin e legjislacionit ekzistues. Së këndejmi, konsideroj se fakti pse toka bujqësore atakohet çdo ditë e më shumë, në favor të tokës ndërtimore,¹⁸ dhe jo vetëm të saj, në masën më të madhe është pasojë e moszbatimit të ligjeve ekzistuese. Kështu, për shembull, Kosova, me gjithë faktin se ka Ligjin për tokën bujqësore, i cili definon mjaft qartë kriteret e shfrytëzimit të kësaj toke,¹⁹ shumë sipërfaqeve tokësore, pa vendimin

¹⁷ Polonia, p.sh., ka ligjin për mënyrën e shfrytëzimit të tokës bujqësore, si një ligj specifik, e kjo aktualisht nuk është përvoja e Kosovës. Pastaj, Shqipëria ka ligjin për mbrojtjen e tokës bujqësore si ligj specifik (Shih: Ligjin nr.9244, që ka hyrë në fuqi më 17 qershor 2004) etj.

¹⁸ Për këtë, më gjerësisht, shih: Të pamëshirshëm ndaj tokës, Editorial, Kosova sot, E përditshme informative e pavarur, nr.3852, dt.27 maj 2010, f.1. Në këtë shkrim editorial, ndër të tjera, theksohet se mijëra hektarë tokë të punueshme humbasin çdo vit për shkak të shndërrimit të tyre në vatra ndërtimi, kurse një pjesë tjetër e konsiderueshme e kësaj toke, thuhet se kryesisht lihet djerrë.

¹⁹ Kështu, sipas nenit 4, paragrafit 1, të këtij Ligji, pronari apo shfrytëzuesi i tokës bujqësore është i detyruar që tokën bujqësore ta shfrytëzojë në mënyrën e cila iu përshtatet vetive natyrore të tokës, duke mos e zvogëluar vlerën e saj dhe duke përdorur masat agroteknike përkatëse. Me këtë ligj rregullohet edhe shfrytëzimi i

e autoriteteve kompetente, apo, thënë më mirë, jashtë kontrollit të tyre, u është ndërruar destinimi. Në këtë rrjedhë, konsideroj se veprimi i parë që do të duhej ndërmarrë, në mënyrë që të sigurohet një shfrytëzim më racional i sipërfaqes së tokës bujqësore, është zbatimi i legjislacionit ekzistues. Krahas kësaj, nuk duhet reshtur përpjekjet për avancim të legjislacionit tjetër mbështetës, që do të ishte në funksion të krijimit të mundësive për shfrytëzim më adekuat të tokës bujqësore dhe pengim të degradimit të saj të jashtëligjshëm, duke funksionalizuar sistemin e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj gjithsecilit që shkel ligjin në fuqi.

1.2. PYJET DHE ASPEKTI LIGJOR I SHFRYTËZIMIT TË TYRE

Fondi pyjor, gjithashtu, përfaqëson njërin nga resurset natyrore shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit, përparimin e ambientit jetësor të njeriut (pyjet pastrojnë ajrin, rregullojnë lagështinë, pakësojnë ndotjen bakteriologjike, pastrojnë ujërat e ndotur etj.), rregullimin e regjimit të ujërave, zhvillimin e aktiviteteve rekreative etj.²⁰ Marrë në përgjithësi, fondi i përgjithshëm pyjor i Kosovës përfshin 40.92% të sipërfaqes së Kosovës.²¹ Vendi ka një strukturë pyjore jo shumë të volitshme. Por, megjithatë, pjesëmarrja e pyjeve të larta në masën e përgjithshme të pyjeve vlerësohet të jetë mbi 70%.²²

Hulumtimet e zhvilluara dëshmojnë se pylltaria në periudhën e kaluar nuk e kishte trajtimin e duhur në aspektin e zhvillimit ekonomik të Kosovës.²³ E njëjta situatë, të thuash, është prezente edhe në ditët e sotme. Në këtë aspekt mendoj se ndikim vendimtar, përveç masave të politikës ekonomike, kanë ushtruar edhe investimet e pamjaftueshme dhe joadekuate. Efektet e kësaj gjendjeje pa dyshim se do të ndihen edhe në zhvillimin e mëvonshëm. Në fakt, në dhjetë

kullotave, mbajtja e evidencës për tokën bujqësore, mbrojtja e tokës bujqësore, kushtet mbi bazën e të cilave mund të bëhet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore, shfrytëzimi i tokës bujqësore në sistemin e ujitjes, rritja e shtesës së pëlleshme të tokës, rikultivimi i tokës bujqësore, mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja, rregullimi i tokës bujqësore, masat që sigurojnë shfrytëzimin e tokës bujqësore në përputhje me ligjin në fuqi etj.

²⁰ Ismet Gusia, vep., e cit. f.164- 165.

²¹ Kosova në vështrim, ..., f.37.

²² Ismet Gusia, vep. e cit., f.169.

²³ Po aty, f.165-166.

vjetët e fundit vërehet tendenca në rritje e procesit të degradimit të pyjeve, ashtu që politika e mbrojtjes së tyre ka qenë shumë pasive dhe jofunksionale.²⁴

Për adresimin e çështjeve që ndërlidhen me pyjet, Kosova ka nxjerrë ligj të veçantë. Ky është Ligji për pyjet e Kosovës.²⁵ Ky ligj që në paragrafin 2 të nenit 1 pyjet i trajton si resurse kombëtare, të cilat duhet të udhëhiqen në mënyrën që ato të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme. Në këtë rast, potencohet fakti se udhëheqja e pyjeve duhet të marrë parasysh edhe interesa të tjera publike. Në zgjidhjet e vendosura me këtë ligj, po ashtu, është paraparë që menaxhimi i pyjeve të Kosovës duhet të bëhet në përputhje me deklaratën e parimeve për konsensusin global mbi menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha tipave të pyjeve të dhëna në aneksin III të raportit të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin.²⁶ Në kontekst të shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës janë parashikuar shumë dispozita të këtij Ligji. Me këto dispozita janë trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes së pyjeve përmes pyllëzimit të sipërfaqeve tokësore të zhveshura, regjenerimin e tyre pas prerjes, kufizimet në rastin e prerjes së pyjeve dhe shfrytëzimit të tyre²⁷ etj. Për qëllime të shfrytëzimit më racional të resurseve pyjore, me ligj është paraparë edhe nxjerrja e planeve menaxhuese. Në mbështetje të kësaj çështjeje, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural ka nxjerrë edhe disa akte përkatëse nënligjore.²⁸

Në koncept dhe përmbajtje Ligji për pyjet i Kosovës vlerësohet të jetë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare. Zgjidhjet e këtij ligji, sa i përket çështjes që është temë e këtij artikulli janë, të thuash,

²⁴ Vlerësohet se në Kosovë, vetëm deri në vitin 1999 kishte 81.639 ha pyje të degraduara. Kjo sipërfaqe në periudhën e pasluftës vlerësohet të jetë shumë më e madhe. Për këtë, më gjerësisht, shih: Kosova në, ..., f.37.

²⁵ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.2003/3.

²⁶ Kjo konferencë është mbajtur në Rio-de-Zhanejro, më 3-14 qershor 1992.

²⁷ Ligji në fjalë, në nenin 3.7, përcakton se asnjë person me rastin e prerjes së trungjeve nuk mundet ta lërë tokën me më pak se 40% të mbulesës pyjore.

²⁸ Kështu, kjo Ministri ka nxjerrë rregulla të posaçme me të cilat garantohet origjina dhe kualiteti i farërave, fidanëve dhe krasitjeve për rigjenerimin e pyjeve si dhe disa udhëzime të veçanta administrative, që rregullojnë çështje të mënyrës së shfrytëzimit të fondit bimor.

identike me zgjidhjet e vendosura në Ligjin për pyjet të Shqipërisë, Serbisë, Kroacisë etj.

Së këndejmi, lirshëm mund të konstatohet se Kosova aktualisht ka një infrastrukturë ligjore funksionale dhe të qëndrueshme sa i përket shfrytëzimit të resurseve pyjore. Megjithatë, si në rastin e tokës bujqësore, edhe kur është fjala për shfrytëzimin e fondit pyjor ekzistues, problemi kyç ka të bëjë me zbatimin e këtij legjislacioni. Në këtë aspekt, në mënyrë që gjërat, sa i përket shfrytëzimit të këtyre pasurive natyrore të rrjedhin si duhet, shtrohet si çështje e domosdoshme avancimi i sistemit të kontrollit, mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë së autoriteteve për të cilat legjislacioni në fuqi ka adresuar autorizime përkatëse në këtë lëmë.²⁹

1.3. BIMËSIA (PËRVEÇ PYJEVE) DHE ASPEKTI LIGJOR I SHFRYTËZIMIT TË SAJ

Ndonëse sipërfaqja e territorit të Kosovës përbën 2.3% të Ballkanit, ajo përfaqëson një rëndësi ndërmjet zonat më të pasura me bimësi në këtë Gadishull. Në këtë aspekt, veçanërisht dallohen malet e Bjeshkëve të Nemuna dhe të Sharrit. Kështu, sipas studimeve të specialistëve përkatës, rezulton se në territorin e Kosovës gjenden rreth 2500 lloje bimësh, midis të cilave rreth 200 lloje vlerësohet të jenë bimë endemike, të cilat kryesisht rriten në parqe e kopshte, siç është parku Karagaç në Pejë, në disa mjedise në rrethinën e Prizrenit etj.³⁰

Kjo shumëllojshmëri bimësh, në kushtet aktuale, paraqet një resurs natyror me leverdi të shumëfishtë, duke përfshirë këtu edhe aspektin zhvillimor të vendit. Duke pasur parasysh këtë fakt, Kosova në periudhën e fundit dhjetëvjeçare ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm në drejtim të vënies nën mbrojtje të kësaj shumëllojshmërie bimore, duke përfshirë këtu çështjen e mënyrës së shfrytëzimit të saj. Këtu është fjala, në rend të parë, për nxjerrjen e ligjeve bazike që adresojnë këto çështje. Së këndejmi, ligje të tilla konsiderohen: Ligji mbi mbrojtjen e varieteteve të bimëve,³¹ Ligji për

²⁹ Gjendja faktike në terren dëshmon se çështja e regjenerimit të sipërfaqeve pyjore të prera i është lënë mëshirës së natyrës, kurse degradimi i pyjeve të larta, bile edhe i atyre që janë nën mbrojtje të veçantë të shtetit, është një fenomen që vazhdon të shqetësojë opinionin publik, sidomos atë profesional.

³⁰ Për këtë, më gjerësisht, shih: Kosova në, ..., f.36-38.

³¹ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/L-98.

mbrojtjen e bimëve,³² Ligji mbi materialin fidanor,³³ Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve³⁴ etj.

Këto ligje, pavarësisht çështjes themelore që rregullojnë, adresojnë edhe aspekte të mbrojtjes së bimëve- llojeve të tyre, duke përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e shfrytëzimit, ripërtëritjen etj. Marrë në përgjithësi, këto çështje legjislacioni i Kosovës i trajton në mënyrë mjaft të avancuar.³⁵ Ky legjislacion është i standardizuar dhe, të thuash, tërësisht i harmonizuar me legjislacinin e vendeve të përparuara të Evropës që trajton këtë fushë. Kjo çështje është e evidente në çdo rast, kur ligje të veçanta të Kosovës, p.sh., Ligji për mbrojtjen e bimëve krahasohet me Ligjin për mbrojtjen e bimëve të Shqipërisë, të Sllovenisë apo të ndonjë vendi tjetër.

Përvoja e mëhershme tregon se fondi bimor i Kosovës, sidomos bimësia endemike, shumë pak është shfrytëzuar në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Përvoja e tillë vazhdon ta përcjellë Kosovën edhe në ditët e sotme. Për më tepër, me gjithë faktin se ekzistojnë ligjet bazike, bimësia e Kosovës, ngjashëm si resurset e tjera, vazhdon të mos e ketë tretmanin praktik të duhur, kuptohet në aspektin e mbrojtjes, regjenerimit, por edhe të shfrytëzimit. Së këndejmi, problemi kryesor edhe në këtë rast është ai që ka të bëjë me zbatimin e legjislacionit në fuqi.

1.4. FAUNA DHE ASPEKTI LIGJOR I SHFRYTËZIMIT TË SAJ

Bimësia e pasur e Kosovës vlerësohet të jetë faktori kryesor, që kushtëzon përhapjen gjeografike të faunës. “Kështu, në zonat pyjore të Sharrit e të Bjeshkëve të Nemuna fauna është më e pasur në numër e lloje sesa në zonat tjera më të ulëta e më me pak bimësi”.³⁶ Literatura e përdorur tregon se Kosova, marrë në tërësi, përfaqëson një vend relativisht të pasur me faunë.

Edhe pse Kosova është vend i pasur me faunë, ky resurs natyror vlerësohet të jetë përdorur në masë relativisht të vogël për zhvillimin ekonomik të vendit. Sidoqoftë, ekziston një vlerësim i përgjithshëm se

³² Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/L-95.

³³ Ligji nr.2004/3.

³⁴ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.03/ L- 042.

³⁵ Kështu, me Ligjin mbi mbrojtjen e varieteteve të bimëve (neni 6), përveç të tjerash, është adresuar në mënyrën më kuptimplote të mundshme çështja e shfrytëzimit ekonomik të bimëve nga persona të autorizuar.

³⁶ Kosova në, ..., f.38.

në Kosovë aktualisht ekzistojnë të gjitha parakushtet që në të ardhmen kjo pasuri natyrore të ketë tretman shumë më të avancuar në aspektin e shfrytëzimit të saj. Ky supozim mbështetet në faktin se tashmë Kosova ka një rregullativë ligjore, që vlerësohet të jetë mjaft e avancuar në aspektin e realizimit të këtij qëllimi, megjithëse në këtë drejtim pritet të ketë efekt të fuqishëm edhe përvoja e vendeve të përparuara, e cila, edhe në këtë lëmë (edhe pse akoma në finesë) ka filluar të bartet vitet e fundit në vendin tonë.

Vlen të theksohet fakti se në Kosovë, në periudhën e pasluftës, në funksion të kultivimit, mbrojtjes dhe shfrytëzimit të faunës së pasur me të cilën disponohet, janë nxjerrë disa ligje. Të tilla ligje janë: Ligji për përkujdesje ndaj kafshëve,³⁷ Ligji për gjuetinë,³⁸ Ligji për blegtorinë e Kosovës,³⁹ Ligji për peshkatarinë dhe akuakulturë,⁴⁰ Ligji mbi bletarinë⁴¹ etj. Për të pasqyruar aspektet që ndërlidhen me mënyrën e shfrytëzimit të këtij resursi natyror, e vlerësoj të mjaftueshme theksimin e asaj që është normuar në kapitullin III të Ligjit për peshkatarinë dhe akuakulturë. Zgjidhjet e dhëna në këtë kapitull, përveç të tjerash, rregullojnë edhe çështjen e shfrytëzimit të peshkut për qëllime ekonomike. Mirëpo, neni 14 i këtij Ligji e bën më se të qartë faktin se peshkimi ekonomik mund të realizohet vetëm në regjionet apo zonat e përcaktuara pas marrjes së licencës për peshkim ekonomik. Kjo qasje vlerësoj të jetë në funksion të çështjes së shfrytëzimit më racional të peshkut, si një resurs i çmuar i vendit.

Marrë në përgjithësi (në koncept dhe përmbajtje), legjislacioni vendor, që trajton çështjen e faunës, vlerësohet të jetë modern dhe i adaptuar me standardet e BE-së. Ky legjislacion ka hapur shumë mundësi të shfrytëzimit të faunës me të cilën disponohet në funksion të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe të vendit në tërësi. Se sa dhe si do të shfrytëzohen këto mundësi, kjo është çështje që do të dëshmohet në vitet e ardhshme.

1.5. UJI DHE ASPEKTI LIGJOR I SHFRYTËZIMIT TË TIJ

Uji është pasuri natyrore me vlerë të madhe dhe kusht i domosdoshëm i jetës. “Kosova ka pasuri të mëdha ujërash. Territori i

³⁷ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/ L-10.

³⁸ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/ L-53.

³⁹ Ligji nr.2004/33.

⁴⁰ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/ L-85.

⁴¹ Ligji nr.2008/5.

saj përbën një nyje hidrografike interesante. Sasia e përgjithshme e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore në Kosovë është 3818.1 milionë metra kub.⁴²

Sidoqoftë, nevojat për ujë po shtohen vazhdimisht për shkak të shtimit të popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike, si dhe standardit jetësor. Ekzaminimet shkencore tregojnë se kjo pasuri natyrore vazhdon të rrezikohet nga mënyra e shfrytëzimit të saj, por edhe nga faktorë të tjerë. Cilësia e ujit po rrezikohet⁴³ dhe furnizimi i popullsisë me ujë të pijshëm nuk është i kënaqshëm.⁴⁴

Siç dihet, pjesa më e madhe e ujit në Kosovë aktualisht shfrytëzohet nga popullsia, pastaj vjen bujqësia dhe industria. Gjendja ekzistuese në Kosovë karakterizohet nga mungesa e ujit si për popullsinë, ashtu edhe për industrinë dhe ujitje. Ky problem do të ketë efekte kufizuese në zhvillimin e shumë pjesëve të Kosovës. Për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë të Kosovës nevojiten mjete të mëdha. Por, pavarësisht nga kjo, është e domosdoshme që resurset e ujit të shfrytëzohen racionalisht si dhe të ruhet cilësia e ujit.⁴⁵

Mbështetur në këto vlerësime, konsideroj se në Kosovë, në periudhën e fundit dhjetëvjeçare, sa i përket tematikës që është objekt i këtij artikulli, është bërë relativisht shumë. Kështu, aktualisht Kosova ka dy ligje, që trajtojnë çështjen e ujit, duke përfshirë këtu çështjen e shfrytëzimit të tij. Këto ligje janë: Ligji për ujërat i Kosovës⁴⁶ dhe Ligji për ujitjen e tokave bujqësore.⁴⁷

Derisa ligji i parë mëton të rregullojë materien që ndërlidhet me ujin në tërësinë e saj, ligji i dytë trajton vetëm çështjen e ujitjes së tokave bujqësore. Së këndejmi, me Ligjin për ujërat rregullohet çështja e administrimit të ujërave, kufizimet e përdorimit publik të ujit, rregullimi dhe kontrollimi i ujërave etj. Nga një analizë, sado e shkurtër, që mund t'iu bëhet këtyre çështjeve, mund të nxirret konkluzioni se qëllimi i këtij Ligji është që të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurive ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin shoqëroro- ekonomik të Kosovës, si dhe të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tejhshfrytëzimi dhe keqpërdorimi. Të këtij

⁴² Për këtë, më gjerësisht, shih: Kosova në, ..., f.26-36.

⁴³ Sasia më e madhe rrjedhëse e ujit i takon kategorisë së katërt. Për këtë, më gjerësisht, shih: Ismet Gusia, vep. e cit., f.181.

⁴⁴ Po aty, f.180-181.

⁴⁵ Po aty, f.182- 184.

⁴⁶ Ligji nr.2004/24.

⁴⁷ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.02/ L-9.

karakteri vlerësohet të jetë pjesa më përmbajtësore e dispozitave të këtij Ligji. Ndërsa aspekti i shfrytëzimit të ujit në lëmin e bujqësisë, në mënyrë specifike rregullohet me Ligji për ujitjen e tokave bujqësore. Ky Ligj rregullon organizimin dhe administrimin e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore në Kosovë, kompetencat dhe ndarjen e përgjegjësive të subjekteve të ujitjes dhe kullimit, formimin dhe regjistrimin e kompanive të ujitjes, tarifat e ujit për ujitje etj. Qëllimi i këtij Ligji (neni 1) është që të krijojë kushtet optimale për ujitjen e tokës bujqësore në Kosovë, mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta me qëllim të shtimit të rendimenteve bujqësore etj. Ligji në fakt rregullon çështjen e shfrytëzimit të ujërave të ashtuquajtura të tepërta për nevojat e zhvillimit ekonomik, në këtë rast të bujqësisë, si sektori ndër më të rëndësishmit të zhvillimit të vendit. Pra, mund të thuhet lirisht se përmes këtyre dy ligjeve Kosova ka krijuar një bazë solide ligjore, gjithsesi jo të përkryer dhe jo pa ndonjë mangësi, të shfrytëzimit të këtij resursi jetik për ekzistencë dhe zhvillim.

Në të vërtetë, fakti se në Kosovë ka probleme me furnizimin e qytetarëve me ujë, me ujitjen ose nevoja të tjera, nuk mund të thuhet se kjo është rrjedhojë e mungesës së legjislacionit, gjegjësisht e zgjidhjeve joadekuate që ai i adreson. Problem kyç edhe këtu është ai që ndërlidhet me zbatimin e legjislacionit ekzistues, avancimin e sistemit të kontrollit dhe përgjegjësive,⁴⁸ por edhe në mungesën e investimeve kapitale, të cilat do të rezultinin me funksionalizimin e infrastrukturës së sistemit “Ibër- Lepenc”, sistemit të “Radoniqit” dhe të kapaciteteve të tjera ujore që disponon vendi.

1.6. RESURSET MINERALE DHE ASPEKTI LIGJOR I SHFRYTËZIMIT TË TYRE

Hulumtimet e realizuara dëshmojnë se Kosova i ka pothuajse të gjitha lëndët e para minerale, madje në sasi të konsiderueshme. Rrjedhimisht, si më të rëndësishme konsiderohen lëndët e para minerale energjetike, madje pikërisht linjiti,⁴⁹ ku sasia e tij përbën 58% të rezervave të përgjithshme. Përveç kësaj, Kosova ka edhe rezerva të konsiderueshme të plumbit, zinkut, argjendit, nikelit,

⁴⁸ Aktualisht, në Kosovë zhvillohet një sistem mjaft i vrazhdë aktivitetesh të shfrytëzimit të zhavorrit nga lumenjtë. Përvoja e viteve të fundit tregon se shfrytëzuesit e këtij zhavorri, jo vetëm që po e ndotin ujin, por po e dëmtojnë edhe sasinë e tij, ngase në shumë raste ata hapësirën e eksploatimit të zhavorrit e lënë fare pa e adoptuar (rregulluar).

⁴⁹ Ismet Gusia, vep. e cit., f.74.

manganit etj. Kosova ka edhe pasuri të mëdha të mineraleve jometalike, si: lëndët e para zjarrdruuese, gurë zbukurimi, deltina të cilësisë së lartë, bentonite, olivinite të freskëta, asbesti e shumë të tjera. Rezervat e plumbit dhe zinkut e radhisin Kosovën në vendet e para të Evropës.⁵⁰

Të dhënat që aktualisht ekzistojnë mbi rezervat ekzistuese të lëndëve të para minerale gjithsesi duhen marrë me rezervë. Kjo për faktin se në Kosovë, me përjashtim të thëngjillit, kërkimet e bëra gjeologjike vlerësohen si jo të mjaftueshme. Së këndejmi, mund të thuhet lirisht se në kushtet aktuale, shtrohet si nevojë emergjente që të bëhen hulumtime të mirëfillta gjeologjike, në mënyrë që të dihen saktësisht rezervat që ka Kosova sa i përket këtyre resurseve. Qëllim i gjithë këtij angazhimi duhet të jetë arritja në stadin i cili garanton shfrytëzim ekonomik të këtyre resurseve natyrore.

Në aspektin ligjor, çështja e resurseve minerale është rregulluar me Ligjin për minierat dhe mineralet në Kosovë⁵¹ dhe me Ligjin për punimet nga metalet e çmuara⁵². Ligji për minierat dhe mineralet në Kosovë trajton aspektet e përgjithshme të çështjeve që ndërlidhen me pasuritë minerale, duke përfshirë këtu çështjet e kërkimit, eksploatimit, ato që kanë të bëjnë me xehetarinë dhe përpunimin e xeheve në Kosovë etj. dhe në mënyrë të veçantë çështjen e shfrytëzimit të këtyre pasurive. Rrjedhimisht, sa i përket çështjes së shfrytëzimit të pasurive minerale, ky Ligj përcakton se ato duhet të shfrytëzohen sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe me racionalitet (neni 37). Ligji për punimet nga metalet e çmuara trajton vetëm çështjen e punimeve të metaleve që kanë epitelin e metalit të çmuar siç është ari, argjendi, platina, bakri etj., pra një aspekt të rëndësishëm të shfrytëzimit të tyre.

Thëngjilli, siç e pamë , është një pasuri e madhe natyrore. Ai është komponent shumë i rëndësishëm i zhvillimit të vendit dhe i mirëqenies së përgjithshme shoqërore. Thëngjilli aktualisht është burimi themelor, që shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike. Duke marrë parasysh peshën e madhe që ka energjia elektrike, por edhe problemet e vazhdueshme që i ka pasur Kosova e këtyre dhjetë vjetëve të fundit në aspektin e furnizimit të vendit me të, tashmë është në finalizim projekti ideor “Kosova e Re” , që është në funksion të shtimit të kapaciteteve të energjisë të nevojshme për tërë vendin.

⁵⁰ Kosova në, ..., f.42-43.

⁵¹ Ligji nr.2005/3.

⁵² Ligji nr.2004/28.

Krahas kësaj, Qeveria e Kosovës ka hartuar edhe strategjinë e energjisë, që gjithashtu vlerësohet një dokument me vlera të mëdha për vendin. Ndërsa, në aspektin ligjor, çështjet që ndërlidhen me mënyrën e shfrytëzimit të kapaciteteve energjetike në vend janë rregulluar me Ligjin për energjinë⁵³ dhe Ligjin për energjinë elektrike.⁵⁴

Derisa me Ligjin për energjinë janë rregulluar aspektet e përgjithshme të strategjisë energjetike në Kosovë, rregullat për sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe efikas të energjisë si dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, me Ligjin për energjinë elektrike janë trajtuar çështjet e prodhimit, bartjes, distribuimit, tregtimit, eksplotimit, importimit dhe tranzitimit të energjisë elektrike.

Marrë në përgjithësi, Kosova vlerësohet të ketë ndërtuar kapacitetet bazike ligjore me të cilat adresohet çështja e shfrytëzimit të burimeve minerale të vendit. Këto ligje, ngjashëm si dhe pjesa tjetër më përmbajtësore e legjislacionit vendor, vlerësohet të jenë në përputhshmëri me direktivat gjegjëse të BE-së dhe, të thuash, identik me legjislacionin e ngjashëm të vendeve të përparuara të Evropës. Kjo përshtypje krijohet në çdo rast kur ky legjislacion krahasohet me legjislacionin përkatës të specifikuar të vendeve të tjera, siç është rasti me Austrinë, Italinë, Kroacinë etj. Së këndejmi, mund të thuhet lirisht se Kosova aktualisht nuk e ka problem çështjen e kapaciteteve ligjore për një shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve minerale dhe burimeve të tjera të energjisë, por problemi kyç edhe këtu, sigurisht, qëndron në zbatimin e tij.

2. DISA LIGJE TË TJERA QË TRAJTOJNË ÇËSHTJE TË SHFRYTËZIMIT TË RESURSEVE NATYRORE

Përveç ligjeve të referuara më lart, në kuadër të këtij artikulli, e shoh të nevojshme të evidencoj edhe disa ligje të tjera, të cilat, në një aspekt ose tjetër, trajtojnë çështje të shfrytëzimit të resurseve natyrore të vendit, gjegjësisht që adresojnë çështje që prekin këtë element me shumë interes për vendin. Konsideroj se epitetin e ligjeve të tilla mund ta kenë edhe: Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor,⁵⁵ Ligji për

⁵³ Ligji nr.2004/8.

⁵⁴ Ligji nr.2004/10.

⁵⁵ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.03/ L-015.

inspektoratin bujqësor,⁵⁶ Ligji për zonat ekonomike,⁵⁷ Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,⁵⁸ Ligji për veprimtarinë hoteliere dhe turistike,⁵⁹ etj.

Në fakt, këto ligje, marrë në tërësi, trajtojnë aspekte të veçanta të çështjeve, për rregullimin e të cilave janë nxjerrë. Megjithatë, në brendinë e tyre ndeshen jo pak dispozita, të cilat trajtojnë edhe aspekte të veçanta të mënyrës së shfrytëzimit të resurseve gjegjëse natyrore të vendit. Kështu, me Ligjin për zonat ekonomike përcaktohet se në zonat ekonomike mund të kryhet çdo lloj veprimtarie, që nuk cenon mjedisin, faunën dhe pasuritë kombëtare të Republikës së Kosovës. Në çdo rast, përcaktimi i territorit të zonës ekonomike duhet të bazohet në arsyeshmërinë ekonomike të destinuar me elaboratin studimor.

PËRFUNDIM

Gjatë trajtimit të çështjes së rregullativës ligjore të shfrytëzimit të resurseve natyrore të Kosovës kam nxjerr këto konstatime:

1. Kosova, ndonëse në aspektin e sipërfaqes tokësore me të cilën disponon konsiderohet shtet i vogël, ajo ka resurse të mëdha natyrore. Pasuritë ndër më të çmueshmet natyrore të Kosovës janë lëndët e para minerale (linjiti, zinku, plumbi, argjendi, nikeli, mangani etj.), pastaj fondi tokësor, bimor, ujqor etj.

2. Për rregullimin e çështjeve që ndërlidhen me resurset natyrore, duke përfshirë këtu aspektet e shfrytëzimit të tyre, Kosova në dhjetë vjetët e fundit ka nxjerrë, të thuash, ligjet e domosdoshme bazike. Këto ligje, marrë në tërësi, konsiderohet të jenë të harmonizuara me direktivat gjegjëse të BE-së, si dhe vlerësohet se, në masë të madhe, vështruar në përmbajtje, janë të ngjashme me ligjet e vendeve të tjera të përparuara të Evropës.

3. Në Kosovë ka nevojë urgjente që të zhvillohen hulumtime të mirëfillta gjeologjike, por edhe hulumtime të tjera, të cilat do të nxirrnin në dritë faktin e vëllimit të pasurive minerale dhe resurseve të tjera natyrore të vendit.

4. Me qëllim që të mundësohet një shfrytëzim racional dhe ekonomik i resurseve natyrore, çmohet nevojë urgjente nxjerrja e një

⁵⁶ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr.03/ L-029.

⁵⁷ Shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës- Ligji nr. 03/ L-129.

⁵⁸ Ligji nr.2004/30.

⁵⁹ Ligji nr.2004/16.

strategjie afatgjate zhvillimore e Kosovës, bazuar kjo në resurset aktuale me të cilat disponon vendi.

5. Si problematika më kyçe, sa i përket çështjes së shfrytëzimit të resurseve natyrore, është ajo e zbatimit të legjislacionit ekzistues. Në këtë aspekt, duhet fokusuar përqendrimin në forcimin e kontrollit dhe përgjegjësisë së të gjitha autoriteteve, të cilat kanë mandat në shfrytëzimin e resurseve natyrore të disponueshme.

Avdullah HOTI

PASURITË NATYRORE DHE ZHVILLIMI EKONOMIK: EVIDENCA DHE IMPLIKIMET PËR POLITIKAT EKONOMIKE

Abstrakt

Historiku i zhvillimit ekonomik në nivel global tregon se në vendet që kanë varshmëri nga pasuritë natyrore, struktura sektoriale e Produktit të Brendshëm Bruto bëhet e pafavorshme për të nxitur zhvillimin e sektorëve prodhues dhe atyre me efekte eksternale pozitive. Në vendet e tilla, ngec zhvillimi institucional, që është parakusht për të krijuar një ambient të favorshëm investues. Edhe pse përdorimi i pasurive natyrore për zhvillim ekonomik fillimisht shkakton një 'boom' ekonomik, në afat të gjatë norma e rritjes ekonomike ngec prapa. Zhvillimi i shpejtë ekonomik i Kosovës, sidomos në vitet 1960 dhe 1970, është bazuar kryesisht në shfrytëzimin e pasurive natyrore. Dinamika e zhvillimit ekonomik të Kosovës e vitit 1945 është në përputhje me evidencën në nivel global – një rritje ekonomike e konsiderueshme fillimisht e përcjell me stagnim ekonomik. Kjo ka krijuar një strukturë të tillë ekonomike, e cila ka lënë pasoja për shumë dekada derisa ekonomia e Kosovës iu është përshtatur zhvillimeve të reja pas viteve 1998-1999. Sidoqoftë, *për se* pasuritë natyrore nuk paraqesin problem për zhvillimin ekonomik? Problemet shkaktohen nga keqmenaxhimi i tyre.

Fjalët kyçe: pasuritë natyrore, zhvillimi ekonomik, bota, Kosova.

1. HYRJJE

Shumë studime kanë trajtuar, në aspektin shkencor, çështjen se pasuritë natyrore të një vendi në kombinim me fuqinë punëtore dhe kapitalin e shpien vendin përpara. Sidoqoftë, ekziston evidencë se posedimi i pasurive natyrore nuk është i mjaftueshëm për të siguruar zhvillim ekonomik. Autorët Gylfason dhe Zoega (2002) argumentojnë

se vendet si Japonia, Hong-Kongu, Luksemburgu e vende të tjera të ngjashme, që janë me nivel të lartë të zhvillimit ekonomik, nuk kanë pasuri natyrore. Në vendet e tjera të zhvilluara si SHBA, pasuritë natyrore, megjithëse ekzistojnë, ato luajnë një rol të vogël në zhvillimin ekonomik.

Në përgjithësi, marrë në aspektin global, pasuritë natyre janë të shpërndara në vendet në zhvillim dhe në vendet e pazhvilluara¹. Disa prej këtyre vendeve kanë arritur të vënë bazat e zhvillimit të tyre afatgjatë bazuar në të ardhurat e siguruara nga shfrytëzimi i pasurive natyrore, ndërsa disa të tjera nuk po mund të dalin nga rrethi vicioz i varfërisë ekstreme, edhe pse të pasura për nga pasuritë natyrore.

Në këtë punim trajtohet roli i pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik të vendit. Janë analizuar studimet aktuale në këtë fushë, të cilat kryesisht nxjerrin në pah rolin negativ të pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik afatgjatë. Punimi tenton të analizojë shkaqet se si shfaqet ky rol negativ. Më tutje, është analizuar zhvillimi ekonomik i Kosovës në kontekst historik për të parë nëse edhe në Kosovë mund të evidentohet ky efekt. Në fund, janë propozuar zgjidhjet e mundshme për të tejkaluar ndikimin negativ të pasurive në zhvillimin ekonomik.

2. PËRMBLEDHJE E LITERATURËS RELEVANTE

Pasuritë natyrore nuk sigurojnë që një vend të ketë zhvillim ekonomik. Kështu, në shekullin XVII, Holanda e varfër, në resurse e ka tejkaluar Spanjën, e cila akumulonte ar dhe argjend nga kolonitë e saja. Në shekullin XIX, Zvicra dhe Japonia, të varfra në resurse, e tejkaluan Rusinë e pasur në resurse. Ndërsa në tridhjetë vjetët e fundit, janë shfaqur Koreja Jugore, Tajvani, Hong-Kongu dhe Singapori, që të gjitha të varfra me resurse krahasuar me Meksikën, Nigerinë dhe Venezuelën, që janë shumë të pasura me resurse.

Sachs dhe Warner (1997), në një studim të tyre, gjejnë se prej 95 vendeve, që janë përfshirë në studim, ato me pjesëmarrje më të lartë të resurseve natyrore në eksportin e vendit në vitin 1970, kanë pasur rritje më të vogël gjatë periudhës 1970-1990. Pjesëmarrja e resurseve natyrore në eksport është matur përmes pjesëmarrjes së produkteve bujqësore, mineraleve dhe naftës në eksportin total. Kjo lidhje është e qëndrueshme edhe kur autorët në vlerësimet përmes regresioneve kontrollojnë karakteristikat e ndryshme të vendeve për të identifikuar

¹ Të gjitha vendet e botës mund të kategorizohen në: vendet e zhvilluara, vendet në zhvillim dhe vendet e pazhvilluara.

vetëm rolin e pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik, ndërsa duke i mbajtur faktorët e tjerë konstant.

Gylfason dhe Zyega (2002), në një studim që analizon zhvillimin ekonomik dhe determinantet e atij zhvillimi për 85 vende të ndryshme të botës nga viti 1965 deri më 1998, konkludojnë se rritja ekonomike dhe investimet kanë pasur lidhje inverze me resurset natyrore. Ata gjejnë se varësia nga resurse natyrore dekurajon kursimet dhe investimet, duke e dëmtuar zhvillimin e sektorit financiar.

Gylfason (2000) gjen gjithashtu se pasuritë natyrore e zvogëlojnë si rritjen ekonomike, po ashtu edhe pjesëmarrjen në arsim. Kjo e fundit krijon probleme afatgjata për vendet, duke e zvogëluar kapitalin njerëzor të mishëruar në fuqinë punëtore dhe duke ulur kështu produktivitetin e punës.

3. SI SHFAQET EFEKTI NEGATIV I PASURIVE NATYRORE NË RITJEN EKONOMIKE?

Studime të ndryshme argumentojnë se posedimi i pasurive natyrore, ose më saktësisht varshmëria e ekonomisë vendore dhe e të ardhurave nga shfrytëzimi i pasurive natyrore, e pengon zhvillimin ekonomik përmes shumë kanaleve. Disa prej tyre mund të jenë: zvogëlimi i normës së kthimit, sëmundja holandeze, dhënia pas përfitimeve, neglizhenca e arsimit të fuqisë punëtore, mungesa e eksternaliteteve, joefikasiteti institucional, që rrjedh nga varësia e të hyrave shtetërore nga renta e siguruar prej pasurive natyrore, ndryshimi i termave të tregtisë së jashtme etj. (Gylfason dhe Zoega, 2002, Gylfason, 2000).

Pasuritë natyrore për nga natyra janë fikse dhe rrjedhimisht përbëjnë kufizim në zhvillimin ekonomik të vendit. Për ndryshim nga këto, pasuritë e ripërtëritshme kanë normë konstante të kthimit. Me një forcë punëtore në rritje në shumicën e vendeve dhe me akumulim të vazhdueshëm të kapitalit, në situatën kur pasuritë natyrore mbesin fikse, mbizotëron ligji i të ardhurave zbritëse. Rast tipik për të ilustruar një situatë të tillë është përdorimi i tokës. Me një sipërfaqe të kufizuar toke, duke shtuar numrin e punëtorëve dhe kapitalin që përdoret në atë pjesë toke, ulet produkti marginal për punëtorë dhe produkti marginal për kapital të përdorur. Megjithatë, një studim nga Nordhaus (1992) ka argumentuar se normë e njëjtë (e pazvogëluar) e outputit për punëtorë mund të sigurohet nëse arrihet progres

teknologjik i mjaftueshëm për të kompensuar rritjen e popullsisë dhe normën e shterjes (harxhimit) të pasurive natyrore.

Në vendet me pasuri natyrore, sektori i prodhimit mbetet nën hije. Kjo ndodh pasi fokusi vihet në shfrytëzimin dhe eksportin e pasurive natyrore, gjë e cila shumë shpesh shpie në rritjen e kursit të këmbimit. Kjo i bën produktet e tjera vendore të shtrenjta për të huajt, duke i ulur eksportet e vendit dhe duke i dekurajuar investitorët dhe ndërmarrësit.

Shumë qeveri të vendeve të pasura me resurse natyrore janë dhënë tepër shumë pas rentës nga shfrytëzimi i pasurive natyrore, duke i lënë anash politikat që nxisin zhvillim ekonomik përmes mbështetjes së sektorëve me përparësi konkurruese. Kjo ka gjetur shprehje edhe si rezultat i mungesës së institucioneve të forta, që sigurojnë ambient të përshtatshëm për zhvillim ekonomik.

Mbështetja e zhvillimit ekonomik në pasuritë natyrore dhe sigurimi i të ardhurave nga renta prej pasurive natyrore krijon një siguri të rrejshme të qeveritë e vendeve përkatëse dhe të popullsisë e tyre. Si rrjedhim, qeveritë dhe individët nuk investojnë sa duhet në ngritjen e nivelit arsimor si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm, që mundëson adaptim të teknologjive të reja dhe progres të përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror.

Shumë studime përgjithësisht argumentojnë se nuk ka eksternalitete nga shfrytëzimi i pasurive në formë të përhapjes së teknologjisë ose akumulimit të kapitalit njerëzor. Njohuritë e fituara nga punësimi në kompani, që janë të orientuara në nxjerrjen dhe shfrytëzimin e pasurive natyrore, janë specifike dhe nuk mund të përdoren në sektorë të tjerë të ekonomisë.


Eksperienca e shumë vendeve, të cilat e bazojnë zhvillimin e tyre ekonomik në shfrytëzimin e pasurive natyrore, ka treguar se qeveritë mund ta keqpërdorin rentën e siguruar nga pasuritë natyrore. Qeveria, gjithashtu, mund të përqendrojë tërë menaxhimin makroekonomik në sigurimin e rentës nga pasuritë natyrore, duke e lënë anash zhvillimin institucional dhe rritjen e efikasitetit të funksionimit të institucioneve. Një sjellje e tillë nga ana e qeverisë është e motivuar edhe politikisht, pasi të ardhurat nga renta janë të ardhura më të sigurta për buxhetin e shtetit sesa të ardhurat nga taksat. Kjo gjë e zvogëlon rolin e taksave në shpenzimet publike, e cila shpie në përkeqësim të mëtejshëm institucional, ngase qeveria nuk ndihet shumë e obliguar të japë përgjegjësi dhe të jetë transparente para taksapaguesve. Nisur nga fakti se efikasiteti i shfrytëzimit institucional është faktor tepër i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik,

kjo shpie drejtpërdrejt në një situatë ku zhvillimi ekonomik i vendit ngec apo bie së bashku me normën e shfrytëzimit të resurseve natyrore.

Zhvillimet ekonomike ndërkombëtare vënë në pah ndryshime të konsiderueshme dhe të vazhdueshme në çmimet e pasurive natyrore. Këto çmime mund të ndryshojnë për arsye ekonomike apo politike (van der Ploeg, 2007). Vendet në nivel botëror po bëhen më pak të varura nga burimet primare të energjisë. Zhvillimi i teknologjive të reja po e zvogëlon varësinë nga pasuritë natyrore në përgjithësi. Kjo e bën të vështirë marrjen e vendimeve investive si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat sa i përket shfrytëzimit të pasurive, duke shpënë në vjetërsimin e kapaciteteve prodhuese.

Efekti negativ i pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik afatgjatë, i analizuar më lart, mund të ilustruhet përmes figurës në vijim (Sachs and Warner, 1997). Supozojmë se ekzistojnë dy ekonomi identike, të cilat rriten me normë të njëjtë, ashtu që drejtëza që paraqet rritjen ekonomike të tyre është plotësisht identike prej pikës 0 (origjinës) deri në pikën A. Le të supozojmë se në njërin prej këtyre ekonomive ka një rritje të menjëhershme të normës së zhvillimit ekonomik për shkak të zbulimit të pasurove natyrore, ashtu që norma e rritjes ekonomike rritet në pikën B. Nga kjo pikë e tutje, këto dy vende kanë normë të ndryshme të rritjes ekonomike. Për shkak të arsyeve të mësipërme, varshmëria e rritjes ekonomike nga pasuritë natyrore e ulë normën e zhvillimit ekonomik me kalimin e viteve.

Fig.1: Norma e zhvillimit ekonomik dhe bomi ekonomik i shkaktuar nga pasuritë natyrore



Burimi: (Sachs and Warnder, 1997).

Në afat të gjatë, vendi që varet nga pasuritë natyrore do të ketë normë më të ulët të zhvillimit ekonomik. Edhe nëse ky vend eventualisht arrin të ketë normë të zhvillimit ekonomik siç e kishte para zbulimit të pasurive natyrore (para kapërcimit në pikën B në figurë), niveli i zhvillimit ekonomik do të mbetet më i ulët se i vendit tjetër.

4. HISTORIKU I ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOSOVËS

Kosova ka një histori unike të zhvillimit ekonomik, si gjatë socializmit, ashtu edhe gjatë tranzicionit. Të dhënat për zhvillimin ekonomik të Kosovës para Luftës së Dytë Botërore mungojnë pothuajse plotësisht, megjithëse atëherë Kosova ishte një vend plotësisht agrar.

Tabela në vijim paraqet normën e zhvillimit ekonomik të Kosovës gjatë socializmit. Prej pas Luftës së Dytë Botërore e deri në vitet '70, Kosova ka përjetuar një normë domethënëse të rritjes ekonomike. Gjatë viteve 1970, Kosova ka përjetuar një normë të rritjes ekonomike të matur në terma real prej 7.5 për qind (1971-1975) dhe 3.6 për qind (1976-1980). Norma e rritjes ekonomike ra gjatë viteve '80 për shkak të problemeve politike pas vitit 1981. Me gjithë normën domethënëse të rritjes ekonomike, Kosova mbeti regjioni më i

pazhvilluar i ish-Jugosllavisë me produkt për kokë banori sa një e katërta e ish-Jugosllavisë në vitin 1989 (ESK, 1989, Bevc, 1993).

Tabela 1: Norma e zhvillimit ekonomik të Kosovës (1948-1988)

1948-1965	5.7
1966-1970	6.0
1971-1975	7.5
1976-1980	3.6
1981-1985	1.8
1986-1988	1.1

Burimi: ESK dhe Instituti Riinvest

Për shkak të mungesës së të dhënave është vështirë të ofrohet një analizë e zhvillimit ekonomik gjatë viteve '90. Të dhënat që ekzistojnë tregojnë se Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) gjatë viteve 1990-1995 ka rënë 50 për qind krahasuar me atë të viteve '80. Rënia e mëtejme e PBB-së u shkaktua nga lufta e viteve 1998-1999. Vlerësuar me çmimet e vitit 2003, PBB për kokë banori kishte rënë nga €1,500, sa ishte në vitin 1987, në më pak €300 në fund të viteve '90-ta (World Bank, 2004; Moalla-Fetini et al., 2005). Shkaqet e kësaj rënie janë sigurisht konfliktet dhe trazirat gjatë viteve '90 dhe lufta e viteve 1998-1999, si dhe mungesa e reformave strukturore gjatë kësaj periudhe.

Që pas mbarimit të luftës, Kosova ka bërë progres në ndërtimin e institucioneve të nevojshme për ekonominë e tregut. Si një ekonomi e dalë nga lufta, me mungesë të investimeve për një kohë të gjatë, Kosova ka arritur një PBB rreth €4.2 miliard apo rreth €1,900 për kokë banori. Sidoqoftë, shkatërrimi i kapacitete prodhuese, që kanë ekzistuar para vitit 1990 dhe mungesa e ndryshimeve strukturore gjatë viteve '90, ka krijuar varshmëri pothuajse të plotë të konsumit nga importi.

5. PASURITË NATYRORE DHE ZHVILLIMI EKONOMIK I KOSOVËS

Evidenca lidhur me përbërjen e produktit gjatë viteve 1945-1989 tregon se rritja ekonomike e Kosovës ka qenë e mbështetur në shfrytëzimin e pasurive natyrore. Kjo dokumentohet me pjesëmarrjen e madhe të eksporteve primare në eksportet totale të Kosovës gjatë

kësaj periudhe dhe me pjesëmarrjen e lartë të industrisë në produktin e përgjithshëm dhe në punësim.

Rritja ekonomike e Kosovës gjatë kësaj periudhe është bazuar në ndërtimin dhe shfrytëzimin e kapaciteteve energjetike dhe në industrinë nxjerrëse, duke krijuar varshmëri të madhe sa iu përket të ardhurave nga këto industri. Me rënien e këtyre industrive gjatë viteve '90, pasojat ishin rritje enorme e papunësisë dhe rënie e PBB-së. Në vitet '70 dhe '80, energjetika, metalet me ngjyra dhe metalurgjia e zezë, merrnin pjesë në produktin shoqëror me 45, ndërsa në punësim 35%. Tabela në vijim paraqet pjesëmarrjen e sektorëve në produktin shoqëror në vitin 1971 dhe 1988.

Tabela 2: Pjesëmarrja e sektorëve në krijimin e produktit shoqëror

Sektorët ekonomikë	1971	1988
Industria dhe e	33.3	47.4
Bujqësia	28.2	20.4
Ndërtimtaria	13.6	5.7
Komunikacioni dhe	4.7	4.0
Tregtia e hotelieria	16.2	16.4
Zejtaria	2.9	2.7
Veprimtaritë e tjera	1.1	3.3

Burimi: Instituti Riinvest

Bazuar në analizën e mësipërme dhe në eksperiencën e vendeve të tjera, dinamika e zhvillimit ekonomik të Kosovës (e paraqitur sipas të dhënave në tabelat më sipër) mund të përshkruhet si një bum ekonomik fillimisht pas Luftës së Dytë Botërore dhe pastaj një rritje të ngadalësuar. Kjo dinamikë e rritjes ekonomike është tipike me përshkrimin e paraqitur në figurën më lart.

Pas vitit 1999, rritja ekonomike e Kosovës nuk është e mbështetur në resurse natyrore. Megjithatë, kjo nuk ka ardhur si rezultat i diversifikimit të aktiviteteve ekonomike, por si rezultat i shkatërrimit të kapaciteteve prodhuese në sektorin primar dhe humbjes së tregjeve të mëparshme ku janë plasuar produktet primare. Po ashtu, sektori privat në Kosovë është mjaft joefikas për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare. Paqartësia politike, e cila në një formë po vazhdon edhe pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, ka bërë


gjithashtu që shumë investitorë të hezitojnë që të investojnë në Kosovë.

6. SI TË ZVOGËLOHET VARSHMËRIA NGA PASURITË NATYRORE?

Nga analiza e mësipërme, varshmëria e zhvillimit ekonomik të një vendi nga pasuritë natyrore është e dëmshme për një zhvillim ekonomik afatgjatë dhe të qëndrueshëm të vendit. Sidoqoftë, duhet ditur se *për se* pasuritë natyre nuk paraqesin problem ? Problemi dhe efekti i tyre negativ në zhvillimin ekonomik vjen nga përdorimi joadekuat dhe keqmenaxhimi i tyre, duke e bërë ekonominë vendore plotësisht të varur nga të ardhurat që vijnë nga shfrytëzimi i pasurive natyrore.

Siç shihet në figurën në vijim, ka vende që, edhe pse të pasura me resurse, nuk janë të varura nga resurset (si SHBA dhe Kanada). Varshmëria nga resurset matet përmes pjesëmarrjes të pasurive natyrore në Produktin e Brendshëm Bruto dhe në eksportet totale. Në ekstremin tjetër janë vendet si Çadi dhe Mali, që janë të varfra me resurse dhe njëkohësisht të varura nga resurset.

Fig.2: Kategorizimi i vendeve sipas varshmërisë nga resurset dhe pasurisë me resurse



Burimi: Gylfason dhe Zoega, 2002

Zgjidhja dhe politika adekuate varen nga ajo se cili efekt negativ dominon në ekonominë vendore që vjen nga shfrytëzimi i pasurive

natyrore. Për të stimuluar veprimtaritë prodhuese krahas shfrytëzimit të pasurive natyrore, qeveria mund të subvencionojë ato përmes buxhetit të shtetit. Renta nga përdorimi i pasurive natyrore mund të lidhet drejtpërdrejt në stimulimin e veprimtarive prodhuese përmes krijimit të kornizës së nevojshme ligjore, e cila e eliminon diskrecionin e qeverive në shfrytëzimin e kësaj rente.

Korniza ligjore mundet, po ashtu, të sigurojë transparencë të plotë të investimit të rentës nga shfrytëzimi i pasurive natyrore në fonde investuese, që sjellin normën më të lartë të kthimit. Të ardhurat e fituara në këtë mënyrë mund të përdoren për të diversifikuar aktivitetin ekonomik të vendit, për të nxitur punësimin në sektorët produktivë dhe në sektorët që karakterizohen me efekte eksternale pozitive, për të investuar në teknologji dhe industri të dijes në përgjithësi dhe për investim në arsim.

LITERATURA

- Asanuma, S. (2008): Natural Resource Abundance and Economic Development: A Curse? Or A Blessing? – Lessons from Indonesia's Experience; *Shinji, Hitotsubashi University*
- Bevc, M. (1993): Rates of return to investment in education in former Yugoslavia in the 1970s and 1980s by region; *Economics of Education Review*, 12(4): 325-343
- De Gregorio, J. (2003): The role of foreign direct investment and natural resources in economic development; *Banco Central de Chile*
- Gylfason, Th. (2000): Natural resources, education and economic development; *Interational Macroeconomics*
- Gylfason. Th. dhe Zoega, G. (2002): Natural resources and economic growth: The role of investment;
- Hoti, A. (2010): Schooling, labour market rewards and emigration decisions: Evidence for Kosova; *Lambert Publishing, Germany (ISBN 978-3-8383-3403-5)*
- Moalla-Fetini, R., Hatanpää, H., Hussein, S., Koliadina, N. (2005): Kosovo: Gearing policies toward growth and development; *International Monetary Fund, Washington*
- Nordhaus, W. (1992): Lethal Model 2: The Limits to Growth Revisited; *Brookings Papers on Economic Activity 2*
- Riinvest (2000): *Economic activities and democratic development of Kosova; Riinvest Institute, 2nd edition, Prishtina*

- Riinvest (2005): Qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës; *Instituti Riinvest*;
- Riinvest Institute (2005): Towards economic viability of Kosova; *Paper presented at a roundtable organised by the Riinvest Institute on 6 December 2005*, Prishtina.
- Sachs, J. dhe Warner, A. (1997): Natural resource abundance and economic growth; *Center for International Development and Harvard Institute for International Development*
- SOK (1989): *Statistical yearbook of SAP of Kosova*; Statistical Office of Kosova, Prishtina, in Albanian
- Van der Ploeg, F. (2007): Challenges and Opportunities for Resource Rich Economies; *Journal of Economic Literature*, 2007
- World Bank (2004): Kosovo economic memorandum; *World Bank, Europe and Central Asia Region, Report 28023-KOS*.

Petrit GASHI

RESURSET NATYRORE DHE NDIKIMI I TYRE NË RRIJTJEN EKONOMIKE: ÇFARË MUND TË THUHET PËR KOSOVËN?

Abstrakt

Identifikimit të faktorëve të rritjes ekonomike i është kushtuar vëmendje e madhe nga bota akademike. Janë dokumentuar një numër i madh faktorësh ekonomikë, politikë dhe socialë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë ndikim në nivelin e rritjes ekonomike. Në mesin e këtyre faktorëve, të një rëndësie të veçantë është konstatuar të jenë edhe resurset natyrore. Mirëpo, sikur që shpesh hasim shpërputhje mendimesh sa u përket çështjeve ekonomike, edhe në rastin e raportit resurse natyrore – rritje ekonomike, studiuesit janë të ndarë. Për një kohë të gjatë ndikimi pozitiv i resurseve natyrore në rritjen ekonomike është konsideruar i patjetërsueshëm. Sidomos pas viteve tetëdhjetë besimi në efektet pozitive të resurseve natyrore fillon të venitet. Duke iu referuar argumenteve dhe rasteve të shumta studimore të prezantuara në literaturë, për vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, ky studim synon të rekomandojë hapa konkretë për Kosovën, me rezerva të mëdha të resurseve natyrore. Edhe për Kosovën, shfrytëzimi eficient i resurseve natyrore duhet të sigurohet, para së gjithash, përmes ngritjes së kualitetit institucional, ngritje kjo e cila do të sigurojë akumulimin e kapitalit human, ky i fundit si mekanizmi kryesor i rritjes ekonomike afatgjate. Të rëndësishme mbeten, gjithashtu, edhe politikat makroekonomike – veçanërisht politikat fiskale prociklike – të cilat sigurojnë që përfitimet nga pasuritë natyrore të ndahen në mes të gjeneratave të sotme dhe atyre të ardhshme.

Fjalët kyçe: resurset natyrore, rritja ekonomike, institucionet, kapitali human.

I. HYRJJE

Në mesin e një numri të madh të faktorëve ekonomikë, politikë dhe socialë, të cilët i ka identifikuar literatura ekonomike, resurset natyrore konsiderohen të jenë një ndër instrumentet e rëndësishme të rritjes ekonomike. Shumë vende në botë, në zhvillim apo të zhvilluara, pjesërisht apo në tërësi, e kanë bazuar rritjen ekonomike mbi resurset natyrore. Literatura ka dokumentuar se sukcesi i Britanisë së Madhe, Gjermanisë dhe i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) gjatë periudhës së Revolucionit Industrial është i lidhur ngushtë me shfrytëzimin e pasurive natyrore (shih Stijns, 2005). Lidhjes pozitive në mes të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike i referohen klasikët si Smithi e Rikardo dhe pasardhësit e tyre. Lidhja pozitive në mes të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike ka qenë e pakontestueshme deri në pjesën e dytë të viteve shtatëdhjetë dhe fillimi i viteve tetëdhjetë. Pas viteve tetëdhjetë, një pjesë e madhe e ekonomistëve e kanë vërtetuar në mënyrë empirike se vendet e pasura me resurse natyrore kanë shënuar rritje më të ngadalshme ekonomike në krahasim me të tjerat, që nuk janë të pasura me resurse të tilla. Gjetjet e këtyre të fundit dokumentojnë se resurset natyrore, përmes kanaleve të tërthorta, veçanërisht përmes institucioneve, mund të ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike. Si rrjedhojë, në literaturë shpesh e gjejmë argumentin se resurset natyrore janë mallkim për vendet që i posedojnë ato!

Mirëpo, për një pjesë tjetër të botës resurset natyrore kanë qenë edhe bekimi i tyre. Në rastin e këtyre të fundit, këto resurse janë shfrytëzuar për përfitime afatgjata, në formë të akumulimit të dijes, zhvillimit institucional, investimeve, të cilat përfundimisht kanë ndikuar në ngritjen e mirëqenies së përgjithshme. Duke u nisur nga kjo bazë, një numër studimesh i viteve të fundit kanë kthyer besimin se resurset natyrore ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike. Për më tepër, ata hedhin poshtë pjesën më të madhe të gjetjeve ekonometrike të deritanishme, duke aluduar se variablat, të cilat janë përdorur për të konstatuar raportin negativ në mes të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike janë specifikuar gabimisht. Për më tepër, kjo rrymë e ekonomistëve dokumentojnë se edhe të dhënat janë interpretuar gabimisht.

Ky punim nuk ka për qëllim të përfshihet në debatin, që ka të bëjë me drejtimin e ndikimit të resurseve natyrore në rritjen ekonomike. Ne, në këtë studim, do të ndjekim logjikën e Frankel-it

(2010), i cili insiston se debati mbi drejtimin e ndikimit të resurseve natyrore në rritjen ekonomike është i fryrë dhe se studiuesit duhet të koncentrohen në gjetjen e rrugëve më të mira për shfrytëzimin e resurseve natyrore, çfarë do të siguronte rritje ekonomike afatgjatë dhe mirëqenie. Frankel insiston se, pa marrë parasysh se cilit tabor i takojmë, atij që beson në raport negativ në mes të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike apo grupit tjetër, edhe më tutje ka hapësirë për të rekomanduar politika, të cilat do ta çojnë një vend në drejtim të shfrytëzimit sa më të mirë të resurseve natyrore. Në të vërtetë, ky punim në asnjë moment nuk synon të theksojë se ka diçka përjetësisht problematike në lidhje me pasuritë natyrore. Në prapavijë të këtij punimi qëndron ideja se resurset natyrore janë një potencial shumë i madh për një vend, mirëpo shfrytëzimi i tyre bart më vete rreziqe të caktuara, të cilat duhet të jenë në llupën e politikëbërësve, e këta të fundit duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të eliminuar kanalet përmes të cilave potencialisht mund të prezantohen këto ndikime negative.

Ky punim mbledh fakte nga hulumtimet e bëra për vende të ndryshme të botës të pasura me resurse natyrore, dhe përpiqet t'i identifikojë praktikrat dhe qasjet më të mira në shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe destinimin e të ardhurave nga këto burime. Më poshtë prezantohen raste të vendeve të cilat shpesh janë prezente në literaturë për efektet e resurseve natyrore dhe masat që kanë ndërmarrë këto vende për të kanalizuar këto resurse në rritje ekonomike dhe mirëqenie. Veçanërisht është fjala për Norvegjinë, Botsvanën dhe vendet e ish-Bashkimit Sovjetik. Grupi i fundit i vendeve është i rëndësishëm të analizohet edhe për një përfundim të një pjese të literaturës: një numër i studiuesve konsiderojnë se reformat transformuese kanë qenë më të ngadalshme në vendet e pasura me resurse natyrore sesa në ato që janë më pak të pasura me resurse. Edhe ky argument mbetet i debatueshëm.

Të gjitha brengat dhe rekomandimet që nxjerr literatura, flasin për rëndësinë e ngritjes së kualitetit të institucioneve si parakusht që shfrytëzimi i resurseve natyrore të sigurojë rritje ekonomike afatgjatë dhe mirëqenie. Pra, është e pakontestueshme që resurset natyrore janë burim shumë i rëndësishëm ekonomik për Kosovën, mirëpo pa institucione funksionale, të cilat, para së gjithash, do t'i orientonin këto burime në drejtim të akumulimit të kapitalit human, nuk do të sigurohet rritje ekonomike afatgjate. Në njërën anë, ngritja e institucioneve, në këtë kontekst, nënkupton, ndër të tjera, krijimin e stabilitetit politik, fuqizimin e zbatimit të ligjit, eliminimin e korrupsionit, dhe mbrojtjen e

të drejtave pronësore. Në anën tjetër, akumulimi i kapitalit human do të thotë shfrytëzim i burimeve natyrore me qëllim të krijimit të një sistemi të fuqishëm arsimor, i cili ngadalë do të krijojë kuadro të reja, të cilat do ta tërheqin Kosovën nga vartësia në resurse natyrore. Për më tepër, resurset humane të zhvilluara do të ndikojnë në diversifikimin e industrive – një tjetër faktor i rëndësishëm i rritjes ekonomike – me theks të veçantë në ngritjen e sektorit të shërbimeve. Për më tepër, dhe jo më pak të rëndësishme për Kosovën, rekomandimet koncentrohen edhe në ngritjen e infrastrukturës dhe përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, faktorë këta të cilët do të ndikojnë, para së gjithash, në fuqizimin e sektorit privat, bartës kryesor i zhvillimit ekonomik afatgjatë. Të rëndësishme mbeten gjithashtu edhe politikat specifike fiskale. Të gjitha këto propozime kanë një synim: të sigurojnë që përfitimet nga pasuritë natyrore të ndahen në mes të gjeneratave të sotme dhe atyre të ardhshme.

Në pjesën e dytë do ofrohet një përmbledhje e burimeve kryesore të rritjes ekonomike. Pjesa në vijim do të koncentrohet në diskutimin e argumenteve, në njërën anë, që lidhin pozitivisht dhe, në anën tjetër, që lidhin negativisht resurset natyrore me rritjen ekonomike. Në këtë pjesë do të prezantohen rastet studimore nga disa vende të ndryshme të pasura me resurse natyrore dhe rezultatet që kanë prodhuar këto resurse për ekonominë e këtyre vendeve. Pjesa e katërt, diskuton rekomandimet më kryesore që gjenden në literaturë në kontekst të Kosovës. Krejt në fund, do ta përmbledhim diskutimin.

II. FAKTORËT E RITJES EKONOMIKE

Me rritjen ekonomike ndërlidhen emrat e klasikëve si Adam Smith dhe David Hume, pastaj të neoklasikëve si Robert Solow, e deri te gjeneratat e reja të përfaqësuar nga Robert Lucas, Jr., Paul Romer dhe Paul Krugman, të cilët janë përgjegjës për qasjen më të re të rritjes ekonomike, të ashtuquajturës Teoria Endogjene e Rritjes. Duhet kuptuar se rrymat apo qasjet në përcaktimin e faktorëve të rritjes ekonomike nuk janë të kufizuara vetëm me teoritë apo shkencëtarët që u potencuan më lart, mirëpo ekzistojnë edhe rrymat të tjera dhe emra të shumtë, të cilët kanë ndërtuar teori sa i përket rritjes ekonomike. Analizimi i këtyre qasjeve nuk është qëllim i këtij studimi, mirëpo është e nevojshme të ofrohet një pasqyrë e faktorëve të cilët janë konstatuar si më me rëndësi për rritjen ekonomike. Kjo pjesë do të na ofrojë një pasqyrë të përgjithshme mbi faktorët e rritjes ekonomike

dhe do t'i paraprijë diskutimit mbi efektet negative të resurseve natyrore në rritjen ekonomike.

Gylfason (2007) bën një përmbledhje të faktorëve të rritjes ekonomike, të cilëve do t'u referohemi në vijim. Sipas tij, të rëndësishme për rritjen ekonomike janë kursimet dhe investimet, përmes të cilave bëhet akumulimi i kapitalit real (infrastruktura fizike, rrugët dhe urat, fabrikat, makineritë, etj.) – Është konstatuar, në raste të ndryshme, rëndësia e investimeve në rritjen ekonomike. Nga investimet, të rëndësisë së veçantë janë argumentuar të jenë investimet në pajisje dhe teknologji. Për më tepër, edukimi, trajnimi, shëndetësia, luajnë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike, pasi që këto çojnë drejt akumulimit të kapitalit human, apo të krijimit të një force më produktive të punës. Në këtë kontekst, i rëndësisë së veçantë është konstatuar të jetë edukimi, madje duke shfrytëzuar parametra të ndryshëm të matjes, si: normat e regjistrimit në shkollë, vitet e shkollimit dhe shpenzimet në edukim. Gjithashtu, të rëndësisë së veçantë janë edhe trajnimi në punë dhe aspektet e tjera të zhvillimit gjatë karrierës. Edhe shëndetit të shoqërisë i është kushtuar vëmendje e veçantë si determinante e rëndësishme e rritjes ekonomike. Rezultatet e hulumtimeve empirike kanë treguar që jetëgjatësia, parametër i përcaktuar nga mënyra e të ushqyerit, sistemi shëndetësor dhe edukimi, ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike.

Grup tjetër faktorësh ka të bëjë me eksportin dhe importin e produkteve, shërbimeve dhe të kapitalit me qëllim të gjenerimit të kapitalit të jashtëm/të huaj. Ekziston një konsensus i përgjithshëm se kapitali i huaj ndikon në rritjen ekonomike, duke rritur nivelin e tërësishëm të kapitalit në ekonominë nacionale, si dhe duke shërbyer si kanal përmes të cilit depërtojnë dija dhe idetë e reja, shkathtësitë, dhe ekspertiza nga jashtë. Për shumë ekonomi, kjo ka qenë rruga e ndjekur për të siguruar rritje ekonomike afatgjatë. Dhe, suksesi i kësaj strategjie është dokumentuar në literaturë. Integrimi financiar (në të cilin përfshihen këmbimet tregtare me jashtë, fluksi i investimeve nga jashtë, remitencat dhe parametra të tjerë të rëndësishëm) për një kohë të gjatë ka qenë faktori kyç me ndikim në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion. Mirëpo, kjo strategji bart më vete rreziqe; një strategji e tillë i bën vendet të ndjeshme ndaj lëvizjeve në ekonominë globale, ciklike apo e natyrave të tjera. Kriza ekonomike globale e viteve 2008 dhe 2009 e dokumentoi këtë më së miri. Vendet më tepër të integruara financiarisht u prekën më shumë nga kriza financiare (p.sh., vendet

Baltike dhe ato të Comonvelthit të Vendeve të Pavarura), ndërsa ato më pak të integruara e kaluan më lehtë këtë sfidë (p.sh., Shqipëria).¹

Ndërtimi i institucioneve kualitative është parametër tjetër i rëndësishëm i rritjes ekonomike. Institucionet ndërtojnë të ashtuquajturin kapital social. Institucionet sigurojnë stabilitet politik, pastaj sigurojnë proceset demokratike në vend, lirinë, funksione të tjera. Për më tepër, institucionet do të sigurojnë një kornizë të fuqishme legislative të përcjellë me mekanizma të fuqishëm të zbatimit të ligjit. Gjithashtu, ato janë përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave pronësore. Vetëm duke realizuar këto funksione, institucionet do të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike.

Sigurimi i likuiditetit ekonomik përmes ndërtimit të kapitalit financiar ndikon në rritjen ekonomike. Në njërën anë, ky aspekt është i lidhur me stabilitetin makroekonomik, pra mbajtjes në nivel të ulët të inflacionit, aq sa do të mbante ekonominë në lëvizje. Niveli i ulët i inflacionit në këtë rast iu referohet normave të përcaktuara sipas Konsensusit të Uashingtonit, që duhet të jetë patjetër njëshifror, madje në pjesën e poshtme. Mirëpo, ka të atillë që mendojnë se niveli i inflacionit deri në 40 për qind nuk do të prodhonte rezultate të padëshiruara për ekonominë nacionale. Në anën tjetër, gjenerimi i kapitalit financiar është i lidhur me sektorë financiarë të fuqishëm. Kohëve të fundit, përveç faktorit konvencional të kapitalit dhe punës, sektori financiar, së bashku me dijen dhe institucionet, llogaritet të jetë një nga parametrat që ndikojnë drejtpërdrejt në ngritjen e përparësive krahasuese të një vendi.

Në fund, sipas përmbledhjes që bën Gylfason, diversifikimi i industrive prodhuese dhe atyre shërbyese është parakusht për rritje ekonomike afatgjatë. Ekonominë e zhvilluara janë të ndërtuara mbi një miks të industrive prodhuese e shërbyese, strukturë e cila determinon rritjen ekonomike dhe avancim të vazhdueshëm të mirëqenies së popullatës. Vendet të cilat janë të pasura me burime natyrore, në shumë raste nuk e kanë një raport të tillë të industrive vendore. Në këto vende, pjesa më e madhe e aktivitetit ekonomik është i koncentruar rreth industrive të ndërlidhura me resurset natyrore. Ka edhe vende të tilla, edhe në mesin e vendeve të zhvilluara, të cilat kanë rënë në kurthin e resurseve natyrore dhe e kanë humbur këtë balanc. Rast konkret është Holanda me zbulimin e burimeve të gazit në Detin e Veriut në fund të

¹ Për efektet e krizës globale financiare në vendet në tranzicion shih raportin e EBRD-së *Transition Report 2009*. Në mënyrë specifike për efektet e krizës në vendet e Evropës Juglindore shih Bartlett dhe Monastiriotis, 2010.

viteve pesëdhjetë (për *Sëmundjen Holandeze* do të diskutohej në pjesën në vijim). Andaj, shpesh vendeve të varura nga resurset natyrore u rekomandohet që të përpiqen t'i diversifikojnë industrinë e tyre. Kjo do t'u mundësonte atyre zhvendosjen nga aktivitetet/industrinë primare, të cilat punësojnë fuqi punëtore me aftësi të ulëta në ato intensive në kapital.

Diskutimi i mësipërm nuk nënkupton se është thënë e tëra rreth burimeve të rritjes ekonomike. Në të vërtetë, një pjesë e faktorëve që janë përmbledhur më lart nuk janë dokumentuar përmes analizave empirike. Për më tepër, literatura identifikon edhe faktorë të tjerë të natyrave të ndryshme, të cilët ndikojnë në rritjen ekonomike. Faktorët gjeografikë, historikë, kulturorë, demografikë, edhe të atillë që janë të lidhur me religjionin, që në raste të caktuara janë dokumentuar se ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike. Në tabelën në vijim po japim një përmbledhje të faktorëve, të cilët janë përdorur për të shpjeguar rritjen ekonomike. Për këtë, do t'u referohemi dy punimeve, njëri nga Sala-i-Martin (1997a) dhe tjetri nga Sala-i-Martin *et al.* (2004), të cilat në mënyrë koncize sjellin ata faktorë që janë të lidhur në mënyrë të qëndrueshme me rritjen ekonomike. Të dyja studimet identifikojnë variablat e ndryshme, të cilat janë përdorur nga autorë të ndryshëm për të shpjeguar lidhjen me rritjen ekonomike (këto studime mbulojnë të gjitha variablat të cilat kanë qenë të rëndësishme në së paku një regresion), dhe këto variabla testohen për konsistencë sipas metodologjisë përkatëse.² Në studimin e parë analizohen 59 variabla, nga të cilat vetëm 22 dalin të jenë të qëndrueshme dhe sistematike. Në studimin e dytë, numri i variablave të testuara është edhe më i lartë, duke kapur shifrën prej 67 variablave, mirëpo numri i variablave që identifikohen si të qëndrueshme dhe sistematike janë vetëm 18, ndërsa tri të tjera identifikohen vetëm pjesërisht të tilla. Detajet janë dhënë në tabelën në vijim.

² Teoritë e rritjes ekonomike nuk specifikojnë qartë se cilët faktorë apo determinante duhet të përfshihen në analizat empirike. Si rrjedhojë, ky fakt ka ndikuar që në regresione të përfshihen faktorë nga më të ndryshmit për të identifikuar ndikimin në rritjen ekonomike. Sala-i-Martin *et al.* (2004), pjesërisht edhe ironikisht, pohojnë se tani mund të numërohen më tepër variabla që janë përfshirë në regresionet e rritjes ekonomike sesa që ka vende në botë. Këto dy studime synojnë të identifikojnë ato variabla të cilat i takojnë, siç shprehen autorët, regresionit 'të vërtetë' për identifikimin e lidhjeve konsistente dhe sistematike në mes të faktorëve të ndryshëm dhe rritjes ekonomike.

TABELA 1: VARIABLAT E LIDHURA NË MËNYRË KONSISTENTE DHE SISTEMATIKE ME RRIJTEN EKONOMIKE

Kategoria	Përshkrimi	1997		2004	
		Efekti	Renditja	Efekti	Renditja
Variablat gjeografike	Variabla që mbulon vendet e Afrikës Nënshahiane	Negativ	8	Negativ	10
	Variabla që mbulon vendet e Azisë Lindore ¹⁾	/	/	Pozitiv	1
	Variabla që mbulon vendet e Amerikës Latine	Negativ	7	Negativ	11
	Distanca nga Ekuatori	Pozitiv	17	Josign.	34
	Kolonitë Spanjolle	Negativ	22	Negativ	13
	Dendësia e popullsisë në rajonet bregdetare	/	/	Pozitiv	6
	Përqindja e sipërfaqes tokësore në vise tropikale	/	/	Negative	5
	Zbatimi i ligjit	Pozitiv	4	/	/
	Të drejtat politike	Pozitiv	6	Josign.	23
	Liritë qytetare	Pozitiv	9	Josign.	40
Variablat politike	Numri i revolucioneve dhe grusht shteteve	Negativ	10	Josign.	41
	Lufta	Negativ	15	Josign.	67

Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore

Variablat e lidhura me religjionin	Përqindja e popullsisë konfuçiane	Pozitiv	3	Pozitiv	9
	Përqindja e popullsisë budiste	Pozitiv	20	Pozitiv	16
	Përqindja e popullsisë myslimane	Pozitiv	5	Pozitiv	15
	Përqindja e popullsisë protestante	Negativ	19	Josign.	29
	Përqindja e popullsisë katolike	Negativ	21	Josign.	35
Investimet ²⁾	Investimet në pajisje	Pozitiv	1	/	/
	Investimet në kategori të tjera, përveç pajisjeve	Pozitiv	16	/	/
	Çmimi mesatar i investimeve në mes të viteve 1960 dhe 1964	/	/	Pozitiv	3
Sektorit primar	Përqindja e sektorit primar në totalin e eksporteve	Negativ	13	Josign.	27
	Pjesëmarrja e sektorit të minierave në GDP	Pozitiv	11	Pozitiv	12
Liberalizimi	Numri i viteve si ekonomi e hapur	Pozitiv	2	Pozitiv	14
Çrregullimet dhe performanca në treg	Çrregullimet në normën reale të këmbimit valutor ⁶⁾	Negativ	18	Negativ	17
	Premia në tregun e zi ³⁾	Negativ	12	/	/

Faktorët human	Shkalla e regjistrimit në edukimin primar në vitin 1960 ⁷⁾	Pozitiv	/	Pozitiv	2
	Indeksi fraksionalizimit etnolinguistik ⁴⁾	Josign.	45	Negativ	17
	Përqindja e popullsisë që flet gjuhë të huaja ⁶⁾	Josign.	30	Positive	21
Faktorë të tjerë makroekonomikë	Niveli i GDP-së për kokë banori në vitin 1960 ^{5), 7)}	Negativ	/	Negativ	4
ë	Pjesëmarrja e qeverisë në konsum në vitin 1960	Josign.	27	Negativ	18
Faktorët demografikë	Dendësia e popullsisë në vitin 1960 ⁶⁾	/	/	Pozitiv	19
	Jetëgjatësia ⁷⁾	Pozitive	/	Pozitiv	8
	Indeksi i prevalencës së malaries	/	/	Negativ	7
Sistemi ekonomik	Shkalla e kapitalizmit	Pozitiv	14	Josign.	64

Burimi: Sala-i-Martin (1997a dhe 1997b) dhe Sala-i-Martin *et al.* (2004).

Vërejtje: ¹⁾ Në studimin e vitit 1997 nuk është analizuar variabla, e cila mbulon vendet e Azisë Lindore, sepse ky efekt është mbuluar përmes pjesëmarrjes së popullsisë me besim konfuçian në totalin e popullsisë.

²⁾ Duhet potencuar se në vend të dy variablave të përdorura në studimin e vitit 1997, në studimin e vitit 2004 përdoret variabla e çmimit mesatar të investimeve në mes të viteve 1960 dhe 1964.

³⁾ Premia në tregun të zi paraqet diferencën në përqindje të normës së këmbimit të valutave në tregun e zi dhe normës zyrtare të këmbimit të valutave.

⁴⁾ Ky faktor paraqet probabilitetin që dy persona në një vend të zgjedhur sipas mostrës së rastit të mos flasin të njëjtën gjuhë. Kjo variabël synon të përshkruajë nivelin e konflikteve në mes të grupeve etnike në një vend dhe efektet e tyre në rritje ekonomike.

⁵⁾ Niveli fillestar i GDP-së për kokë banori (viti 1960 është marrë për bazë nga autorët) llogarit të ashtuquajturën konvergjencë të kushtëzuar (pra të konvergjencës së nivelit të GDP-së për kokë banori në vendet më pak të zhvilluara në nivelin e vendeve të zhvilluara), një nga hipotezat e modeleve neoklasike të rritjes ekonomike.

⁶⁾ Në studimin e vitit 2004, këto variabla janë vetëm pjesërisht të lidhura me rritjen ekonomike.

⁷⁾ Në studimin e vitit 1997, variablat si niveli fillestar i GDP-së për kokë banori, jetëgjatësia, dhe shkalla e regjistrimit në edukimin primar në vitin 1960 trajtohen si variabla fikse dhe përfshihen në të gjitha regresionet e realizuara për të përcaktuar konsistencën dhe qëndrueshmërinë e variablave të tjera të analizuara. Si do që të jetë, autori analizon edhe këto tri variabla për lidhje konsistente dhe sistematike me rritjen ekonomike, e rezultatet e prodhuara janë sikur që janë pritur. Me gjithë analizimin e këtyre tri variablave, autori nuk e bën rangimin e tyre sikur në rastet e variablave të tjera.

Nga ajo çfarë shihet më lart, faktorë nga më të ndryshmit janë evidentuar të kenë ndikim në rritjen ekonomike të një vendi në mënyrë konsistente dhe sistematike. Ata janë të natyrës gjeografike – rajonet e caktuara në botë dhe pozita gjeografike (p.sh., bregdeti) janë më favorizuese për rritjen ekonomike. Gjithashtu, këto studime identifikojnë stabilitetin politik dhe ndërtimin e institucioneve të fuqishme, si një element tjetër të rritjes ekonomike. Për më tepër,

religjione të caktuara janë më favorizuese ndaj rritjes ekonomike. Liberalizimi i tregut, gjithashtu, është një element tjetër me rëndësi. Pastaj, çrregullimet në treg, struktura e industrive dhe investimet, të gjithë këta janë parametra të rëndësishëm të rritjes ekonomike. Në kontekst të strukturës së industrive, duhet potencuar ndikimin pozitiv të industrive ekstraktive në rritjen ekonomike, mbështetje e fuqishme kjo për atë pjesë të literaturës, e cila insiston në lidhjen pozitive në mes të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike, edhe pse variabla që mbulon vendet e pasura me burime natyrore të Afrikës Nënshahiane (shih Stijns, 2005) e dokumenton të kundërtën. Faktorët demografikë janë të një rëndësie të veçantë për rritjen ekonomike. Dhe, për fund, në kontekst të rrymave të fundit mbi normat e rritjes ekonomike, faktori që sot konsiderohet më i rëndësishmi për rritjen ekonomike është kapitali human. Në këtë kategori është identifikuar regjistrimi në edukimin fillestar si faktor kyç i rritjes ekonomike, duke u renditur si faktori i dytë sipas rëndësisë.

Mirëpo, sa janë të rëndësishëm të prezantohen faktorët, lidhja e të cilëve me rritjen ekonomike është identifikuar si e qëndrueshme dhe sistematike, gjithashtu edhe disa nga faktorët të cilët nuk janë treguar si të tillë meritojnë vëmendje të veçantë. Tërheqin syrin disa faktorë, të cilët nuk japin shenja të ndikimit konsistent dhe sistematik në rritjen ekonomike, sikur disa nga variablat politike në studimin e vitit 2004; pastaj, një variabël shumë e rëndësishme makroekonomike, siç është niveli i inflacionit (në të dyja studimet); dhe ato të lidhura me kapitalin human, si shpenzimet publike në edukim dhe shkalla e regjistrimit të studentëve në edukimin superior. Këto përfundime mund të rezultojnë nga fakti se një pjesë e efektit të këtyre variablave në rritjen ekonomike është përshkruar përmes variablave të tjera të përfshira në regresione. Ose, në rastin e inflacionit, thuhet se raporti inflacion – rritje ekonomike është jolinear, ndërsa metodologjia e aplikuar në këto studime krijon mundësi vetëm për raporte lineare.

Diskutimi i arsyeve për një rezultat josignifikant të variablave të cekura më lart është përtej objektivit të këtij studimi, mirëpo, në rastin e variablave të lidhura me sistemin e edukimit, ndoshta, janë një indikacion për politikëbërësit se në cilat nivele të edukimit duhet koncentruar më tepër energjinë. Pastaj, përfundimet që relativizojnë rëndësinë e faktorëve politikë në rritjen ekonomike mund të jenë të qëndrueshme; ne njohim shumë vende në botë me nivel të lartë të riskut politik, mirëpo kanë shënuar progres ekonomik, edhe pse ngritja e mirëqenies në pjesën më të madhe të këtyre rasteve është neglizhuar. Për fund, ndoshta, josignifikanca e variablës së inflacionit është një

mbështetje për ata studiues të cilët pretendojnë se edhe nivele më të larta të inflacionit nuk janë barrë për rritjen ekonomike, ndoshta, janë edhe stimulues të rritjes. Të gjitha këto raporte kërkojnë edhe më tutje analiza derisa të vihet te përfundimet e qëndrueshme.

III. RESURSET NATYRORE – FAKTOR NXITËS APO KUFIZUES I RRRITJES EKONOMIKE

Nga diskutimet e mëhershme vërehet një ndarje e thellë në mes të studiuesve rreth efekteve të resurseve natyrore në rritjen ekonomike. Për një kohë të gjatë, efektet pozitive të resurseve natyrore në rritjen ekonomike ishin të padiskutueshme. Në dekadat e fundit ky besim mori një kahe tjetër, duke pretenduar se resurset natyrore ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike. Mirëpo, disa studime të viteve të fundit e kanë kthyer këtë trend edhe një herë, duke insistuar se studimet që nuk gjejnë lidhje pozitive në mes të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike janë të bazuara në interpretim të gabueshëm të të dhënave dhe metodologji defektuozë. Më poshtë do të japim një përmbledhje të shkurtër të disa nga argumentet e të dy taborëve, duke hedhur dritë mbi dilemën: burimet natyrore – mallkim apo bekim?

A. Resurset natyrore faktor nxitës i rritjes ekonomike

Studimet e shumta kanë dokumentuar se resurset natyrore janë faktorë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. E potencuam edhe më herët se vendet e zhvilluara si Britania e Madhe, Gjermania, SHBA e tjera, në fazat fillestare të ekspansionit ekonomik janë mbështetur në shfrytëzimin e resurseve natyrore. Edhe sot, një pjesë e madhe e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik të vendeve të zhvilluara është e lidhur me shfrytëzimin e resurseve natyrore. Norvegjia, Kanada dhe Australia janë vetëm disa nga vendet e zhvilluara ku resurset natyrore luajnë një rol të rëndësishëm në ekonomi. Edhe vendet në zhvillim kanë arritur t'i drejtojnë pasuritë natyrore në krijim të mirëqenies dhe prosperitetit ekonomik. Raste specifike, të cilat i gjejmë shpesh në literaturë, janë Botsvana dhe Kili (shih më poshtë rastet e diskutuara).

OECD (2008), në raportin e saj mbi menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore potencon se efektet pozitive të resurseve natyrore në ekonominë e një vendi, veçanërisht të atyre në zhvillim, lidhen me krijimin e të ardhurave, efektet në punësim, dhe me rritjen e të hyrave fiskale. Për më tepër, në raport thuhet se efektet e resurseve natyrore shtrihen edhe në dimensione të tjera, madje në formë të ofrimit të burimeve shtesë për jetesë të komuniteteve rreth resurseve natyrore,

pastaj në formë të gjenerimit të eksternaliteteve pozitive, si dhe ofrimit të mundësive për krijimin e kapitalit social (p.sh., kapitalit human, institucioneve, etj.) dhe fizik (p.sh., makineritë, pajisjet, infrastruktura, etj.).³

Mirëpo, cilat janë gjetjet dhe arsyetimet e analizave empirike, që prodhojnë raport pozitiv në mes të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike? Duhet potencuar se debatin për drejtimin e ndikimit të resurseve natyrore e kanë ringjallur disa publikime të tre-katër vjetëve të fundit. Së pari, analiza në Brunnschweiler (2008), si dhe Brunnschweiler dhe Bulte (2008), në një mostër prej rreth 100 vendeve, prodhon efekt pozitiv në mes të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike. Për më tepër, në të dy studimet nuk haset ndonjë efekt negativ i resurseve natyrore në zhvillimin institucional. Në të vërtetë, në një rast (shih Brunnschweiler dhe Bulte, 2008), identifikohet efekt pozitiv i resurseve në zhvillimin institucional. Në anën tjetër, Alexeev dhe Conrad (2009 dhe 2010) gjithashtu e vënë në dyshim efektin negativ të resurseve natyrore në rritje ekonomike. Rezultatet e tyre gati në tërësi hedhin poshtë përfundimet e studimeve që gjejnë lidhje negative në mes të këtyre parametrave, mbi bazën e keqinterpretimit të të dhënave dhe shfrytëzimit të metodologjisë defektuoze. Në një mostër reprezentative, duke shfrytëzuar parametra të ndryshëm në lidhje me resurset natyrore si dhe variabla të tjera kontrolluese, matjet e tyre tregojnë se ndikimi i resurseve natyrore, si i naftës dhe mineraleve, në rritjen afatgjatë ekonomike është pozitiv. Sa u përket institucioneve, edhe në këtë rast, duke shfrytëzuar instrumente të ndryshme të kualitetit institucional, si dhe duke korrigjuar për endogjeneitet, autorët nuk gjejnë fakte që përkrahin argumentet se resurset natyrore ndikojnë negativisht në performansën e institucioneve. Për më tepër, ata demonstrojnë se niveli i efekteve pozitive të resurseve natyrore është më i theksuar në vendet me nivel të ulët të zhvillimit institucional sesa në vendet ku institucionet janë më të fuqishme. Faktikisht, në kontekst të zhvillimit institucional, autorët pretendojnë se vendet me institucione më pak funksionale do të ishin edhe më të varfra po të mos kishin burime natyrore.

³ Banka Botërore (2006) bën ndarjet e kapitalit në tri kategori: natyral, social dhe fizik.

A.1 Norvegjia⁴

- GDP (2009, \$): 267.4 miliardë;
- Vendi i 41-të në botë;
- Rritja e GDP (1961 – 2008, %): 3.52
- GDP për kokë (2009, \$): 57,400;
- Vendi i 5-të në botë;
- Papunësia (2009, %): 3.2;
- Inflacioni (2009, %): 2.1;
- Burimet: nafta, gazi natyror, xehe hekuri, plumb, zink, titanium, nikel, etj.
 - Vendi i 21-të në botë me rezerva të naftës;
 - Eksportuesi i 5-të në botë i naftës më 2009;
 - Vendi i 16-të në botë me rezerva të gazit;
 - Eksportuesi i 2-të në botë i gazit më 2009.

Rezervat e naftës, gazit, dhe të mineraleve janë pjesë shumë e rëndësishme e ekonomisë norvegjeze. Për shndërrimin e këtij potenciali natyror në zhvillim ekonomik dhe mirëqenie janë përgjegjëse institucionet dhe politikat e qëlluara ekonomike. Sipas ligjit, prona mbi burimet e naftës është ‘pronë e përbashkët’, dhe qeveria, përmes tatimeve dhe ngarkesave të tjera fiskale, ka arritur të mbledhë rreth 80 për qind të përfitimeve nga resurset natyrore që nga viti 1980, të cilat grumbullohen në Fondin Pensional. Këto mjete pastaj investohen në tregun e letrave me vlerë, me qëllim të ndarjes së përfitimeve nga nafta në mes të gjeneratës së tashme dhe asaj të ardhshme. Në të njëjtën kohë administrata shtetërore është mbajtur nën kontroll. E gjithë kjo është shoqëruar me një performancë të shkëlqyer investuese dhe me zhvillim të avancuar të sistemit arsimor.

Me gjithë faktin që duket se autoritetet në Norvegji kanë ndërmarrë të gjitha masat me qëllim të evitimit të risqeve që burojnë nga mbështetja në burime natyrore, kriza financiare globale dokumentoi të kundërtën. Rënia drastike e çmimeve në tregun e komoditeve, veçanërisht të naftës, ishte një nga faktorët që ndikoi në rënie të nivelit të rritjes ekonomike në vitin 2008 (rritja ishte 1.8 për qind krahasuar me 2.7 për qind një vit më parë), dhe në vitin 2009 në rritje negative ekonomike (-1.6 për qind). Përveç rrezikut që i kanoset nga volatiliteti i tregjeve të resurseve natyrore, Gylfason (2007)

⁴ Të dhënat nga World Development Indicators (<http://data.worldbank.org/data-catalog>; prill 2011), CIA The World Factbook (www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook; prill 2011) dhe Gylfason (2007).

potencon se në ekonominë norvegjeze ka disa shenja të “Sëmundjes Holandeze” ndaj të cilave duhet kujdes i shtuar.

A.2 Botsuana⁵

- GDP (2009, \$): 25.41miliardë;
 - Vendi i 112-të në botë;
 - Rritja ekonomike (1961 – 2008, %): 9.27
- GDP për kokë banori (2009, \$): 12,800;
 - Vendi i 86-të në botë;
- Papunësia (2007, %): 7.5% (vlerësimet jozyrtare: 40%);
- Inflacioni (2009, %): 8.9%;
- Burimet natyrore: diamantet, bakër, qymyr, krip, xehe hekuri, argjend, etj.
 - Nxjerrja e diamanteve është faktori kyç në rritjen ekonomike;
 - Ky aktivitet gjeneron mbi 30% të GDP-së;
 - Llogaritjet të gjenerojë prej 70 – 80% të të hyrave nga eksporti;
 - Mbulon rreth gjysmën e të hyrave për arkën e shtetit.

Në mesin e viteve gjashtëdhjetë Botsvana kishte vetëm 12 kilometra rrugë të shtruara, 22 individë me diplomë universiteti, dhe rreth 100 të tjerë me shkollë të mesme (shih Acemoglu et al., 2004, për më tepër detaje). Sot, Botsvana së bashku me Republikën Mauritius (ishull në Oqeanin Indian) janë dy mrekullitë ekonomike të Afrikës. Mirëpo, përderisa e dyta e ka bazuar zhvillimin e vet kryesisht në sektorin e shërbimeve, e para ekonominë e saj e ka bazuar në resurse natyrore, në mënyrë specifike në eksploatimin e diamantit. Mirëpo, zbulimi i rezervave të diamantit nuk do të ishte i mjaftueshëm për këtë shtet sikur kjo të mos shoqërohej me dizajnimin e politikave të qëlluara ekonomike dhe zhvillimin institucional, të cilat siguruan që Botsvana të ketë nivelin mesatar më të lartë të rritjes ekonomike në botë në pesë dekadat e fundit, mbi 9 për qind. Masat që siguruan një rritje impulsive për një periudhë kaq të gjatë kanë të bëjnë me dizajnimin dhe aplikimin e një kornize relativisht të fuqishme legislative, duke përfshirë këtu edhe sistemin bazë për zbatimin e kontratave. Për më tepër, administrata ishte e kufizuar, e thjeshtë dhe funksionale. Në këtë kontekst, u zvogëluan në masë të madhe hapësirat për favorizime të

⁵ Të dhënat nga World Development Indicators (<http://data.worldbank.org/data-catalog>; prill 2011), CIA The World Factbook (www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook; prill 2011) dhe Acemoglu et al. (2004).

prodhueseve në industrinë me bazë në burimet natyrore, pastaj korrupsioni dhe hapësira për tendenca grabitqare nga pushteti. E tërë kjo u shoqërua me investime të mëdha në infrastrukturë, edukim, dhe shëndetësi. Shpenzimet në edukim krahasuar me GDP-në e vendit janë gati më të lartat në botë (Gylfason, 2001). Dhe, jo më pak të rëndësishme, ishin politikat fiskale dhe sociale, që i siguruan vendit stabilitet makroekonomik.

Me gjithë këto arritje, Botsvana ballafaqohet ende me probleme. Përveç efekteve të krizës financiare në ekonominë botsvaneze (në vitin 2009 rritja negative e GDP-së ishte -5.4 për qind), kjo e fundit ballafaqohet edhe me problemin shumë të madh të prevalencës së virusit HIV (sipas vlerësimeve prevalenca është e dyta më e larta në botë). Pastaj, një problem tjetër është edhe niveli i lartë i papunësisë, që vlerësimet jozyrtare e ngrenë deri në 40 për qind.

B. Resurset natyrore faktor frenues i rritjes ekonomike

Vendet e zhvilluara, që i theksuam më parë si storje suksesi, me kohë kanë arritur të eliminojnë vartësinë nga resurset natyrore, duke zhvilluar paralelisht edhe sektorë të tjerë të ekonomisë, veçanërisht shërbimet. Vartësia krijon hapësira për devijime në politikëbërje dhe në ndërtim të institucioneve. Kjo është thembër e Akilit për vendet e varura nga resurset natyrore dhe kanal përmes të cilit resurset natyrore mund të prodhojnë efekte negative në rritjen ekonomike. Sipas literaturës, ndikimi negativ i resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik nuk është i drejtpërdrejtë, por i tërthortë, zakonisht përmes ndikimit në performancën e institucioneve. Argumenti vazhdon tutje: pa institucione kualitative edhe efektet e politikave ekonomike, sado të qëlluara qofshin, do të jenë të kufizuara. Ky është pikërisht fati i një numri të madh të vendeve në zhvillim, e njëkohësisht edhe mallkimi i tyre.

Në mënyrë specifike, literatura ka identifikuar një numër kanalesh përmes të cilave përçohen efektet jo të dëshiruara të burimeve natyrore në rritjen ekonomike (shih Sachs and Warner, 1995; Gylfason, 2001; Auty, 1993, 2001; Mehlum et al., 2006; e të tjerë). Emërues i përbashkët i të gjithë këtyre faktorëve është kualiteti i dobët institucional. Kanali i parë, që duhet përmendur në këtë kontekst, është e ashtuquajtura “Sëmundja Holandeze”, koncept ky që u farkua nga gazeta *The Economist* për të përshkruar efektet e zbulimit të gazit nga Holanda në fund të viteve pesëdhjetë. Shkurt, efekti i “Sëmundjes Holandeze” mund të përshkruhet si në vijim: zbulimi i rezervave të një burimi natyror do të tërheqë pas vetes një pjesë të

madhe të aktivitetit ekonomik së bashku me një fluks të konsiderueshëm të kapitalit të huaj. Si rrjedhojë e rritjes së kërkesës nga jashtë për këtë produkt, të hyrat e gjeneruara nga eksporti do të ndikojnë në rritjen e vlerës reale të valutës kombëtare (apo të pagave reale). Rritja e vlerës së valutës kombëtare do të ndikojë në uljen e nivelit të konkurrencës të sektorëve të tjerë të ekonomisë në tregun e jashtëm, veçanërisht të sektorëve të tjerë të prodhimit.

Një tjetër kanal transmetues i efekteve negative të burimeve natyrore në rritjen ekonomike është përmes tendencave të prodhuesve për të përfituar sa më shumë nga shfrytëzimi i resurseve natyrore. Në raste të caktuara, kjo ka nxitur edhe luftëra civile (raste të ndryshme në Afrikë). Për më tepër, apetitet për të fituar sa më tepër nga resurset natyrore mund të çojnë drejt përqendrimit të fuqisë politike dhe ekonomike në duart e elitave të caktuara, të cilat mund ta shfrytëzojnë këtë fuqi për të ardhur në pushtet apo për ta mbajtur pushtetin, duke injoruar kështu parimet demokratike, që patjetër do të ketë reflektime edhe në rritjen ekonomike të vendit. Në raste të tjera, qeveritë do të injorojnë mekanizmat e tregut dhe t'u ofrojnë privilegje ndërmarrjeve apo individëve për shfrytëzimin e resurseve natyrore (të dyja deklaratimet e fundit kujtojnë Rusinë). Këta hapa ndikojnë në rritjen e korrupsionit dhe në alokimin e gabueshëm të resurseve, duke ndikuar kështu në uljen e efijencës ekonomike dhe të barazisë sociale.

Gylfason (2001, f.850) thotë që 'prindërit e pasur shpesh i lazdrojnë fëmijët. Nëna natyrë në raste të caktuara e bën të njëjtën'. Posedimi i burimeve të shumta natyrore shkakton një ndjenjë të rreme të sigurisë si për njerëzit, ashtu edhe për qeveritë e këtyre vendeve, duke shkaktuar neglizhencën e politikave dhe masave të tjera që sigurojnë rritje ekonomike, duke përfshirë këtu liberalizimin e tregut, zvogëlimin e burokracisë dhe ngritjen e kualitetit institucional. Edhe më keq, në shumë raste të analizuara të vendeve të pasura me resurse natyrore shihet gjithashtu një neglizhencë e vazhdueshme e burimeve njerëzore, duke mos investuar në edukim dhe zhvillim të gjeneratave të ardhshme. Kjo është një sfidë e veçantë. Në studimin e Xala-i-Martin et al. (2004) e pamë që faktori i dytë më me rëndësi për zhvillimin ekonomik afatgjatë është pjesëmarrja e nxënësve në shkollimin primar. Për më tepër, u identifikuan edhe parametra të tjerë, që lidhen me zhvillimin e resurseve humane, rëndësia e të cilave është e pakontestueshme për rritjen ekonomike.

B.1 Vendet në tranzicion⁶

- *Rritja ekonomike (1999-2008, %) – Rusi: 5.5; Kazakistan: 8.0%; dhe Uzbekistan: 6.3;*
- *GDP për kokë banori (2010, \$) – Rusi: 15,900; Kazakistan: 12,800; dhe Uzbekistan: 3,100;*
- *Papunësia (2010, %) – Rusi: 7.6; Kazakistan: 5.5; dhe Uzbekistan: 1.1;*
- *Inflacioni (2010, %) – Rusi: 6.7; Kazakistan: 7.8; dhe Uzbekistan: 15.0;*
- *Burimet natyrore –*
 - *Rusia në vitin 2009 ishte eksportuesi më i madh i gazit natyror në botë, i dytë i naftës, dhe eksportuesi i tretë i çelikut dhe aluminit bazë.*
 - *Kazakistani ka rezerva enorme të naftës dhe gazit, si dhe rezerva të mëdha të mineraleve dhe metaleve si uranium, bakër e zink.*
 - *Uzbekistani është eksportues i gazit dhe i naftës. Të tjerë komponentë të rëndësishëm për ekonominë janë ari dhe pambuku. Sa i përket produktit të fundit, Uzbekistani tani është eksportuesi i dytë më i madh i pambukut në botë.*

Komonvelthi i Vendeve të Pavarura (ish entitetet e Bashkimit Sovjetik, duke përfshirë këtu edhe Rusinë) veçohen për nga rezervat enorme të resurseve natyrore, si të naftës, gazit, mineraleve dhe metaleve. Duket që këto vende, ndoshta pjesa më e madhe e ish-bloku socialist, të jenë të predispozuar që të dështojnë në kanalizimin e resurseve natyrore në rritje ekonomike dhe mirëqenie. Këto indikacione janë të lidhura me kushtet fillestare, nivelin e ngritjes institucionale, progresin në reforma strukturore, jostabilitetin makroekonomik dhe parametra të tjerë. Një pjesë e madhe e literaturës identifikon probleme të shumta, që janë të lidhura me menaxhimin e keq të resurseve natyrore (shih Kronenberg, 2004). Rritja reale e valutës kombëtare, favorizimi i prodhuesve, korrupsioni, neglizhenca e sektorit të edukimit, të gjitha këto janë tipike për Rusinë, Kazakistanin, Uzbekistanin e vende të tjera. Mirëpo, çfarë është e veçantë për vendet në tranzicion, literatura identifikon edhe një devijim tjetër: është fjala për reformat gjithëpërfshirëse- pjesë e procesit

⁶ Të dhënat nga World Development Indicators (<http://data.worldbank.org/data-catalog>; prill 2011), CIA The World Factbook (www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook; prill 2011), Markandya dhe Averbchenkova (2001) për Rusinë dhe Auty (2001) për Kazakistanin dhe Uzbekistanin.

të transformimit në ekonominë e tregut. Hulumtimet tregojnë se vendet e pasura me burime natyrore kanë qenë shumë më të ngadalshme në realizimin e reformave në ekonominë e tregut. Ngadalësimi i reformave (p.sh., transformimi i pronës, reformimi i sistemit fiskal) nga këto vende shpjegohet me faktin e thjeshtë se të hyrat nga shfrytëzimi i burimeve u japin komoditet të caktuar, duke i bërë këto vende më pasive në reforma.

Rrezikun nga vartësia në resurse natyrore këto vende e ndien në kurriz veçanërisht gjatë krizës financiare globale. Ekonomia ruse ishte një nga më të prekurat, me rënie ekonomike mesatare prej 7.8 për qind në vitin 2009. Për të ngadalësuar zhvleftësimin e rublës, Banka Qendrore shpenzoi rreth \$200 miliardë të rezervave të saj konvertibile. Gjithashtu, edhe qeveria shpenzoi rreth \$200 milionë për të rritur likuiditetin e sistemit bankar dhe për të ndihmuar sektorin e ndërmarrjeve.⁷

IV. MËSIMET PËR KOSOVËN


Ekzistenca e burimeve natyrore është një përparësi e madhe për secilin vend, andaj, edhe Kosova duhet ta shohë pasurinë e saj natyrore si një mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim. E thamë më herët që për shumë vende në botë, të zhvilluara dhe në zhvillim, resurset natyrore kanë qenë të një rëndësie të veçantë për progresin e tyre ekonomik. Duhet ritheksuar se me gjithë një numri defektesh të lidhura me shfrytëzimin e resurseve natyrore, në fakt, në këtë punim në asnjë moment nuk synohet të thuhet se ka diçka negative në lidhje me posedimin e resurseve natyrore. I tërë problemi konsiston në atë se shfrytëzimi eficient i resurseve kërkon një kontekst të caktuar, që është i ndërlidhur me institucione funksionale dhe politika të mira ekonomike. Ky qëndrim yni është në të njëjtën linjë me pjesën më të madhe të studimeve. Shembull, Gylfason (2001, p. 851) potencon se ‘nuk është problem ekzistenca e pasurive natyrore, por është dështimi i autoriteteve publike për të evituar rreziqet që shoqërojnë këtë dhuratë të natyrës. Politikat e mira patjetër që do t’i kthejnë pasuritë e natyrës në bekim’.

Edhe po të abstrakojmë kanalet e tërthorta të ndikimit negativ në rritjen ekonomike, zhvillimi ekonomik i bazuar në burimet natyrore është i paqëndrueshëm në afat të gjatë. Kjo, për dy arsye: *së pari*, burimet natyrore janë të shtershme (apo të kufizuara); dhe, *së dyti*,

⁷ Shih CIA The World Factbook (www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook; prill 2011).

tregjet e komoditeteve (mënyra se si iu referohemi produkteve me bazë natyrore) janë shumë të ndjeshme apo volatile. Çështja e fluktuimeve në tregun e komoditeteve u cek më herët. I pamë disa raste të efekteve çrregulluese të krizës financiare globale në vende të ndryshme në botë, veçanërisht në vendet në të cilat resurset natyrore luajnë një rol të theksuar në jetën ekonomike. Grafiku në vijim pasqyron pikërisht fluktuimet në indeksin e çmimeve të metaleve në 25 vjetët e fundit, ku vërehet rënia drastike e çmimeve në vitin 2008. Si do që të jetë, fluktuimet në çmime janë evidente në të gjithë periudhën e analizuar. Efektet e lëvizjeve të fundit të çmimeve i shohim edhe në Kosovë, të cilat shkaktuan rënie të konsiderueshme të eksporteve, veçanërisht në vitin 2009 (për më shumë detaje shih: Gashi, 2010).

FIGURA – VLERA E INDEKSIT TË ÇMIMIT TË METALEVE (2005=100)



Burimi: <http://www.indexmundi.com>.

Vërejtje: Indeksi i çmimeve të metaleve përfshin indekset e çmimeve të bakrit, aluminit, xehes së hekurit, kallajit, nikelit, zinkut, plumbit dhe uranit.

Si rrjedhojë e paqëndrueshmërisë së rritjes ekonomike të bazuar në resurset natyrore, diversifikimi i industrive dhe i aktivitetit

ekonomik mbetet një nga opsionet e rëndësishme që siguron qëndrueshmëri ekonomike afatgjate. Për një kohë është menduar (e në qarqe të caktuara kjo ide ende mbijeton, edhe pse pjesërisht e modifikuar) që ky diversifikim duhet të arrihet pikërisht përmes industrive të bazuara në resurse natyrore. Faktikisht, të ardhurat e gjeneruara nga industritë e bazuara në resurse natyrore duhet të shfrytëzoheshin për krijimin e degëve të tjera të industrisë. Në shumë vende kjo qasje nuk dha rezultatet e pritura. Si do të jetë, Rodrik (2010) është i mendimit se politika industriale asnjëherë nuk e ka humbur rëndësinë e vet, edhe pse për një kohë kjo mendohej se ishte e tejkualuar.⁸ Rodrik mendon se problemi me politikën industriale nuk është se a duhet aplikuar, mirëpo se si duhet realizuar këtë politikë. Për suksesin e politikës industriale, sipas tij, më shumë është e rëndësishme të krijohet një klimë e mirë bashkëpunimi në mes sektorit privat e qeverisë sesa të përkrahen financiarisht bizneset. Pastaj, përkrahja nga qeveria duhet të jetë e përkohshme dhe e bazuar në performansë. Dhe, në fund, qeveria duhet të jetë në gjendje të vlerësojë se kur duhet ndërprerë përkrahjen për sektorët apo firmat, të cilat nuk japin rezultatet e pritura.

Ky mund të jetë edhe mësimi i parë për Kosovën, pra paralelisht me krijimin e mekanizmave efikas për shfrytëzimin e resurseve natyrore, një pjesë të të ardhurave nga to t'i orientojë në krijimin e kapaciteteve të reja industriale (larg industrive me bazë natyrore), në kontekst të përvojave më të mira (duke përfshirë këtu edhe rekomandimet e Rodrikut). Ky është një rekomandim që ngërthen në veti shumë rreziqe, sidomos për Kosovën me nivel të diskutueshëm të zhvillimit institucional. Zhvillimet e fundit na tregojnë se gjasat janë të vogla që mekanizmat institucionalë të jenë në gjendje të krijojnë një raport partneriteti me sektorin privat për të avancuar politikën industriale. Për më tepër, rreziku mund të vijë nga grupet e fuqishme të interesit, apo elitat, të cilat do të mund të imponojnë orientimin e resurseve në industri apo firma joprfitabile. Pavarësisht nga kjo, ky është një opsion, që duhet të merret parasysh në të ardhmen.

Më poshtë po japim edhe disa rekomandime për Kosovën, që rezultojnë nga përvojat e vendeve të ndryshme në botë, në ekonominë e të cilave resurset natyrore luajnë një rol të rëndësishëm. Për më

⁸ Rodrik, D. (2010), The Return of Industrial Policy. Artikull i shkruar për *Project Syndicate*. Shih <http://www.project-syndicate.org/commentary/rodrik42/English> (prill 2011).

tepër, në kontekst të Kosovës do të komentojmë disa nga rekomandimet e studimit të Jeffrey Frankel (2010), që propozon një numër hapash për të evituar efektet e mundshme negative të resurseve natyrore gjatë cikleve në tregun e komoditeteve. Do të ndalemi fillimisht te rëndësia e institucioneve, pastaj te sistemi edukativ, për të siguruar rritje afatgjatë (që është e ndërlidhur me të parën), dhe, në fund, do të diskutojmë disa politika makroekonomike, veçanërisht ato fiskale të përshtatshme në kontekst të Kosovës.

A. Institucionet dhe resurset natyrore

Viteve të fundit shohim një rrymë të re në mendimin ekonomik, e prire nga studiues prominent si Robert Barro e Dani Rodrik të Harvardit dhe Daron Açemoglu i MIT, të cilët pretendojnë se institucionet janë faktor bazë, që përcaktojnë se cilat vende arrijnë progres ekonomik e cilat jo. Sipas tyre, pa institucione të fuqishme, edhe politikat ekonomike nuk kanë kuptim. Për më tepër, institucionet e dobëta e rrisin riskun e vendit, çojnë në pabarazi, krijojnë kushte që elitat dhe politikanët të grabisin vendin, e në raste të caktuara edhe diktatura. Në kontekst të ndikimit të burimeve natyrore në zhvillimin ekonomik, është një konsensus i përgjithshëm (dhe përvojat e prezantuara këtu e dokumentojnë) se kualiteti i institucioneve determinon atë se a do të jenë burimet natyrore mallkim apo bekim për vendet të cilat i posedojnë ato.

Edhe në rastin e Kosovës, zhvillimi i institucional – duke përfshirë këtu përcaktimin e të drejtave pronësore si dhe zhvillimin e një kornize të fuqishme ligjore e përcjell me mekanizma efikas të zbatimit të ligjit – është parametri kyç në kanalizimin e burimeve natyrore në zhvillimin afatgjatë ekonomik të Kosovës. Janë ‘institucionet e pronës private’, ato të cilat sigurojnë shfrytëzimin e suksesshëm të burimeve natyrore dhe që ndikojnë në rritjen ekonomike dhe të mirëqenies. Këto institucione duhet të sigurojnë të drejtat pronësore të investitorëve, ekzistent dhe potencial, nga eksproprijimi dhe nacionalizimi, dhe të trajtojnë njësoj të gjithë investitorët, të vendit e të huaj. Në të njëjtën kohë, institucionet do të jenë përgjegjëse për sigurimin e stabilitet politik. Për më tepër, ato do të krijojnë mekanizma që do të sigurojnë që elitat politike të jenë të kufizuara nga sistemi politik. Ato do të sigurojnë përfshirje të gjerë të shoqërisë në përfitimet nga shfrytëzimi i resurseve natyrore. Dhe, për fund, institucionet do të koncentrohen edhe në ngritjen e infrastrukturës dhe përmirësimit të ambientit të të bërit biznes, faktorë këta të cilët do

të ndikojnë, para së gjithash, në fuqizimin e sektorit privat, bartës kryesor i zhvillimit ekonomik afatgjatë.

Mirëpo, propozimet që u dhanë në kontekst të zhvillimit institucional, janë përafërsisht të njëjtat rekomandime që përgjithësisht do të jepeshin për ngritjen e kualitetit të institucioneve me qëllim të funksionimit të mirë të ekonomisë së tregut.⁹ Frankel (2010) propozon hapa më konkret në këtë drejtim.¹⁰ Për vendet e pasura me resurse natyrore, vende këto që ballafaqohen me rrezikun e përhershëm të luhatjeve të çmimeve, Frankel propozon krijimin e institucioneve, të cilat do t'i bëjnë kursimet në nivel të vendit prociklike.¹¹ Thënë thjesht, këto institucione do të jenë përgjegjëse që të kursehet më shumë gjatë ngritjeve të çmimeve në tregun e komoditeteve, e të shpenzohet më tepër kur çmimet bien. Së pari, Frankel propozon krijimin e të ashtuquajturave Fonde Sovrane të Pasurisë (siç e pamë rastin e Norvegjisë me Fondin Pensional), të cilat do t'i investonin mjetet në tregun e letrave me vlerë. Mirëpo, krijimi i një mekanizmi të tillë nuk do ta pengonte politikëbërjen në Kosovë që të mos i 'fus duart' në të për plotësimin e objektivave afatshkurtër, si për shembull të rritjes së konsumit qeveritar apo të pagave. Andaj, për funksionimin e këtyre mekanizmave është parakusht që këto fonde të menaxhohen profesionalisht dhe në mënyrë transparente, e njëkohësisht me ligj të kufizohen mundësitë e intervenimeve nga politika për mënyrën e shpenzimeve të këtyre fondeve.

Një qasje tjetër për menaxhimin e të ardhurave nga shfrytëzimi i burimeve natyrore është që kjo detyrë t'i lihet në dorë një mekanizmi të jashtëm. Në këtë kontekst, rasti i Çadit është interesant për t'u

⁹ E njëjta vlen edhe për ngritjen e sistemit të edukimit.

¹⁰ Frankel (2010) propozon një numër të madh masash, mirëpo ne do të koncentrohemi vetëm në ato që mund t'i përshtaten kontekstit të Kosovës.

¹¹ Përveç krijimit të institucioneve, Frankel propozon masa të caktuara afatshurtra për të evituar risqet që dalin nga ciklet e çmimeve të komoditeteve. Për Kosovën, një nga to bie në sy veçanërisht. Për vendet eksportuese të energjisë – dhe Kosova ka synim të bëhet fuqi eksportuese e energjisë në të ardhmen – Frankel propozon të ashtuquajturat indeks kontratat, përmes të cilave të dy palët pajtohen paraprakisht që nëse çmimet botërore rriten për një nivel të caktuar, atëherë përfitimet do të ndahen në mes të qeverisë dhe kompanisë blerëse sipas një parimi të paracaktuar. Indeksi i kontratave është një mekanizëm për ndarjen e riskut dhe të përfitimeve, pa shpenzime të rinegocijimit të kontratave. Për më tepër, kjo nuk e dëmton reputacionin e shtetit në tregun global, i cili mund të luhatet nëse shihen indikacione që qeveria e vendit ka tendencë të rinegociojë kontratat. Kjo do të përcillte një mesazh të pakëndshëm te investitorët potencialë.

komentuar. Në vitin 2000, Banka Botërore u pajtua t'i ndihmojë Çadit në ndërtimin e naftës-jellësit deri në një port të Kamerunit, me kushtin që 72 për qind të të ardhurave nga eksporti i naftës do të investoheshin në uljen e varfërisë (përmes investimeve në shëndetësi, edukim dhe në infrastrukturën rrugore), si dhe të ndajë 10 për qind të këtyre të ardhurave për gjeneratat e ardhshme. Kompania kontraktuese u obligua që t'i depozitojë këto mjete në një llogari bankare specifike dhe u përcaktua që shpenzimi i këtyre mjeteve të kontrollohet nga një panel i pavarur. Mirëpo, me rritjen e fluksit të të ardhurave nga eksporti i naftës, Qeveria e Çadit, një ndër më të korruptuarat në botë, prishi marrëveshjen pas tetë vjetësh të ekzistencës së saj.¹² Për të evituar situata të tilla, prapë kërkohet menaxhim i pavarur dhe transparencë në të gjithë procesin. Mirëpo, qenësore në këtë rast është përkushtimi i qeverisë së vendit për realizimin e këtyre marrëdhënieve kontraktuese.

Shpërndarja proporcionale për kokë banori e të ardhurave nga shfrytëzimi i resurseve natyrore është një tjetër opsion që rekomandohet nga Frankel, por edhe nga të tjerë. Shteti i Alaskës është një rast specifik, ku është e përcaktuar me ligj që gjysma e përfitimeve nga investimet në sektorin e naftës t'u shpërndahet banorëve në mënyrë proporcionale. Arsyeja për këtë hap qëndron në atë se individët presupozohet të jenë në gjendje që më mirë t'i shenjëzojnë mjetet se qeveria. Për më tepër, kjo i bën banorët e Alaskës të ndihen bashkëpronarë të këtyre burimeve.

B. Zhvillimi i faktorit njeri

Siç e dokumentuam më herët, faktori njeri është kyç për zhvillimin ekonomik afatgjatë. Një nga mësimet që mund të nxirret për Kosovën, e që doli nga shoshitja e literaturës, është se shfrytëzimi i një pjese të të hyrave të gjeneruara nga eksploatimi i burimeve natyrore [dhe jo vetëm këto] duhet të drejtohet në rritjen e vazhdueshme të investimeve në edukim dhe në zhvillimin e faktorit njeri. Kjo e bën edhe më urgjente rritjen e kualitetit të institucioneve, pasi që efektet e shfrytëzimit të burimeve natyrore në akumulimin e burimeve njerëzore kanalizohen përmes institucioneve. Dhe, sa më tepër edukim, apo sa më i lartë niveli i edukimit, aq më tepër është e mundur zhvendosja e përparësive krahasuese nga sektorët e bazuar në

¹² Mjetet filluan menjëherë të orientohen në blerjen e armatimit për të kontrolluar fraksionet rivale brenda vendit, si dhe për të evituar rreziqet nga jashtë. Për më tepër shih *The Economist*, Breaking the bank: A vaunted model development project goes awry, 25 shtator 2008.

burime natyrore drejt sektorëve të prodhimit apo shërbimeve. Mirëpo, analizat e prezantuara në këtë studim tregojnë se disa qasje në ngritjen e kapitalit human përmes sistemit edukativ janë më të qëndrueshme se të tjerat. Është krejt përtej objektit të studimit të këtij punimi dhënia e rekomandimeve për avancimin e sistemit të edukimit në Kosovë, mirëpo, literatura e prezantuar këtu na jep indikacione të caktuara së paku për atë se çfarë duhet të ketë prioritet në zhvillimin e sistemit edukativ. Për shembull, politikëbërja duhet të koncentrohet në nivelet fillestare të edukimit (norma e regjistrimit të nxënësve në edukimin fillestar ishte faktori me intensitet të dytë më të lartë në rritjen ekonomike), sepse orientimi i energjisë në nivelet më të larta të edukimit është më pak produktiv (pjesëmarrja në edukimin e lartë nuk ishte e rëndësishme).

C. Politika të tjera makroekonomike

Frankel (2010) përmbledh një numër të politikave monetare dhe fiskale për vendet e pasura me resurse natyrore. Edhe këto synojnë evitimin e efekteve negative kur cikli i lëvizjes së çmimeve është në rënie. Për Kosovën, shfrytëzimi i mekanizmave të politikës monetare nuk është opsion.¹³ Andaj, mbeten mekanizmat e politikës fiskale për të intervenuar në situata të tilla. Gjatë ngritjes së çmimeve të komoditeteve qeveritë kanë tendencë të rrisin investimet kapitale apo pagat në sektorin publik. Nuk do të kishte asgjë të keqe nga këto sikur fluksi i të hyrave të mund të mbahej konstant. Mirëpo, në të dyja rastet, rënia e të hyrave ndikon negativisht. Në rastin e projekteve investuese, gjatë rritjes së fluksit të të hyrave, qeverive të vendit u rritet apetiti për investime të mëdha dhe afatgjata kapitale. Me rënien e fluksit të të hyrave, projektet e tilla rrezikohen të ndërpriten, apo në raste të caktuara mungojnë mjete për mirëmbajtjen e tyre. Të njëjtën situatë e shohim edhe sa i përket rritjes së faturës së pagave në sektorin publik, e cila vështirë mund të ulet me rastin e rënies të të ardhurave nga shfrytëzimi i burimeve natyrore.

Çfarë mund të bëhet që të evitohet një situatë e tillë? Në raste të tilla, zakonisht aludohet në rastin e Kilit, dhe rregullave specifike që ka aplikuar ky vend për menaxhimin e buxhetit të shtetit. Kili ka ndërtuar një politikë fiskale në tërësi kundërciklike, e cila kursen më tepër gjatë bumeve të çmimeve, ndërsa shpenzon më tepër gjatë rënies

¹³ Në këtë rast kërkohet krijimi i një regjimi specifik valutë, fleksibil, mirëpo i menaxhuar, i cili do të krijonte mundësi që të intervenohet efektivisht në tregun e valutave gjatë cikleve të komoditeteve.

së tyre. Mirëpo, se sa do të kursehet dhe shpenzohet, kjo përcaktohet në bazë të rregullave strikte fiskale. Më saktësisht, për të përcaktuar nivelin e shpenzimeve apo të kursimeve qeveria në Kil përcjell rregulla të caktuara që kanë për bazë trendet e ardhshme të çmimeve të bakrit¹⁴, atë të inflacionit dhe ato të rritjes ekonomike. Për shembull, qeveria mund të gjenerojë deficit mbi nivelin e caktuar fillestar vetëm në rastet kur autputi është nën atë potencial për periudha afatgjata apo kur çmimi i bakrit parashihet të jetë nën nivelin mesatar për së paku dhjetë vjet. Një tjetër karakteristikë e këtij procesi është krijimi i dy paneleve të përbëra nga ekspertë të fushës (nga kompanitë në industrinë ekstraktive, sektori financiar, instituteve hulumtuese dhe universiteteve), të cilët në mes të vitit përcaktojnë se cili është **gapi** ? në mes të autputit të gjeneruar dhe atij potencial, si dhe cili është ekuilibri afatmesëm i çmimeve të bakrit. Bazuar në këto analiza, qeveria pastaj bën vlerësimet përkatëse dhe përcakton buxhetin e vendit sipas rregullave të përcaktuara më parë.

Një qasje e tillë është aplikuar edhe në vende të tjera. Në vendet me institucione të brishta (sikur që është edhe rasti i Kosovës), Frankel sugjeron që këto rregulla fiskale të përforcohen edhe me mekanizma të tjerë. Ai sugjeron që i tërë ky proces i ndërtimit të buxhetit të sanksionohet me ligj, e anëtarëve të paneleve t'u jepet pavarësi ligjore. Gjithashtu, mund të përcaktohen me ligj kualifikimet profesionale që kërkohen për të qenë pjesë e paneleve dhe ata të mbrohen nga përfshirja nga panelet.

V. PËRMBLEDHJE

Për efektin e resurseve natyrore në ekonominë nacionale ka dilema të shumta. Konvencionalisht është besuar që efektet e resurseve natyrore janë pozitive në rritjen ekonomike, mirëpo studime të ndryshme kanë trumbetuar të kundërtën. Si do që të jetë, ekziston një konsensus i përgjithshëm, duke përfshirë këtu edhe ata të cilët insistojnë në raportin negativ në mes të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike, se nuk është problem ekzistenca e pasurive natyrore, por është dështimi i mekanizmave të shtetit për të evituar rreziqet që shoqërojnë këtë bekim të natyrës. Edhe ky studim ndërtohet në këtë frymë; në qendër të këtij punimi qëndron ideja se resurset natyrore janë një potencial shumë i madh për një vend, mirëpo

¹⁴ Kili ishte eksportuesi më i madh i bakrit në vitin 2009. Shih The Top 10 Copper Producing Countries në <http://copperinvestingnews.com/4147/the-top-10-copper-producing-countries> (prill 2011).

shfrytëzimi i tyre bart më vete rreziqe të caktuara, të cilat duhet të evidentohen nga politikëbërja dhe të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për të eliminuar kanalet përmes të cilave potencialisht mund të prezantohen këto ndikime negative.

Qëllimi i këtij punimi ishte të identifikojë përvojat e vendeve të ndryshme në botë, të pasura me burime natyrore, dhe t'i transmetojë këto përvoja në kontekst të Kosovës. U synua të identifikohen hapat kryesorë institucionalë që duhet ndërmarrë Kosova që efektet e shfrytëzimit të resurseve natyrore të jenë sa më mëdha për ekonominë e vendit dhe mirëqenien e popullsisë. Bazuar në analizën e literaturës që ndërlidh resurset natyrore me rritjen ekonomike si dhe bazuar në përvoja të ndryshme nga vendet e zhvilluara dhe në zhvillim, në fund u propozuan një numër masash në përputhje me realitetin kosovar. Duhet thënë që ky punim nuk ka pretenduar të ofrojë listën e plotë dhe përfundimtare të rekomandimeve për Kosovën me qëllim të shfrytëzimit sa më eficient të resurseve natyrore. Edhe ajo çfarë është propozuar këtu duhet të shihet me sy kritik, pasi që propozimet e dhëna kërkojnë elaborim të mëtejshëm dhe të detajuar.

Të gjitha përvojat e prezantuara këtu flasin për rëndësinë e ngritjes së kualitetit të institucioneve si parakusht që shfrytëzimi i resurseve natyrore të sigurojë rritje ekonomike afatgjatë dhe mirëqenie. Fuqizimi i institucioneve nënkupton krijimin e stabilitetit politik, zbatimit më të mirë të ligjit, eliminimin e korrupsionit dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore. Për më tepër, institucionet janë përgjegjëse që një pjesë të të ardhurave nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të kanalizohet në akumulimin e kapitalit human, çfarë do të sigurojë rritje ekonomike afatgjate. Akumulimi i kapitalit human do të thotë shfrytëzim i burimeve natyrore me qëllim të krijimit të një sistemi të fuqishëm arsimor, i cili ngadalë do të krijojë kuadro të reja, të cilat do ta tërheqin Kosovën nga vartësia në resurse natyrore. Për më tepër, resurset humane të zhvilluara do ndikojnë në diversifikimin e industrive – një tjetër faktor i rëndësishëm i rritjes. Gjithashtu, institucionet janë përgjegjëse për ngritjen e infrastrukturës dhe përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, faktorë këta të cilët do të ndikojnë, para së gjithash, në fuqizimin e sektorit privat. Në kontekst të Kosovës, të rëndësishme mbeten gjithashtu edhe politikat fiskale prociklike, të cilat determinojnë kursime më të mëdha gjatë ngritjeve të çmimeve në tregun e komoditeteve dhe shpenzimeve më të mëdha kur këto çmime bien. Të gjitha këto propozime kanë një synim: të sigurojnë që përfitimet nga pasuritë natyrore të ndahen në mes të gjeneratave të sotme dhe atyre të ardhshme.

REFERENCA

- Acemoglu, D., Johnson, S. dhe Robinson, J. A. (2004), An African Success Story: Botswana. Në *In Search of Prosperity: Analytic Narratives on Economic Growth*. Edituar nga Rodrik, D. Princeton University Press.
- Alexeev, M. dhe Conrad, R. (2009), The Elusive Curse of Oil, *The Review of Economics and Statistics*, 91 (3).
- Alexeev, M. dhe Conrad, R. (2010), The Natural Resource Curse and Economic Transition, CAEPR Working Paper 018-2009.
- Auty, R. (1993), *Sustaining Development in Mineral Economies*, Rutledge.
- Auty, R. (2001), Reforming Resource-Abundant Transition Economies: Kazakhstan and Uzbekistan. Në *Resource Abundance and Economic Development*, edituar nga Auty, R. Oxford University Press.
- Bartlett, W. dhe Monastiriotis, V. (2010), *South Eastern Europe after the Crisis: a New Dawn or back to Business as Usual?* LSE Reprographics.
- Brunnschweiler, C. (2008) Cursing the Blessings? Natural Resource Abundance, Institutions, and Economic Growth, *World Development*, 36 (3).
- Brunnschweiler, C. dhe Bulte, E. (2008), The Resource Curse Revisited and Revised: A Tale of Paradoxes and Red Herrings, *Journal of Environmental Economics and Management*, 55 (3).
- EBRD (2009), *Transition Report: Transition in Crisis*, EBRD.
- Frankel, J. (2010), The Natural Resource Curse: A Survey, Faculty Research Working Paper RWP10-005.
- Gashi, P. (2010), The global economic crisis and Kosovo. Në *South Eastern Europe after the Crisis: a New Dawn or back to Business as Usual?* Edituar nga Bartlett, W. dhe Monastiriotis, V. LSE Reprographics.
- Gylfason, T. (2001), Natural Resources, Education, and Economic Development, *European Economic Review* 45.
- Gylfason, T. (2007), The International Economics of Natural Resources and Growth, CESIFO Working Paper 1994.
- Kronenberg, T. (2004), The Curse of Natural Resources in the Transition Economies, *Transition Economics* 12 (3).
- Markandya, A. dhe Averbchenkova, A. (2001), Reforming a Large Resource-Abundant Transition Economy: Russia. Në *Resource*

-
- Abundance and Economic Development*, edituar nga Auty, R. Oxford University Press.
- Mehlum, H., Moene, K. dhe Torvik, R. (2006), Institutions and Resource Curse, *The Economic Journal* 116 (Janar).
- OECD (2008), Natural Resources and Pro-Poor Growth, OECD
- Sachs, J. D. dhe Warner, A. M. (1995), Natural Resource Abundance and Economic Growth, NBER Working Paper 5398.
- Sala-i-Martin (1997a), I Just Run Two Million Regressions, *American Economic Review* 87 (2).
- Sala-i-Martin (1997b), I Just Run two Million Regressions. Mimeo.
- Sala-i-Martin, X., Doppelhofer, G. dhe Miller, R. I. (2004), Determinants of Long-Term Growth: A Bayesian Averaging of Classical Estimates (BACE) Approach, *American Economic Review* 94 (4).
- Stijns, J. P. (2005), Natural Resources and Economic Growth Revisited, *Resources Policy* 30.

**SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM
I PASURIVE NATYRORE
2011**

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:
Taulant Veseli

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 8.125 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
PROGRAF
Prishtinë

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

502.5(496.51)(061)
330.15(496.51)(061)

Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore :
Matrialet e Tryezës shkencore 20 tetor 2010, në Prishtinë /
Këshilli redaktues Hivzi Islami, Pajazit Nushi dhe Isa Mustafa.
Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2011.
- 343 f. : ilustr. ; 24 cm. - (ASHAK : Seksioni i Shkencave Shoqërore)

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze. - Parathënie : f. 5-6.
- Indeksi i termave : f. 303-335. - Literatura : f. 338-342

1. Islami, Hivzi 2. Nushi, Pajazit 3. Mustafa, Isa

ISBN 978-9951-413-98-5